

RAPORTI VJETOR 2025

Raporti Vjetor është miratuar me vendim të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, Nr. 1, datë 4.3.2026.

Nëse përdorni të dhëna të këtij publikimi, jeni të lutur të citoni burimin.

Botuar nga: Banka e Shqipërisë,

Sheshi "Skënderbej", Nr.1, Tiranë

Tel.: + 355 4 2419301/2/3; + 355 4 2419409/10/11

Faks: + 355 4 2419408

E-mail: public@bankofalbania.org


www.bankofalbania.org

Tirazhi: 240 kopje



P Ë R M B A J T J A

BAZA LIGJORE E USHTRIMIT TË VEPRIMTARISË	7
FJALA E GUVERNATORIT	9
ZHVILLIMET KRYESORE TË VITIT 2025	11
KËSHILLI MBIKËQYRËS I BANKËS SË SHQIPËRISË	13
1. KËSHILLI MBIKËQYRËS I BANKËS SË SHQIPËRISË	15
2. VEPRIMTARIA E BANKËS SË SHQIPËRISË	20
2.1. Politika monetare	20
2.2. Operacionet monetare	53
2.3. Stabiliteti financiar dhe politika makroprudenciale	56
2.4. Mbikëqyrja bankare	61
2.5. Ndërhyrja e jashtëzakonshme	69
2.6. Emetimi i monedhës	75
2.7. Sistemet e pagesave	78
2.8. Administrimi i rezervës valutore	90
2.9. Statistikat	95
2.10. Puna kërkimore	99
2.11. Integrimi evropian dhe bashkëpunimi ndërkombëtar	103
2.12. Transparenca dhe komunikimi me publikun	107
2.13. Edukimi financiar	114
3. BURIMET NJERËZORE DHE KAPACITETET INFRASTRUKTURORE	116
3.1. Burime njerëzore	116
3.2. Përmirësime në infrastrukturë	117
4. AUDITIMI I BRENDSHËM	119
4.1. Zhvillime të rëndësishme në aktivitetin e auditimit të brendshëm	119
4.2. Tregues të përgjithshëm mbi Departamentin e Kontrollit	120
4.3. Angazhimet e kryera gjatë vitit 2025 dhe problematikat kryesore të evidentuara	121
5. ADMINISTRIMI I RREZIKUT OPERACIONAL	122
6. STRATEGJIA AFATMESME E ZHVILLIMIT TË BANKËS SË SHQIPËRISË 2026 – 2028	125



HAPËSIRA INFORMUESE

<i>Hapësirë Informuese 1</i>	<i>Ecuria e kursit të këmbimit dhe reagimi i Bankës së Shqipërisë</i>	24
<i>Hapësirë Informuese 2</i>	<i>Rivlerësimi i rritjes potenciale</i>	33
<i>Hapësirë Informuese 3</i>	<i>Programi i financimit për biznesin mikro, të vogël dhe të mesëm</i>	48
<i>Hapësirë Informuese 4</i>	<i>Burimet e financimit të kërkesës MREL gjatë vitit 2025</i>	72
<i>Hapësirë Informuese 5</i>	<i>Përditësimi i sistemeve kombëtare të pagesave</i>	82
<i>Hapësirë Informuese 6</i>	<i>Flukset që ndikuan rezervën valutore, gjatë vitit 2025</i>	93
<i>Hapësirë Informuese 7</i>	<i>Aktivitete brenda vendit, të organizuara gjatë vitit 2025</i>	109

PËRMBAJTJA E TABELAVE

2.	<i>Veprimtaria e Bankës së Shqipërisë</i>	
Tabelë 1.	<i>Rritja reale dhe kontributet sektoriale</i>	29
Tabelë 2.	<i>Rritja potenciale sipas metodave të ndryshme në vite</i>	34
Tabelë 3.	<i>Dekompozimi i rritjes potenciale sipas faktorëve të prodhimit</i>	35
Tabelë 4.	<i>Kontributi i kategorive kryesore në inflacionin vjetor</i>	39
Tabelë 5.	<i>Ecuria e treguesve kryesorë të bilancit të pagesave dhe të borxhit të huaj</i>	42
Tabelë 6.	<i>Kredia e bankave për bizneset, sipas sektorëve të ekonomisë</i>	47
Tabelë 7.	<i>Tregues kryesorë makroekonomikë dhe financiarë</i>	52
Tabelë 8.	<i>Struktura e operacioneve injektuese të likuiditetit nga Banka e Shqipërisë</i>	54
Tabelë 9.	<i>Tregues të aktivitetit të sistemit financiar</i>	57
Tabelë 10.	<i>Kufijtë për raportet “Kredi ndaj vlerës së kolateralit” dhe “Shërbimi i borxhit ndaj të ardhurave” në disbursim</i>	59
Tabelë 11.	<i>Numri i ekzaminimeve sipas tematikës, për vitin 2025</i>	64
Tabelë 12.	<i>Struktura e pronësisë së bankave, numri i bankave</i>	67
Tabelë 13.	<i>Numri i bankave, subjekteve financiare jobanka, shoqërive të kursim-kreditit dhe zyrave të këmbimit valutor të licencuara nga Banka e Shqipërisë</i>	68



PËRMBAJTJA E GRAFIKËVE

2.	<i>Veprimtaria e Bankës së Shqipërisë</i>	
Grafik 1	<i>Ecuria e inflacionit, atij bazë e pritjeve afatmesme dhe norma bazë</i>	23
Grafik 2	<i>Lidhja e sektorit të jashtëm të ekonomisë me kursin e këmbimit dhe tregun valutor</i>	25
Grafik 3	<i>Efektet në inflacion dhe normë bazë të interesit në kushtet e mbajtjes së kursit fiks 115.5 lek/eur</i>	27
Grafik 4	<i>Ecuria e PBB-së dhe kontributi i aktiviteteve ekonomike sipas sektorëve në rritjen ekonomike</i>	28
Grafik 5	<i>Ndryshimi vjetor i kërkesës së brendshme sipas komponentëve</i>	29
Grafik 6	<i>Ecuria e konsumit dhe e investimeve</i>	29
Grafik 7	<i>Kontributi i eksportit dhe importit në rritjen ekonomike</i>	30
Grafik 8	<i>Ndryshimet vjetore të eksporteve dhe importeve të mallrave me kontributet e kategorive kryesore</i>	31
Grafik 9	<i>Impulsi fiskal dhe natyra e politikës fiskale</i>	31
Grafik 10	<i>Të ardhurat dhe shpenzimet</i>	32
Grafik 11	<i>Deficiti buxhetor dhe financimi dhe borxhi publik ndaj PBB-së</i>	33
Grafik 12	<i>Tregues të tregut të punës</i>	36
Grafik 13	<i>Inflacioni vjetor dhe objektiv; inflacioni në vend, në vendet e rajonit dhe në BE</i>	37
Grafik 14	<i>Struktura e artikujve të shportës së IÇK-së sipas intervaleve të inflacionit</i>	38
Grafik 15	<i>Kontributi i qirave në inflacionin total dhe indekseve të çmimeve të banesave dhe qirave në vend</i>	38
Grafik 16	<i>Inflacioni sipas komponentëve bazë dhe jobazë, të brendshëm dhe të importuar</i>	40
Grafik 17	<i>Tregues të gjendjes ciklike</i>	40
Grafik 18	<i>Ecuria e pritjeve të agjentëve ekonomikë për inflacionin</i>	41
Grafik 19	<i>Ecuria e tregut ndërbankar dhe e tregut primar</i>	43
Grafik 20	<i>Ecuria e kursit të këmbimit</i>	44
Grafik 21	<i>Ecuria e normave të interesit të kredive dhe depozitave</i>	45
Grafik 22	<i>Ecuria e kredisë për sektorin privat dhe e depozitave të bankave</i>	47
Grafik 23	<i>Kontributi i BMV-ve në vlerën e shtuar dhe në rritjen e kredisë për biznese</i>	48
Grafik 24	<i>Ecuria e programit sipas madhësisë së biznesit, sektorit ekonomik dhe përdorimi i fondeve</i>	51
Grafik 25	<i>Ecuria e likuiditetit të sistemit bankar</i>	53
Grafik 26	<i>Kapaciteti MREL</i>	71
Grafik 27	<i>Burimet e financimit të MREL për grupin e bankave që i nënshtrohen kësaj kërkesë dhe struktura e MREL në dhjetor 2025</i>	72
Grafik 28	<i>Fondi i Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme dhe niveli i synuar në vitin 2027</i>	74
Grafik 29	<i>Tregues të ecurisë së monedhës kombëtare dhe të kartëmonedhës dhe të monedhës metalike</i>	75
Grafik 30	<i>Treguesit e përpunimit dhe papërshtatshmërisë së kartëmonedhave dhe koeficienti i qarkullimit</i>	76
Grafik 31	<i>Ecuria e treguesit të falsifikimit të kartëmonedhave në qarkullim</i>	76
Grafik 32	<i>Numri dhe vlera e transaksioneve të procesuara në AIPS</i>	79
Grafik 33	<i>Numri dhe vlera e transaksioneve të procesuara në AIPS EURO</i>	80
Grafik 34	<i>Volumi dhe vlera e transaksioneve të kleruar në AECH</i>	81
Grafik 35	<i>Ecuria e sistemit AFISaR sipas numrit dhe vlerës së transaksioneve të procesuara, dhe në përqindje ndaj PPB-së</i>	82
Grafik 36	<i>Numri i instrumenteve të pagesave elektronike dhe në formë letër numri i pagesave për frymë (+15 vjeç)</i>	84
Grafik 37	<i>Pesha e instrumenteve të pagesave sipas numrit të transaksioneve dhe përdoruesit sipas tipologjisë së instrumenteve të pagesave, gjatë vitit 2025</i>	85
Grafik 38	<i>Përdorimi i kartave për pagesa kundrejt tërheqjeve të parasë fizike në ATM, si dhe numri total i kartave</i>	86



Grafik 39	Numri i ATM-ve dhe POS-ve fizike dhe virtuale	87
Grafik 40	Ecuria e rezervës valutore	90
Grafik 41	Përbërja sipas monedhave e rezervës valutore bruto	91
Grafik 42	Shpërndarja e rezervës sipas afatit të maturimit të instrumenteve	91
Grafik 43	Përbërja e portofolit të rezervës sipas vlerësimit dhe kundërpalës	92
Grafik 44	Kithimi i rezervës valutore	92
4.	<i>Auditimi i brendshëm</i>	
Grafik 45	Progresi në vlerësimin e EQA-s	120



BAZA LIGJORE E USHTRIMIT TË VEPRIMTARISË

Banka e Shqipërisë (BSH) është banka qendrore e Republikës së Shqipërisë. Ky status sanksionohet në nenin 161 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe në ligjin 8269/1997 "Për Bankën e Shqipërisë", i cili përcakton objektivat, detyrat, marrëdhëniet me sistemin bankar dhe me shtetin, organizimin dhe drejtimin, pronësinë mbi kapitalin, pasqyrat financiare dhe shpërndarjen e fitimit.

Banka e Shqipërisë ka si objektiv kryesor, arritjen dhe ruajtjen e stabilitetit të çmimeve. Në përmbushje të këtij objektiwi dhe të detyrave të tjera të saj, ajo ushtron funksionet në mënyrë autonome dhe të pavarur nga çdo pushtet tjetër.

Banka e Shqipërisë është me kapital tërësisht shtetëror dhe përgjigjet përpara Kuvendit të Republikës së Shqipërisë. Ajo drejtohet nga Këshilli Mbikëqyrës, i cili kryesohet nga Guvernatori, që vepron edhe si Drejtor i Përgjithshëm Ekzekutiv i saj.

Veprimtaria e Bankës së Shqipërisë mbështetet në ligjet e mëposhtme:

- Neni 161 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë;
- Ligji nr. 8269, datë 23.12.1997, "Për Bankën e Shqipërisë", i ndryshuar;
- Ligji nr. 9662, datë 18.12.2006, "Për bankat në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar;
- Ligji nr.133, datë 29.4.2013, "Për sistemin e pagesave";
- Ligji nr.55/2020, "Për shërbimet e pagesave";
- Ligj nr.52, datë 19.5.2016, "Për shoqëritë e kursim-kreditit dhe unionet e tyre";
- Ligj nr.133, datë 22.12.2016, "Për rimëkëmbjen dhe ndërhyrjen e jashtëzakonshme në banka në Republikën e Shqipërisë";
- Ligji nr.100, datë 14.12.2023, "Për llogarinë e pagesave me shërbime bazike";
- Statuti i Bankës së Shqipërisë, miratuar me vendimin nr.90, datë 2.12.2015 të Këshillit Mbikëqyrës, i ndryshuar.





GUVERNATORI I BANKËS SË SHQIPËRISË, Z. GENT SEJKO

FJALA E GUVERNATORIT

Viti që lamë pas ishte një vit pozitiv për ekonominë shqiptare dhe Bankën e Shqipërisë.

Ndonëse konteksti i brendshëm dhe ai i jashtëm i zhvillimit mbetën sfidues, si pasojë e goditjeve të ofertës, tensioneve gjeopolitike, rritjes së barrierave tregtare dhe të pasigurisë në tregjet botërore, ekonomia shqiptare arriti të ruajë një trend pozitiv zhvillimi. Rritja ekonomike mbeti në nivele solide, duke gjeneruar më shumë vende pune dhe paga më të larta në sektorin privat jobujqësor. Gjithashtu, inflacioni i çmimeve të konsumit mbeti i ulët dhe i kontrolluar, ndërsa ekuilibrat e brendshëm dhe të jashtëm të ekonomisë erdhën në përmirësim, duke rritur rezistencën tonë ndaj goditjeve potenciale.

Një kontribut pozitiv në këtë ecuri kanë dhënë dhe politikat, ndërhyrjet rregullatore dhe masat e ndërmarra nga Banka e Shqipërisë. Në pamundësi të listimit të të gjithë aktivitetit tonë gjatë vitit 2025, po ndalem shkurtimisht në disa momente kryesore.

Politika jonë monetare mbeti e orientuar drejt ruajtjes së stabilitetit të çmimeve, duke qenë njëkohësisht proaktive, fleksibile dhe e kujdesshme. Lehtësimi i kostos së parasë dhe prezenca e rritur në tregjet valutore, ndihmuan në ruajtjen e inflacionit në nivele të ulëta dhe pranë objektivit të Bankës së Shqipërisë. Stabiliteti i çmimeve ka mbrojtur fuqinë blerëse të pagave dhe të kursimeve të familjeve shqiptare, ka reduktuar pasiguritë për të ardhmen dhe ka krijuar një mjedis stimulues për rritjen e konsumit dhe të investimeve.

Mbikëqyrja rigoroze, politika makroprudenciale dhe fuqizimi i instrumenteve për ndërhyrje të jashtëzakonshme kanë rritur rezistencën e sektorit bankar ndaj goditjeve. Në veçanti, gjatë vitit 2025 kemi punuar për uljen e kostove të produkteve bankare dhe rritjen e transparencës së tyre, në interes të rritjes së mbrojtjes së konsumatorit, për forcimin e rrjeteve të kontrollit në funksion të parandalimit të pastrimit të parave, si dhe për përafrimin e mëtejshëm të kuadrit tonë mbikëqyrës e rregullator me standardet e Bashkimit Evropian. Falë përpjekjeve tona të vazhdueshme, sot sistemi bankar paraqitet i qëndrueshëm, likuid, i mirëkapitalizuar dhe i gatshëm të financojë rritjen e ekonomisë. Kreditë me probleme kanë zbritur pranë minimeve historike, duke reflektuar një mjedis të shëndetshëm kreditimi.

Modernizimi i ekosistemit të pagesave ka sjellë një ndryshim të prekshëm në përditshmërinë financiare të qytetarëve dhe bizneseve. Në veçanti, përditësimi i sistemeve të pagesave, përmirësimi i kuadrit rregullator dhe operimi i SEPA-s kanë mundësuar transferata më të shpejta, më të sigurta dhe më të lira. Zgjerimi i përdorimit të pagesave elektronike është dëshmi konkrete se reformat e ndërmarra ndër vite po japin rezultate, duke thelluar përfshirjen financiare dhe duke përshpejtuar digjitalizimin e ekonomisë.

Mbështetja e procesit të integritimit evropian mbeti një prioritet strategjik i punës sonë. Përafrimi i mëtejshëm i kuadrit ligjor, rregullator dhe statistikor me acquis dhe standardet e Bashkimit Evropian ka rritur nivelin e konvergencës institucionale dhe ka afruar sistemin financiar shqiptar me arkitekturën evropiane, duke kontribuar drejtpërdrejt në avancimin e procesit të anëtarësimit.



Banka e Shqipërisë ka investuar në forcimin e besimit publik përmes rritjes së transparencës, komunikimit dhe edukimit financiar, duke intensifikuar dialogun me publikun dhe tregjet. Ndërkohë, agjenda jonë shkencore, jo vetëm ka mbështetur vendimmarrjen, por ka pasuruar edhe debatin profesional në vend.

I dashur lexues,

Viti 2025 shënoi 100-vjetorin e themelimit të Bankës së Shqipërisë. Ky jubile nuk ishte vetëm një moment reflektimi mbi një shekull kontribut në stabilitetin monetar e financiar, por edhe një pikënisje për një fazë të re zhvillimi. Historia jonë është dëshmi se institucionet e forta dhe të pavarura janë themel i zhvillimit të qëndrueshëm. Ato ruajnë stabilitetin në kohë sfidash dhe mbështesin ndryshimin në kohë mundësish.

Përpara nesh qëndrojnë sfida të njohura e të panjohura, në një mjedis të brendshëm e të huaj në ndryshim, ku transformimi teknologjik, dinamika demografike dhe procesi i konvergjencës evropiane kërkojnë vendimmarrje të matur dhe vizion afatgjatë. Në këtë kontekst, drejtimi ynë mbetet i qartë: ruajtja e stabilitetit të çmimeve, forcimi i qëndrueshmërisë financiare, modernizimi i mëtejshëm i infrastrukturës financiare dhe mbështetja e integritimit evropian. Në një botë të pasigurt, stabiliteti është kontributi ynë më i madh për zhvillimin e qëndrueshëm.

Në këto rrethana, Banka e Shqipërisë do të vazhdojë të investojë për forcimin e kuadrit të politikës monetare, makro dhe mikroprudenciale, si dhe për konsolidimin e mëtejshëm të kapaciteteve të saj institucionale, në funksion të ruajtjes së stabilitetit monetar e financiar të vendit.

Në përfundim, dëshiroj të falënderoj stafin e Bankës së Shqipërisë për profesionalizmin dhe përkushtimin e treguar gjatë këtij viti, si dhe partnerët tanë institucionalë për bashkëpunimin konstruktiv. Besimi i publikut mbetet kapitali ynë më i çmuar dhe përgjegjësia jonë për ta merituar atë është e përhershme.

Me respekt,

Gent Sejko
GUVERNATOR



ZHVILLIMET KRYESORE TË VITIT 2025

- *Ekonomia shqiptare shënoi progres gjatë vitit 2025, si në drejtim të rritjes ekonomike, ashtu edhe të konsolidimit të stabilitetit makroekonomik.*
- *Vëllimi i aktivitetit ekonomik, punësimi dhe pagat në sektorin privat jobujqësor shënuan rritje gjatë tre tremujorëve të parë. Rritja ekonomike u ushqye nga zgjerimi i konsumit, i investimeve dhe i eksportit të shërbimeve, dhe u pasqyrua në rritje të sektorit të shërbimeve dhe të ndërtimit. Në terma makroekonomikë, trendi pozitiv i rritjes pasqyroi bilancet likuide të sektorit privat, ambientin stimulues financiar, besimin për të ardhmen dhe kontributin pozitiv të turizmit.*
- *Inflacioni i çmimeve të konsumit qëndroi në nivelin mesatar 2.2%, duke u luhatur poshtë – por pranë – objektivit të Bankës së Shqipërisë. Gjithashtu, deficitit buxhetor dhe ai i llogarisë korrente mbetën pranë niveleve minimale historike, borxhi publik dhe ai i huaj erdhën në rënie, treguesit e shëndetit të sistemit bankar u përmirësuan, tregjet financiare ishin të qeta dhe rezerva valutore e Bankës së Shqipërisë arriti në nivelin 7.3 miliardë euro.*
- *Banka e Shqipërisë ndoqi një politikë monetare me kah lehtësues gjatë vitit 2025, duke ruajtur stabilitetin e çmimeve dhe duke krijuar kushte më stimuluese financiare. Reduktimi në 2.5% i normës bazë të interesit nxiti rritjen e mëtejshme të kreditimit dhe uli kostot e shërbimit të borxhit. Kredia për sektorin privat u rrit me 14.7%, e udhëhequr nga rritja e kredisë në lekë dhe ajo me destinacion investimi. Gjithashtu, rritja e prezencës së Bankës së Shqipërisë në tregun valutor zbuti ritmin e forcimit të kursit të këmbimit të lekut.*
- *Spektori bankar ruajti tregues solidë likuiditeti, përfitueshmërie dhe kapitalizimi. Kreditë me probleme zbritën në 3.8%, ndërsa rreziqet sistemike vlerësohen të përmbajtura. Spektori bankar shfaq një nivel të kënaqshëm rezistence ndaj goditjeve potenciale.*
- *Kuadri mbikëqyrës dhe makroprudencial u përmirësua më tej, me fokus kontrollin më të mirë të rreziqeve, mbrojtjen e konsumatorit dhe parandalimin e pastrimit të parave. Përafrimi i kuadrit rregullator me acquis e BE-së dhe rritja e kapacitetit për ndërhyrje të jashtëzakonshme rritën qëndrueshmërinë e sektorit bankar.*
- *Banka e Shqipërisë modernizoi infrastrukturën e pagesave. Përditësimi i sistemeve, rishikimi i kuadrit rregullator në funksion të uljes së kostove, rritjes së shpejtësisë dhe zgjerimit të gamës së produkteve, dhe operimi i SEPA-s, mundësuan transfertat më të shpejta, më të sigurtat dhe me kosto më të ulëta.*
- *Banka e Shqipërisë përmbushi detyrimet institucionale në kuadër të procesit të integritimit evropian, duke harmonizuar më tej kuadrin e saj ligjor e rregullator me acquis dhe standardet e BE-së, duke vijuar dialogun në fushën e politikave ekonomike dhe duke kontribuar në procesin e negociatave.*
- *Banka e Shqipërisë garantoj qarkullimin cilësor dhe të sigurt të Lekut, duke mbështetur funksionimin normal të ekonomisë dhe të aktivitetit tregtar.*



Gjithashtu, ajo shënoi progres në përmirësimin e statistikave financiare dhe kontribuoi në zhvillimin e kërkimit shkencor dhe të dialogut publik.

- *Qeverisja dhe orientimi strategjik u konsoliduan. Mekanizmat e kontrollit të brendshëm, auditimit dhe administrimit të rrezikut u përforcuan, si dhe u miratua Strategjia Afatmesme e Zhvillimit të Bankës së Shqipërisë 2026-2028, e cila qartëson prioritetet institucionale dhe orienton buxhetin afatmesëm.*
- *Banka e Shqipërisë përmirësoi më tej transparencën dhe komunikimin, duke rritur besimin e publikut në të. Në veçanti, viti 2025 shënoi kremtimin e 100-vjetorit të themelimit të Bankës së Shqipërisë. Jubileu kurorëzoi një shekull kontribut në stabilitetin monetar dhe financiar të vendit. Aktivitetet e vitit ndërthurën reflektimin historik me vizionin për të ardhmen.*



KËSHILLI MBIKËQYRËS I BANKËS SË SHQIPËRISË



1. KËSHILLI MBIKËQYRËS I BANKËS SË SHQIPËRISË

Këshilli Mbikëqyrës është organi më i lartë vendimmarrës dhe mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë. Këshilli: (i) miraton politikën monetare dhe atë të kursit të këmbimit, si dhe politikën e stabilitetit financiar dhe atë makroprudenciale; (ii) mbikëqyr procesin e buxhetimit, të raportimit financiar, të kontrolleve të brendshme dhe të auditimit në Bankën e Shqipërisë; (iii) miraton të gjitha aktet normative që nxirren nga institucioni; si dhe (iv) miraton strategjinë afatmesme, emërimin e drejtuesve të departamenteve dhe strukturën organizative të Bankës së Shqipërisë.

Këshilli i ushtron kompetencat e veta në mënyrë të pavarur dhe transparente, në përputhje me ligjin organik dhe me rregullat e brendshme procedurale.

Monitorimi i procesit të raportimit financiar dhe i sistemit të kontrollit të brendshëm i është deleguar Komitetit të Auditit.

Këshilli Mbikëqyrës zhvilloi 16 mbledhje gjatë vitit 2025. Tetë prej tyre iu dedikuan politikës monetare, katër stabilitetit financiar dhe mbikëqyrjes, ndërsa mbledhjet e tjera trajtuan: (i) programin vjetor të Këshillit; (ii) raportin vjetor dhe rezultatin financiar; (iii) pasqyrat financiare dhe (iv) strategjinë afatmesme, buxhetin vjetor dhe atë afatmesëm.

Këshilli u informua rregullisht mbi: (i) politikat e administrimit të institucionit; (ii) mënyrat dhe procedurat e përdorimit të mjeteve financiare për realizimin e veprimtarisë operative; dhe (iii) ecurinë e administrimit të rezervës valutore. Departamenti i Kontrollit ka raportuar mbi efektivitetin dhe cilësinë e sistemeve të kontrollit të brendshëm, administrimit të rrezikut dhe drejtimit të BSH-së.

Këshilli u njoh gjithashtu me raportin vjetor të mbikëqyrjes, i cili analizon veprimtarinë e sistemit bankar dhe mbikëqyrjen e tij gjatë vitit 2024, ofron statistika dhe informacione mbi subjektet e licencuara, si dhe analizon çështje të ecurisë së sistemit bankar.

Në zbatim të detyrimeve si institucion i pavarur kushtetues, Banka e Shqipërisë ka raportuar rregullisht në Kuvend për përmbushjen e rekomandimeve të lëna në rezolutën për vlerësimin e veprimtarisë së saj.

KËSHILLI SI ORGANI MË I LARTË VENDIMMARRËS I BANKËS SË SHQIPËRISË

Këshilli miratoi 73 vendime, prej të cilave, 49 ishin akte të reja dhe 24 ndryshime aktesh ekzistuese.



Vendimet janë nxjerrë në përmbushje të detyrave ligjore të Këshillit, si: (i) stabiliteti i çmimeve; (ii) licencimi, rregullimi dhe mbikëqyrja e bankave dhe institucioneve të tjera financiare; dhe (iii) ofrimi i infrastrukturës financiare (emisioni i kartëmonedhës dhe monedhës; sistemet e pagesave; tregu ndërbankar; statistikat).

Çdo muaj, Këshilli ka marrë informacion nga administratorët lidhur me zhvillimet ekonomike, financiare dhe monetare, në përmbushje të detyrimeve ligjore.

DREJTIMI DHE ORGANIZIMI I BRENDSHËM

Gjatë vitit 2025, Këshilli ka miratuar një numër vendimesh strategjike që synojnë rritjen e efikasitetit të brendshëm, modernizimin e strukturës organizative, forcimin e qeverisjes dhe përdorimin optimal të burimeve financiare.

Në nëntor, Këshilli miratoi Strategjinë Afatmesme të Zhvillimit të Bankës së Shqipërisë 2026-2028, duke ruajtur të pandryshuar misionin, vizionin dhe vlerat e Bankës. Strategjia e përditësuar mbështet një qasje të integruar të zhvillimit institucional dhe konsolidon prioritetet strategjike me synim forcimin e kapaciteteve, efikasitetin dhe transparencën e institucionit.

BUXHETI

Këshilli miratoi buxhetin për vitin 2026 dhe atë orientues afatmesëm për vitet 2027-2028. Buxheti u hartua në përputhje me objektivat e Strategjisë Afatmesme të Zhvillimit të Bankës së Shqipërisë, si dhe me parashikimet e departamenteve në lidhje me të ardhurat dhe shpenzimet për periudhën afatmesme.

Buxheti synon zhvillimin normal të veprimtarisë së Bankës së Shqipërisë dhe përmbushjen, në mënyrë të pavarur, të detyrave të përcaktuara në ligjin organik.

Shpenzimet kapitale dhe projektet e përfshira në buxhet u miratuan paraprakisht në Komitetin e Shpenzimeve Kapitale.

KËSHILLI SI ORGANI MË I LARTË MBIKËQYRËS I BANKËS SË SHQIPËRISË

Këshilli është informuar rregullisht nga hallkat e kontrollit të brendshëm dhe të jashtëm për sigurimin e respektimit korrekt të ligjit dhe të akteve të tjera që rregullojnë veprimtarinë e përditshme të institucionit.

A. Kontrolli i brendshëm

Kontrolli është një veprimtari e pavarur nga administrimi, i cili përfshin funksionet e administrimit të rrezikut, përputhshmërisë dhe auditimit të brendshëm dhe ofron vlerësim, raportim dhe siguri objektive.

1. Kontrolli mbi administrimin

Këshilli është informuar mbi politikat e administrimit të institucionit dhe përdorimin e mjeteve financiare për realizimin e veprimtarisë operative të Bankës së



Shqipërisë. Guvernatori përgjigjet përpara Këshillit për zbatimin e vendimeve të miratuara, si dhe për drejtimin, kontrollin dhe mbikëqyrjen mbi administrimin dhe operacionet e institucionit.

Inspektori i Përgjithshëm ka paraqitur në Këshill informacione tremujore mbi detyrat e kryera nga Departamenti i Kontrollit dhe mbi rezultatet e veprimtarisë së auditimit të brendshëm në BSH.

2. Veprimtaria e Komitetit të Auditit

Në funksion të rritjes së eficiencës dhe thellimit në fusha specifike, funksionet e auditimit të brendshëm i janë deleguar Komitetit të Auditit, i cili ushtron detyrat e tij në mbështetje të linjave të kontrollit të brendshëm dhe të jashtëm. Komiteti është përgjegjës për: (i) procesin e raportimit financiar; (ii) sistemin e kontrollit të brendshëm; (iii) auditimin e brendshëm dhe të jashtëm; si dhe (iv) përputhshmërinë me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.

Komiteti përbëhet nga tre anëtarë të Këshillit Mbikëqyrës. Anëtarët emërohen prej Këshillit, për një periudhë katërvjeçare, me të drejtë rizgjedhjeje vetëm një herë. Administratorët e Bankës së Shqipërisë nuk mund të jenë anëtarë të Komitetit. Kryetari i Komitetit zgjidhet prej anëtarëve të tij. Deri në dhjetor të vitit 2025, Komiteti përbëhej nga zj. Suela Popa (Kryetar), z. Ridvan Bode dhe zj. Edlira Luçi.

Komiteti zhvilloi 8 mbledhje, në të cilat u trajtuan: (i) veprimtaria e auditimit të brendshëm; (ii) rezultati financiar i Bankës së Shqipërisë; (iii) pasqyrat financiare dhe opinionin e auditorit të jashtëm; (iv) letra për drejtimin për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2024; (v) buxheti vjetor dhe afatmesëm, realizimi i buxhetit; dhe (vi) veprimtaria e administrimit të rrezikut operacional.

Komiteti ka informuar rregullisht Këshillin mbi veprimtarinë e tij dhe zbatimin e përgjegjësive të veta.

3. Auditimi i brendshëm

Inspektori i Përgjithshëm ka raportuar rregullisht në Këshill për realizimin e planit vjetor të punës së Departamentit të Kontrollit dhe rezultatet e angazhimeve të auditimit. Plani mbështetet në standardet ndërkombëtare të auditimit të brendshëm dhe në vlerësimin e përditësuar të rrezikut për funksionet e identifikuara në universin e rishikuar të auditimit.

4. Administrimi i rrezikut operacional dhe vijueshmëria e veprimtarisë

Këshilli ka miratuar politikën për administrimin dhe monitorimin e rrezikut operacional në Bankën e Shqipërisë dhe nivelin e tolerancës ndaj këtij rreziku. Përgjegjësia për trajtimin e rrezikut operacional, në përputhje me kuadrin e mësipërm, u përket administratorëve.



Komiteti i Auditit luan një rol mbështetës, duke diskutuar rregullisht me Inspektorin e Përgjithshëm dhe me auditorin e jashtëm, rreziqet e identifikuara dhe veprimet për trajtimin e tyre, si dhe duke i rekomanduar Këshillit masa për përmirësimin e sistemeve të kontrollit.

Këshilli është informuar rregullisht nga Inspektori i Përgjithshëm dhe Njësia e Administrimit të Rrezikut Operacional mbi ecurinë e zbatimit të programit për menaxhimin e vijueshmërisë së veprimtarisë.

B. Kontrolli i jashtëm

Ligji organik parashikon se llogaritë dhe regjistrat e Bankës së Shqipërisë mund të kontrollohen nga auditorë të jashtëm të institucioneve audituese të njohura në arenën ndërkombëtare që caktohen nga Këshilli. Auditori i Jashtëm shpreh opinionin e tij nëse raportet e përgatitura nga Banka e Shqipërisë paraqesin, në mënyrë të plotë dhe të drejtë, situatën financiare të institucionit, në përputhje me standardet ndërkombëtare të kontabilitetit të pranuara gjerësisht.

Pasqyrat financiare të Bankës së Shqipërisë auditohen për të ofruar siguri të arsyeshme se ato nuk kanë pasaktësi, si rezultat i gabimeve apo mashtrimit. Kjo i mundëson Auditorit të Jashtëm një rol kyç në ruajtjen e besimit të tregjeve financiare dhe publikut në raportimin financiar të Bankës së Shqipërisë.

Komiteti i Auditit shqyrton pasqyrat financiare të Bankës së Shqipërisë dhe vlerëson nëse ato janë hartuar në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar dhe në përputhje me opinionin e Auditorit të Jashtëm.

Përpara dorëzimit të opinionit mbi pasqyrat financiare, Komiteti takohet me Auditorin e Jashtëm, pa praninë e administratorëve, ku diskutohet ecuria e procesit të auditimit.

C. Llogaridhënia dhe transparencja

Ligji organik i jep Këshillit, kompetencën për të miratuar të gjitha raportet dhe rekomandimet që Banka e Shqipërisë i paraqet Kuvendit ose Këshillit të Ministrave, si dhe të miratojë raportet vjetore dhe raportet financiare të institucionit. Pas miratimit nga Këshilli, raportet publikohen.

1. Miratimi i raportit vjetor

Në muajin mars, Këshilli miratoi dhe dërgoi në Kuvend dhe në Këshillin e Ministrave, Raportin Vjetor 2024, i cili përshkruan gjendjen ekonomiko-financiare të vendit dhe veprimtarinë e institucionit gjatë vitit.

Pjesë përbërëse e raportit vjetor janë edhe pasqyrat financiare të audituara nga auditori i jashtëm (Ernst & Young Albania). Sipas opinionit të Ernst & Young, pasqyrat financiare japin një pamje të vërtetë dhe të drejtë të pozicionit financiar të Bankës së Shqipërisë më 31 dhjetor 2024, të performancës së



saj financiare dhe të flukseve të saj të parasë, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar.

Në zbatim të kërkesave të Manualit të Monitorimit Vjetor dhe Periodik të institucioneve të pavarura kushtetuese, raporti u shoqërua nga një informacion mbi nivelin e zbatimit të rekomandimeve të rezolutës së Kuvendit për vlerësimin e veprimtarisë së Bankës së Shqipërisë për vitin 2024, si dhe nga një informacion i detajuar mbi zbatimin e rregullave të përcaktuara në manual për raportimin e institucioneve të pavarura kushtetuese, në përgjithësi, dhe të Bankës së Shqipërisë, në veçanti.

2. Raportime të tjera për Kuvendin dhe Këshillin e Ministrave


Sipas ligjit organik, Banka e Shqipërisë publikon: (i) çdo tre muaj, një opinion të detajuar mbi gjendjen e ekonomisë, dhe (ii) çdo gjashtë muaj, një deklaratë për kërcënimet mbi stabilitetin e sistemit financiar.

Këshilli ka përmbushur rregullisht detyrimet e llogaridhënies së Bankës së Shqipërisë ndaj Kuvendit dhe detyrimet e transparencës ndaj publikut, sistemit financiar dhe mediave përmes përgatitjes dhe publikimit të raporteve tre dhe gjashtëmujore.

Në muajt shkurt, maj, gusht dhe nëntor, Këshilli ka miratuar raportet tremujore të politikës monetare, të cilat përbëjnë instrumentin kryesor të llogaridhënies dhe transparencës në fushën e politikës monetare. Këto raporte paraqesin zhvillimet e fundit makroekonomike dhe faktorët që ndikojnë në ecurinë e çmimeve të konsumit në vend.

Ndërsa, në muajt prill dhe shtator, Këshilli ka miratuar deklaratat dhe raportet gjashtëmujore të stabilitetit financiar që përmbajnë vlerësimin e përgjithshëm të rreziqeve dhe kërcënimeve ndaj sistemit financiar shqiptar dhe infrastrukturës së tij, si dhe vlerësimin për aftësinë e sistemit për t'i përthithur këto rreziqe.

Raportet i janë dërguar Kuvendit, Këshillit të Ministrave dhe institucioneve të tjera qendrore.



2. VEPRIMTARIA E BANKËS SË SHQIPËRISË

2.1. POLITIKA MONETARE

Në përputhje me Ligjin “Për Bankën e Shqipërisë”, politika monetare formulohet dhe zbatohet në funksion të arritjes dhe ruajtjes së stabilitetit të çmimeve. Stabiliteti i çmimeve përkufizohet si një rritje vjetore e indeksit të çmimeve të konsumit prej 3% në afatin e mesëm. Nëpërmjet përmbushjes së këtij objekti, Banka e Shqipërisë kontribuon në zhvillimin e qëndrueshëm të ekonomisë, në promovimin e stabilitetit financiar dhe në rritjen e mirëqenies së shoqërisë shqiptare.

Vendimet e politikës monetare merren nga Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë, bazuar në një kuadër modern analize dhe parashikimi. Ky kuadër shfrytëzon të gjithë spektrin e informacionit të disponueshëm, mbështetet në modele bashkëkohore ekonometrike dhe reflekton praktikën më të mira të bankave qendrore. Për më shumë informacion mbi objektivat, parimet dhe strategjinë e politikës monetare, mund të konsultoni Dokumentin e Politikës Monetare. Ndërkohë, Raportet e Politikës Monetare ofrojnë një analizë të plotë të situatës ekonomike dhe financiare në vend, parashikimet për të ardhmen, qëndrimin e politikës monetare, si dhe kontributin e saj në zhvillimin ekonomik.

Politika monetare e Bankës së Shqipërisë vijon të jetë e orientuar drejt ruajtjes së stabilitetit të çmimeve, si parakusht për zhvillimin e qëndrueshëm të ekonomisë dhe për rritjen e mirëqenies së shoqërisë.

Gjatë vitit 2025, Banka e Shqipërisë ndoqi një politikë monetare të kujdesshme dhe me kah lehtësues. Ky qëndrim ndihmoi në kontrollin e inflacionit në nivele të ulëta, ruajti fuqinë blerëse të familjeve, uli pasigurinë në tregjet financiare, nxiti rritjen e kreditimit, si dhe mundësoi ruajtjen e trendeve pozitive të rritjes e zhvillimit. Rritja e aktivitetit ekonomik u shoqërua me rritje të punësimit dhe të pagave në sektorin privat jobujqësor, ndërkohë që përmirësimi i ekuilibrave të brendshëm dhe të jashtëm të vendit forcoi qëndrueshmërinë makroekonomike.

2.1.1 POLITIKA MONETARE GJATË VITIT 2025

Hartimi dhe zbatimi i politikës monetare gjatë vitit 2025 mori jetë në një kontekst sfidues zhvillimesh të brendshme e të jashtme. Megjithatë, monitorimi i vazhdueshëm i dinamikave të inflacionit dhe faktorëve që ndikojnë në të, i treguesve të aktivitetit ekonomik, si dhe i zhvillimeve monetare dhe tregjeve



financiare, mundësoi një kalibrim të mirë të normës bazë të interesit me objektivin e inflacionit.

Në mjedisin ndërkombëtar, rritja ekonomike rezultoi më e mirë se parashikimet fillestare, ndonëse rritja ekonomike e partnerëve tanë kryesorë tregtarë mbeti e moderuar. Konfliktet tregtare dhe tensionet gjeopolitike ishin një burim madhor pasigurie në arenën ndërkombëtare, por intensiteti i tyre erdhi në zbehje gjatë gjysmës së dytë të vitit. Inflacioni botëror ndoqi një trend rënës, i ndikuar – ndër të tjera – nga rënia e çmimeve të lëndëve të para energjetike dhe të produkteve ushqimore. Në këto rrethana, bankat qendrore kryesore lehtësuan qëndrimin e politikës monetare, duke përmirësuar kushtet financiare globale. Në tërësi, zhvillimet ndërkombëtare gjatë vitit 2025 mbështetën rritjen e eksporteve të turizmit, reduktuan presionet mbi çmimet, si dhe ndihmuan në lehtësimin e kushteve financiare në Shqipëri.

Në mjedisin e brendshëm, rritja ekonomike dhe rritja e punësimit dhe e pagave në sektorin privat jobuqësor mbetën në nivele relativisht të larta, ndërkohë që inflacioni mbeti nën objektiv si pasojë e goditjeve pozitive të ofertës. Vëllimi i aktivitetit ekonomik u rrit me 3.7% gjatë tre tremujorëve të parë të vitit, i mbështetur nga rritja e konsumit, e investimeve dhe e eksportit të shërbimeve. Rritja e kërkesës së brendshme pasqyroi rritjen e të ardhurave të bizneseve dhe familjeve, besimin për të ardhmen, si dhe kushtet e favorshme financiare, ndërsa rritja e eksportit të shërbimeve pasqyroi rritjen e të ardhurave nga turizmi. Nga ana tjetër, politika fiskale vijoi të ruajë një natyrë konsoliduese, ndërsa eksporti i mallrave shënoi rënie, si pasojë e koniunkturës së pafavorshme globale dhe e problemeve specifike sektoriale.

Rritja ekonomike u reflektua në përmirësimin e tregut të punës. Gjatë tre tremujorëve të parë të vitit, papunësia ra në nivelin 8.1%, punësimi në sektorin privat jobuqësor u rrit me 4.7%, ndërsa pagat në sektorin privat u rritën me 9.4%. Në tërësi, tregu i punës vijoi të shfaqë disbalanca midis kërkesës dhe ofertës për punë gjatë vitit 2025, disbalanca të cilat ushtrojnë presion për rritje të shpejtë të pagave.

Inflacioni i çmimeve të konsumit qëndroi në nivelin mesatar 2.2%, duke rezultuar i pandryshuar nga një vit më parë. Kjo qëndrueshmëri pasqyroi rënie të inflacionit të ushqimeve të papërpunuara dhe rritjen e inflacionit të qirave, të disa shërbimeve të lidhura me turizmin dhe të naftës, ndërkohë që inflacioni i artikujve të tjerë të shportës shfaqti luhatje të vogla.

Në aspektin makroekonomik, ecuria e inflacionit pasqyroi reduktimin e presioneve me origjinë të huaj dhe natyrë afatshkurtër dhe rritjen e lehtë të presioneve me origjinë të brendshme dhe natyrë më të qëndrueshme. Presionet e huaja u dobësuan si pasojë e rënies së inflacionit të mallrave bazë në tregjet globale dhe të mallrave të konsumit në tregjet partnere, si dhe e forcimit të kursit të këmbimit të Lekut. Presionet e brendshme inflacioniste u rritën në segmentin e tregut të qirave të banesave, por mbetën relativisht të



qëndrueshme dhe në përputhje me objektivin e inflacionit në segmentet e tjera. Dinamika e presioneve të brendshme u mbështet nga një balancë më e mirë e kërkesës dhe ofertës në tregjet e produkteve dhe shërbimeve, si dhe nga pritjet e ankoruara për inflacionin. Nga ana tjetër, ndikimi i rritjes së pagave dhe të kostove të punës në inflacion u amortizua pjesërisht nga përmirësimi i produktivitetit dhe pjesërisht nga ngushtimi i marzhit të fitimit të bizneseve.

Treguesit e tjerë të ekuilibrave të brendshëm dhe të jashtëm u përmirësuan, duke forcuar stabilitetin makroekonomik dhe duke rritur rezistencën e ekonomisë ndaj goditjeve. Ky përmirësim pasqyroi rritjen e qëndrueshme ekonomike, stabilitetin monetar e financiar, konsolidimin fiskal dhe përmirësimin e bilancit të shkëmbimeve tregtare e financiare me jashtë. Gjatë tre tremujorëve të parë të vitit, llogaria korrente kaloi – për herë të parë në historinë post-tranzicion – në suficit, të vlerësuar rreth nivelit 0.3% të PBB-së. Në të njëjtën kohë, borxhi publik dhe ai i jashtëm i vendit u reduktuan, duke arritur respektivisht nivelet 52.8% dhe 38.9% të PBB-së, ndërsa rezervat valutore arritën në 7.3 miliardë euro në fund të vitit. Po ashtu, bizneset dhe familjet shqiptare shfaqën bilance likuide, sektori bankar mbeti i shëndetshëm dhe cilësia e portofolit të kredisë vijoi të përmirësohet, me raportin e kredive me probleme që zbriti në 3.8%.

Në këtë kontekst zhvillimesh, Banka e Shqipërisë ndërmori një lehtësim të mëtejshëm të qëndrimit të politikës monetare gjatë vitit 2025. Ky lehtësim u materializua nëpërmjet uljes së normës bazë të interesit në nivelin 2.5% në muajin korrik dhe rritjes së blerjeve të valutës në tregun e brendshëm. Këto masa kontribuuan në uljen e kostove të financimit për familjet e bizneset dhe në zbutjen e shpejtësisë së forcimit të Lekut. Në të njëjtën kohë, reagimi në kohë ndaj luhatjeve të inflacionit siguroi ancorimin e pritjeve për inflacionin pranë objektivit 3%.

Kushtet më të mira të financimit u pasqyruan në një rritje të shpejtë të kreditimit, duke mundësuar zgjerimin e konsumit dhe të investimeve private. Kredia për sektorin privat u rrit me 14.4% gjatë vitit 2025, e mbështetur kryesisht nga rritja e shpejtë e kredisë në Lekë dhe e kredisë për biznese me destinacion investimi. Kredia në Lekë përbën rreth 58% të portofolit të kredisë në fund të vitit 2005, duke shfaqur rritje të mëtejshme të peshës specifike, në interes të përmirësimit të transmetimit të politikës monetare dhe të forcimit të stabilitetit financiar. Ndërkohë, rritja e kredisë për qëllime investimi sinjalizon një proces të vazhdueshëm zgjerimi dhe modernizimi të kapaciteteve prodhuese të ekonomisë, duke mbështetur rritjen potenciale të ekonomisë dhe përmirësimin e konkurrueshmërisë së saj në afat të mesëm e të gjatë.

Perspektiva ekonomike paraqitet pozitive. Ekonomia shqiptare pritet të ruajë një ritëm solid rritjeje gjatë viteve të ardhshme, të përafërt me potencialin e saj, ndërsa inflacioni parashikohet të kthehet gradualisht drejt objektivit gjatë vitit 2026.




Megjithatë, rreziqet mbeten të pranishme dhe balanca e tyre kërkon vëmendje të vazhduar. Në ambientin e huaj, pasiguritë gjeopolitike, fragmentimi i tregjeve dhe luhatjet e çmimeve ndërkombëtare, pritet të vijojnë të përbëjnë burime pasigurie, me potencial për të gjeneruar goditje të reja mbi inflacion. Në ambientin e brendshëm, trendet e pafavorshme demografike mund të kufizojnë potencialin e rritjes, përmes tkurrjes së forcës së punës dhe presioneve mbi produktivitetin, si dhe të dëmtojnë qëndrueshmërinë e skemës së pensioneve dhe të reduktojnë hapësirat fiskale. Adresimi i këtyre sfidave kërkon politika të kujdesshme dhe reforma të mëtejshme strukturore.


Banka e Shqipërisë do të vijojë të ndjekë një politikë monetare të kujdesshme, të balancuar dhe koherente, gjithmonë në funksion të objektivit parësor: ruajtjes së stabilitetit të çmimeve. Ky është një parakusht themelor për rritje të qëndrueshme, për mbrojtjen e fuqisë blerëse të familjeve dhe për nxitjen e investimeve afatgjata.

Politika monetare e Bankës së Shqipërisë do të vijojë të ankorohet në regjimin e shënjestrimit të inflacionit dhe të kursit të lirë të këmbimit, si dhe do të zbatohet nëpërmjet instrumenteve indirekte, të cilat janë përputhje me parimet e tregut të lirë. Vendimmarrja e saj do të vijojë të mbështetet në një aparat të konsoliduar analize dhe parashikimi, i cili përmirësohet vazhdimisht, përmes zgjerimit të bazës së të dhënave, zhvillimit të analizave të thelluara mbi çështje specifike dhe forcimit të kapaciteteve modeluese e parashikuese. Gjithashtu, Banka e Shqipërisë do të vijojë të punojë për një konvergencë të plotë të kuadrit dhe praktikave të politikës monetare me standardet e Sistemit Evropian të Bankave Qendrore.

Grafik 1. Ecuria e inflacionit, atij bazë dhe e pritjeve afatmesme (majtas); norma bazë e interesit (djathtas)



Burimi: INSTAT dhe Banka e Shqipërisë.



HAPËSIRË INFORMUESE 1

ECURIA E KURSIT TË KËMBIMIT DHE REAGIMI I BANKËS SË SHQIPËRISË

Ecuria e kursit të këmbimit të Lekut gjatë viteve të fundit ka qenë në qendër të vëmendjes së Bankës së Shqipërisë. Në horizontin kohor 2021-2025, raporti i këmbimit të Lekut ndaj Euros në tregun e brendshëm u forcua me 21%. Pjesa më e madhe e këtij forcimi, ose rreth 75% e tij, ndodhi gjatë viteve 2023 dhe 2024. Ndërkohë, ritmi i forcimit ra në 2.8% gjatë vitit 2025, falë dhe rritjes së pranisë së Bankës së Shqipërisë në tregun valutor gjatë dy viteve të fundit.

Natyrisht, ky forcim i shpejtë i kursit ka sjellë diskutime të shumta mbi arsyet, pasojat dhe reagimin e Bankës së Shqipërisë ndaj tij. Kjo hapësirë informuese, e cila pason komunikimet tona në raportet e mëparshme vjetore*, synon të japë në mënyrë të përmbledhur këndvështrimin e Bankës së Shqipërisë mbi këto çështje.

Arsyet e forcimit të kursit të këmbimit

Vlerësimet dhe analizat tona konkludojnë se trendi forcues i kursit të këmbimit të Lekut është diktuar – në masën më të madhe – nga përmirësimi i bilancit të shkëmbimeve ekonomike, tregtare e financiare me jashtë, si dhe nga reduktimi i primeve të rrezikut në tregun e brendshëm financiar. Këto përmirësime kanë sjellë një rritje të ofertës së valutës në tregun e brendshëm valutor dhe – në prani të një regjimi të lirë të kursit të këmbimit – janë pasqyruar në forcimin e kursit të këmbimit të Lekut.


Më konkretisht, të dhënat e bilancit të pagesave sugjerojnë se:

- Eksportet totale shqiptare janë rritur nga 4.7 miliardë euro në vitin 2021, në 9.8 miliardë euro në katër tremujorët e fundit që mbarojnë në T3-2025, një rritje kjo prej rreth 108.5%. Rolin kryesor në këtë drejtim e kanë pasur të ardhurat nga turizmi, të cilat janë rritur nga 1.9 miliardë euro në vitin 2021, në 5.5 miliardë euro në katër tremujorët e fundit që mbarojnë në T3-2025.
- Po ashtu, remitancat dhe të ardhurat nga puna sezonale e shqiptarëve jashtë vendit janë rritur nga 1.1 miliardë euro në vitin 2021, në 1.8 miliardë euro në katër tremujorët e fundit që mbarojnë në T3-2025, me një rritje mesatare vjetore prej 14.6%.
- Për rrjedhojë, raporti i deficitit tregtar dhe atij të llogarisë korrente ndaj PBB-së është reduktuar me rreth 7 pikë përqindjeje (respektivisht nga 7.7% dhe 13.4% të PBB-së në vitin 2021, në 1.2% dhe 5.8% të PBB-së në katër tremujorët e fundit që mbarojnë në T3-2025).
- Nga ana tjetër, investimet e huaja direkte (IHD) kanë shënuar rritje të vazhdueshme. IHD-të hyrëse u rritën nga 1.0 miliardë euro në vitin 2021, në 1.6 miliardë euro në katër tremujorët e fundit që mbarojnë në T3-2025, me një rritje mesatare vjetore prej 12.2%. Në terma kumulativë, ato kanë qenë rreth 2.5 herë më të larta se deficitin i llogarisë korrente, çka ka bërë që bilanci i pagesave (bilanci i hyrjeve dhe daljeve të valutës në vend) të rezultojë me suficit.

Në të njëjtën kohë, rritja e besimit në monedhën kombëtare dhe përmirësimi i shkallës së rrezikut të borxhit sovran të vendit janë shoqëruar me një rritje të preferencës për kursime në monedhën kombëtare. Po ashtu, analiza e informacionit mbi tregun valutor evidenton një lidhje të fortë dhe të qëndrueshme ndër vite mes transaksioneve në këtë treg dhe vëllimit të shkëmbimeve tregtare me jashtë. Në dekadën e fundit, vëllimet e tregtimit përbëjnë rreth 70% të totalit



të tregtisë së jashtme në mallra dhe shërbime, ndërsa korrelacioni ndërmjet dy treguesve arrin deri në 96%.



Bazuar në këto analiza, forcimi i kursit të këmbimit të Lekut përfaqëson një fenomen strukturor, për sa kohë dhe në masën që përmirësimi i bilancit të pagesave dhe reduktimi i primeve të rrezikut në tregun financiar vlerësohen të jenë të qëndrueshëm.

Pasojat e forcimit të kursit të këmbimit

Përmirësimet strukturorë që kanë diktuar forcimin e kursit të këmbimit janë pasqyruar në forcimin jo vetëm të kursit nominal, por edhe atij real të këmbimit. Në vija të përgjithshme, forcimi i këtij të fundit ilustron një konvergjencë më të shpejtë të të ardhurave dhe të çmimeve të ekonomisë shqiptare me partnerët tanë tregtarë të Bashkimit Evropian.

Ky ritëm më i shpejtë konvergjence është i qëndrueshëm për sa kohë ai bazohet në rritjen e produktivitetit të ekonomisë shqiptare dhe reduktimin e primeve të rrezikut në tregun e brendshëm financiar. Të dyja këto fenomene kanë qenë të pranishme gjatë viteve të fundit. Në veçanti, zhvendosja e fuqisë punëtore drejt sektorit të turizmit dhe shërbimeve të lidhura me të, sektorë të cilët janë në gjendje të paguajnë paga krahasimisht të larta, ilustron një rritje të produktivitetit të përgjithshëm të punës në ekonomi. Po ashtu, toleranca që investitorët vendas kanë shfaqur ndaj niveleve relativisht të ulëta të normave të interesit në Lekë, si dhe rritja e interesit të investitorëve të huaj për të investuar në tregjet financiare shqiptare, janë dëshmi e primeve më të ulëta të rrezikut në to. Këto dy konkluzione mbështeten edhe nga rezultatet e modeleve tona empirike, të bazuara mbi teoritë konvencionale të përcaktuesve të kursit të këmbimit, si pariteti i pambuluar i normave të interesit apo pariteti i fuqisë blerëse. Këto konkluzione sugjerojnë se forcimi i kursit të këmbimit bazohet në faktorë strukturorë dhe pasqyron një lëvizje më të shpejtë konverguese të ekonomisë shqiptare, të paktën në afatin e shkurtër dhe të mesëm.

Forcimi i kursit real të këmbimit mund të akomodohet në tri mënyra: (i) një inflacion më i lartë se partnerët e bashkimit Evropian; (ii) një forcim i kursit nominal të këmbimit; ose, (iii) një kombinim i dy mekanizmave të mësipërm.**



Bankat qendrore, të cilat kanë si objektiv primar inflacionin dhe zbatojnë një regjim të lirë të kursit të këmbimit, zgjedhin alternativën e dytë, duke i njohur kursit nominal të këmbimit rolin e stabilizatorit automatik dhe duke i mundësuar politikës monetare të fokusohet në objektivin e inflacionit. Po ashtu, duhet theksuar se bankat qendrore nuk disponojnë asnjë instrument, i cili të ofrojë zgjidhje të targetuara për pasojat negative që forcimi i kursit të këmbimit mund të sjellë në sektorë specifike të ekonomisë apo segmente të ndryshme të shoqërisë, pa dëmtuar objektivin e saj primar të inflacionit apo aktivitetin ekonomik dhe mirëqenien e shoqërisë në tërësi.

Gjithsesi, FMN-ja*** identifikon tre rrethana në të cilat ndërhyrja e bankës qendrore në tregun valutor mund të jetë e justifikuar, edhe në prani të një regjimi të lirë të kursit të këmbimit: (i) kur tregu valutor është i cekët ose përkohësisht jolikuid, çka mund ta shmangë nivelin e kursit të këmbimit nga fundamentet; (ii) kur agjentët ekonomikë kanë detyrime financiare (kredi) të pambrojtura në valutë, çka mund të rrezikojë stabilitetin financiar; dhe (iii) kur rrezikohet ankorimi i pritjeve për inflacionin, çka mund të dëmtojë stabilitetin e çmimeve. Në gjykimin tonë, rrethana e parë është verifikuar vetëm në periudha specifike dhe mjaft të shkurtra kohe, por mbetet teorikisht e mundur në momente të lëvizjeve të forta dhe të shpejta të kursit; rrethana e dytë nuk është relevante në rastin e forcimit të kursit; ndërsa, rrethana e tretë mbetet potencialisht relevante në rastin e lëvizjeve të forta të kursit.

Reagimi i Bankës së Shqipërisë


Reagimi i Bankës së Shqipërisë ndaj forcimit të kursit të këmbimit është informuar nga analizat dhe konsideratat e mësipërme. Në tërësi, Banka e Shqipërisë ka respektuar regjimin e lirë të kursit të këmbimit, duke mundësuar absorbimin e presioneve inflacioniste, të cilat vinin nga: (i) rritja e shpejtë e çmimeve në tregjet ndërkombëtare (periudha 2022-2023), dhe (ii) rritja e shpejtë e pagave dhe e kërkesës për shërbime (periudha 2023-2024).

Në këto rrethana, Banka e Shqipërisë kreu vetëm ndërhyrje të vogla dhe të kufizuara në kohë në tregun valutor gjatë periudhës 2022-2023. Forcimi i kursit nominal gjatë kësaj periudhe evitoi nevojën për rritje të fortë të normës bazë të interesit dhe bëri të mundur që inflacioni në vend të shënonte norma më të ulëta se në ekonominë e rajonit dhe të Eurozonës, dhe të kthehej më shpejt e me kosto më të ulët në objektiv. Vlerësimet tona ekonometrike sugjerojnë se ndjekja e opsionit të kundërt - ndërhyrjes për të ruajtur një nivel të caktuar të kursit të këmbimit - do të kishte pasojat negative në ekonomi. Më konkretisht, në një skenar hipotetik ku kursi i këmbimit kundrejt Euros do të mbahej fiks gjatë periudhës 2023-2025 (në nivelin e tremujorit të parë të vitit 2023, apo 115.5 lekë/euro):

- Norma e inflacionit do të rritej deri në intervalin 6.0% – 7.0% në periudhën 2024-2025, nga niveli mesatar faktik prej 2.2% i kësaj periudhe.
- Këto nivele inflacioni do të kërkonin rritjen e normës bazë deri në nivelin 7%, çka do të ishte një shtrëngim i qenësishëm i politikës monetare dhe do të impononte një kosto të lartë mbi huamarrësit.
- Shtrëngimi i kushteve financiare do të frenonte kërkesën agregate, duke e ulur rritjen ekonomike deri në 2.6%, nga 3.9% që ka qenë aktualisht.
- Ngadalësimi ekonomik do të rriste me 1.2 pp normën e papunësisë për vitin 2005, duke e çuar atë në nivelin mesatar prej 9.7%, dhe duke shkaktuar vështirësi financiare për bizneset dhe individët. Po ashtu, raporti i kredive me probleme të bizneseve do të rritej me pothuaj 3 pp, duke kërcyer nga niveli 4.6% në 7.5%.



Grafik 3. Efekti në inflacion dhe normë bazë të interesit në kushtet e mbajtjes së kursit fiks 115.5 lek/eur



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Nga ana tjetër, ndryshimi i koniunkturës ekonomike në periudhën 2024-2025 krijoi hapësira për një prani të shtuar të Bankës së Shqipërisë në tregun valutor. Më konkretisht, rënia e inflacionit nën objektiv në këtë periudhë, si pasojë e goditjeve të ofertës në çmimet e mallrave bazë dhe të naftës, rriti rreziqet potenciale që një forcim i shpejtë dhe i mtejshëm të kursit të këmbimit mund të kishte mbi stabilitetin monetar. Në këtë kontekst, një prani më aktive e Bankës së Shqipërisë në treg u konsiderua e nevojshme si masë mbrojtëse ndaj rrezikut - me probabilitet të ulët, por me kosto të lartë - të shmangies së kursit nga fundamentet (kushti i parë), duke reduktuar njëkohësisht edhe rrezikun potencial të dizankorimit të pritjeve për inflacionin nga objektivi (kushti i tretë).

Në përgjigje të këtyre zhvillimeve dhe në përputhje me mandatin e saj për stabilitetin e çmimeve, Banka e Shqipërisë rriti praninë në tregun valutor. Ndërhyrjet tona në këtë treg nuk kanë synuar dhe nuk synojnë mbajtjen e kursit në një nivel të caktuar, por zbutjen e shpejtësisë së forcimit të tij, në funksion të reduktimit të rreziqeve që luhatjet e larta të kursit në tregun valutor mund të kenë mbi stabilitetin monetar e financiar dhe në funksion të ancorimit më të mirë të pritjeve inflacioniste.

Në përmbledhje, regjimi i kursit të këmbimit i ndjekur nga Banka e Shqipërisë dhe përfaqësja e saj ndaj forcimit të Lekut në vitet e fundit i kanë mundësuar vendit një rritje ekonomike të lartë, të qëndrueshme dhe joinflacioniste. Kuadri analitik dhe teorik i paraqitur më sipër do të vijojë të orientojë politikën monetare edhe në periudhën e ardhshme.

* Shih për shembull Hapësirën Informuese 3 në Raportin Vjetor 2024 dhe Hapësirën Informuese 2 në Raportin Vjetor 2023.

** Për një diskutim më të zgjeruar, shiko Hapësirën Informuese 3 në Raportin Vjetor 2024.


*** Integrated Policy Framework – Principles for the use of foreign exchange intervention, 2023, i aksesueshëm në lidhjen: <https://www.imf.org/en/publications/policy-papers/issues/2023/12/20/integrated-policy-framework-principles-for-the-use-of-foreign-exchange-intervention-542881>



2.1.2 ECURIA E AKTIVITETIT EKONOMIK

Aktiviteti ekonomik u zgjerua më tej gjatë vitit 2025, i mbështetur nga bilanci e shëndosha financiare dhe pritjet pozitive të sektorit privat, rritja e të ardhurave nga turizmi, si dhe nga mjedisi mbështetës i politikave ekonomike. Këta faktorë u pasqyruan në rritjen e konsumit, investimeve dhe eksporteve të shërbimeve, duke ruajtur një kontribut pozitiv të kërkesës së brendshme dhe asaj të jashtme në aktivitetin ekonomik.

Produkti i Brendshëm Bruto (PBB) u zgjerua me 3.7% gjatë nëntë muajve të parë të vitit 2025, duke shënuar një ngadalësim të lehtë krahasuar me vitin paraardhës. Në aspektin sektorial, rritja ekonomike u mbështet nga zgjerimi i sektorëve të shërbimeve dhe të ndërtimit, ndërsa aktiviteti bujqësor dhe ai industrial u tkurrën. Ritmi i rritjes ekonomike u ngadalësua në krahasim me një vit më parë, kryesisht si pasojë e zgjerimit më të moderuar të aktivitetit ndërtues.



Sektori i shërbimeve kontribuoi me rreth 3.2 pikë përqindje në rritjen ekonomike të tre tremujorëve të parë, i ndikuar kryesisht nga zgjerimi i aktivitetit në degët “Administrata publike, arsimit dhe shëndetësia”, “Pasuritë e paluajtshme”, si dhe “Informacioni dhe komunikimi”. Nga ana tjetër, **sektori prodhues** dha një kontribut negativ me rreth 0.4 pikë përqindje, i ndikuar nga rënia me 1.9% e **aktivitetit bujqësor** dhe me 3.7% e **aktivitetit industrial**. Rënia e këtij të fundit u ndikua më së shumti nga industria nxjerrëse, dhe – në një masë më të vogël – nga ajo përpunuese. **Sektori i ndërtimit** vijoi të japë kontribut pozitiv në rritjen e aktivitetit ekonomik, por ritmi i rritjes paraqitet i ngadalësuar krahasuar me atë të vitit 2024.



Tabelë 1. Rritja reale dhe kontributet sektoriale (në pikë përqindje)

	2020	2021	2022	2023	2024	2025T1	2025T2	2025T3
Bujqësia	0.3	-0.3	-0.9	-0.2	-0.3	-0.4	-0.3	-0.3
Industria, energjia, uji	-0.9	0.7	0.3	-0.4	-0.7	-0.5	-0.2	-0.5
Ndërtimi	0.2	1.2	1.5	0.6	0.5	0.2	0.3	0.5
Shërbimet	-1.8	4.3	3.3	3.5	3.1	3.3	3.0	3.2
Taksat neto	-1.2	3.1	0.5	0.5	1.4	1.2	0.9	0.8
Rritja reale (në %)	-3.3	9.0	4.8	4.0	4.0	3.8	3.6	3.7


Burimi: INSTAT dhe Banka e Shqipërisë.

Në aspektin e kërkesës agregate, rritja ekonomike pasqyrozi zgjerimin e kërkesës së brendshme dhe të huaj për mallra e shërbime. Kërkesa e brendshme u rrit me 4.3%, e mbështetur nga rritja e konsumit dhe e investimeve, si të sektorit privat dhe të atij publik. Megjithatë, rritja e konsumit privat u ngadalësua, duke ndikuar në moderimin e normës së përgjithshme të rritjes, ndërkohë që kontributi i shpenzimeve publike u rrit dhe ai i investimeve private mbetet i ngjashëm me atë të vitit paraardhës.

Konsumi privat u rrit me 2.6% gjatë tre tremujorëve të parë të vitit, i mbështetur nga rritja e të ardhurave të disponueshme, besimi i përmirësuar i konsumatorëve, si dhe kushtet e favorshme financiare. Të ardhurat e familjeve u rritën si pasojë e rritjes së punësimit dhe pagave, ndërsa normat e ulëta të inflacionit ndihmuan në ruajtjen e fuqisë blerëse. Gjithashtu, zgjerimi i kredisë bankare kontribui pozitivisht në financimin e shpenzimeve për mallra dhe shërbime.


Investimet totale u rritën me 4.5% gjatë tre tremujorëve të parë të vitit, të mbështetura nga rritja e kërkesës agregate, nivelet e larta të besimit të biznesit, si dhe kushtet e favorshme të financimit dhe rritja e kredisë bankare.

Grafik 5. Ndryshimi vjetor e kërkesës së brendshme sipas komponentëve (pikë përqindje)




Burimi: INSTAT dhe Banka e Shqipërisë.


Grafik 6. Ecuria e konsumit dhe e investimeve (ndryshim vjetor, %)



Burimi: INSTAT dhe Banka e Shqipërisë.



Grafik 7. Kontributi i eksportit dhe importit në rritjen ekonomike (në pikë përqindje)



Burimi: INSTAT dhe Banka e Shqipërisë.

Kërkesa e huaj neto kontribuoi me 1.2 pikë përqindje në rritjen ekonomike të tre tremujorëve të parë të vitit, duke reflektuar përmirësimin e bilancit të shkëmbimeve me jashtë. Deficiti tregtar u ngushtua me 21.4% në terma realë, si pasojë e rritjes së shpejtë të eksporteve të shërbimeve. Eksportet e mallrave dhe shërbimeve u rritën me 6.1% në terma realë, duke pasqyruar rritjen me 9.9% të eksportit të shërbimeve dhe rënien me 10.7% të eksportit të mallrave. Nga ana tjetër, importet u rritën me 2.6% në terma realë, të ndikuara nga rritja me 9% e importit të shërbimeve, e kryesisht atyre të lidhura me turizmin, dhe rënia me 0.6% e importit të mallrave.

Të dhënat e tregtisë së jashtme, të raportuara nga INSTAT-i për vitin 2025, treguan zgjerimin me 3% të deficitit tregtar në mallra, zgjerim ky më i ngadalë


se ai i vitit paraardhës (18.8%). Si eksporti dhe importi i mallrave u zvogëluan në terma nominalë, duke reflektuar kryesisht rënien e çmimeve të tyre në tregjet e huaja, ndërkohë që të dhënat e sasive shfaqën rënien e një baze më të ngushtë grup-mallrash.

Eksportet e mallrave u pakësuan me 6.1% gjatë vitit 2025, normë kjo më e moderuar krahasuar me rënien prej 14.3% të regjistruar një vit më parë. Rënia e eksporteve pasqyroi kryesisht ecurinë e kategorive “Materiale ndërtimi dhe metale” dhe “Minerale, lëndë djegëse, energji elektrike” (Grafik 8, majtas). Ecuria në rënie e tyre pasqyroi problemet specifike të degëve përkatëse, probleme të cilat vazhdojnë prej vitit 2024 dhe kanë prekur prodhimin dhe eksportin e gizës e çelikut, dhe të naftës bruto, si dhe kushtet e pafavorshme të motit, të cilat reduktuan prodhimin dhe eksportin e energjisë elektrike.

Importet e mallrave u tkurrën me 0.8%, duke reflektuar ecuri me kahe të kundërta ndërmjet grup-mallrave kryesore (Grafik 8, djathtas). Rritja e importeve në kategoritë “Minerale, lëndë djegëse, energji elektrike” dhe “Ushqime, pije dhe duhan” u tejkalua nga rënia e importeve për “Makinëri, pajisje dhe pjesë këmbimi” dhe “Materiale ndërtimi dhe metale”. Si rrjedhojë, bilanci i këtyre zhvillimeve rezultoi në një tkurrje të lehtë të importeve.

Politika fiskale vijoi të shfaqë tipare konsoliduese gjatë vitit 2025, të pasqyruara në krijimin e suficiteve primare për të tretin vit radhazi. Megjithatë, intensiteti i konsolidimit fiskal gjatë vitit 2025 ishte më i ulët nga një vit më parë, duke krijuar kështu impuls fiskal pozitiv, të vlerësuar në 0.2 pikë përqindje të PBB-së. Ndikimi pozitiv i politikës fiskale mbi kërkesën agregate erdhi kryesisht si pasojë e investimeve publike më të larta nga një vit më parë.


Grafik 8. Ndryshimet vjetore të eksporteve dhe importeve të mallrave me kontributet e kategorive kryesore



Burimi: INSTAT dhe llogaritjet e Bankës së Shqipërisë.
Shënim: Kontributet e kategorive kryesore në tregtinë e mallrave, në pikë përqindje.

Deficiti buxhetor rezultoi rreth nivelit 1.8% të PBB-së, nga 0.7% një vit më parë. Ndonëse deficiti ishte më i lartë në terma vjetorë, vlera e tij prej 47 miliardë lekësh ishte nën nivelin e planifikuar (61.6 miliardë lekë).

Grafik 9. Impulsi fiskal dhe natyra e politikës fiskale*




Burimi: Ministria e Financave, INSTAT dhe llogaritjet e stafit të Bankës së Shqipërisë.

*Për detajet metodologjike, referojuni hapësirës informuese "Mbi natyrën e politikës fiskale" në Raportin Vjetor të BSH-së për vitin 2017. Impulsi fiskal i paraqitur në boshtin vertikal, vlerësohet si diferencë e deficitit primar të korrigjuar për ciklet e biznesit dhe masat e njëkohshme, nga nivelet e një viti më parë.

Shpenzimet buxhetore të vitit 2025 rezultuan rreth nivelit 802 miliardë lekë, ose afërsisht 30.2% të PBB-së. Në krahasim me një vit më parë, shpenzimet u zgjeruan me rreth 10%. Ndikimin kryesor në rritjen e shpenzimeve e dhanë shpenzimet për fondin e sigurimeve sociale (2.5 pikë përqindje), si pasojë e peshës së lartë që ky zë ka në totalin e shpenzimeve. Po ashtu, investimet publike dhanë një ndikim pozitiv prej rreth 2.2 pikësh përqindje, ndërsa rritja e pagave në sektorin publik kontribuoi me 1.8 pikë përqindje në rritjen e shpenzimeve buxhetore totale.





Të ardhurat fiskale arritën një nivel prej 755 miliardë lekësh, ose rreth 28.4% e PBB-së, duke shënuar një rritje vjetore prej 6.2%. Ritmi i rritjes së të ardhurave u ngadalësua në vitin 2025, kryesisht si pasojë e efektit bazë nga të ardhurat me karakter jotatimor¹. Nga ana tjetër, zërat tatimorë vijuan të japin kontribute pozitive në zgjerimin e të ardhurave, ku spikatën të ardhurat nga sigurimet sociale (2.5 pikë përqindje), tatimi mbi të ardhurat personale (2.3 pikë përqindje) dhe TVSH-ja (1.9 pikë përqindje).


Deficiti buxhetor u financua nga burime të brendshme. Rolin kryesor në financimin e deficitit e mbarti shtesa me rreth 49.3 miliardë lekë e huamarrjes në tregun brendshëm të titujve qeveritarë. Kjo shtesë konsistoi vetëm në tituj borxhi afatgjatë, të cilët kompensuan dhe reduktimin e huamarrjes në tituj afatshkurtër, në përputhje me Strategjinë Afatmesme të Menaxhimit të Borxhit Publik. Baza e investitorëve në tituj qeveritarë ishte thujtë e ngjashme me një vit më parë. Sistemi bankar mbetet zotëruesi kryesor i borxhit të brendshëm të qeverisë, duke mbajtur rreth 61% të tij. Individët gjatë vitit 2025 kanë ruajtur të njëjtën sasi titujsh me fundin e një viti më parë, duke ulur në 17% peshën në financimin e borxhit të brendshëm, nga 18% një vit më parë. Jozidentët mbanin një portofol titujsh prej rreth 20.6 miliardë lekësh në fund të vitit 2025, portofol i cili përfaqëson rreth 2.5% të totalit të borxhit të brendshëm. Në vitin 2025 u emetua Eurobondi i shtatë në tregjet ndërkombëtare, në shumën 650 milionë euro dhe me maturitet 10-vjeçar. Rreth 60% e tij u përdor për shlyerjen e pjesës së mbetur për maturim nga Eurobondi i emetuar në vitin 2018. Pjesa e mbetur e fondeve të papërdorura nga huamarrja e brendshme dhe e huaj neto u transferuan për t'u përdorur gjatë vitit 2026.

¹ Në vitin 2024 u transferuan në buxhetin e shtetit rreth 16 miliardë lekë, gjysma e të cilave i përkisnin fondit të pashpenzuar të shpronësimeve dhe pjesa tjetër lidhej me rezultatin financiar të ISSH-së. Të dy këta zëra ishin atipikë për buxhetin e shtetit dhe efekti bazë i tyre në vitin 2025 u vlerësua në rreth -1.8 pikë përqindje.



Konsolidimi fiskal u shpreh në rënie të mëtejshme të borxhit publik gjatë vitit 2025. Raporti i borxhit publik ndaj PBB-së² ra në 52.8%, nga niveli 54.2% i vlerësuar për vitin 2024. Konsolidimi fiskal kontribuoi me rreth 0.3 pikë përqindje në rënie të borxhit, ndërsa pjesa tjetër e kontributit erdhi nga rritja reale ekonomike dhe mbiçmimi i monedhës vendase kundrejt Euros, përkatësisht me 1.9 dhe 0.3 pikë përqindje. Stoku i borxhit të brendshëm u vlerësua në 31.3% të PBB-së, raport i njëjtë me fundin e një viti më parë, ndërsa stoku i borxhit të huaj u vlerësua në 21.5% të PBB-së, nga 22.9% në fund të vitit 2024.

Grafik 11. Deficiti buxhetor dhe financimi (majtas) dhe borxhi publik ndaj PBB-së (djathtas)



Burimi: Ministria e Financave, INSTAT dhe llogaritje të Bankës së Shqipërisë.

HAPËSIRË INFORMUESE 2

RIVLERËSIMI I RITJES POTENCIALE

Norma e rritjes potenciale të ekonomisë është një nga treguesit më të rëndësishëm makroekonomikë, pasi përcakton ritmin e rritjes së qëndrueshme dhe afatgjatë të vendit dhe dikton hapësirat e disponuara për rritjen e mirëqenies shoqërore. Në aspektin teorik, norma e rritjes potenciale nënkupton normën maksimale të rritjes së prodhimit që një ekonomi mund të arrijë në mënyrë të qëndrueshme, pa krijuar presione të shtuara inflacioniste. Si e tillë, ajo përbën një ekuilibër afatgjatë të rritjes së PBB-së, ku faktorët e prodhimit (puna, kapitali dhe produktiviteti i përgjithshëm) përdoren me eficiencë të plotë.

Në këndvështrimin afatgjatë, një nivel më i lartë i rritjes potenciale është premisë për një rritje më të shpejtë të të ardhurave për frymë, si dhe tenton të përmirësojë treguesit e qëndrueshmërisë fiskale dhe të pozicionit të jashtëm të vendit. Si

² Raportet ndaj PBB-së për vitin 2025 janë ndërtuar duke marrë në konsideratë publikimin e INSTAT-it për 3 tremujorët e parë dhe parashikimet e BSH-së për tremujorin e fundit të vitit.



i tillë, ai mbetet një objektiv parësor i politikave të zhvillimit, objektiv i cili ka si parakusht stabilitetin makroekonomik të vendit, por i cili mund dhe duhet të arrihet vetëm nëpërmjet reformave strukturore.

Në këndvështrimin afatshkurtër dhe afatmesëm, ritmi i rritjes potenciale shërben për orientimin e kahut dhe për kalibrimin e koordinimin e politikave monetare, fiskale dhe financiare. Këto tre politika, si instrumente për administrimin e kërkesës agregate, duhet të kujdesen që ritmi i rritjes së saj të jetë në linjë me ritmin e rritjes potenciale. Në këto rrethana, kërkesa dhe oferta agregate në ekonomi rriten me ritme të njëjta, çka nënkupton si shfrytëzim të plotë e optimal të faktorëve të prodhimit – përfshi edhe punësimin – ashtu edhe një inflacion të ulët, të qëndrueshëm dhe në linjë me objektivin.

Për këto arsye, identifikimi i ritmit të rritjes potenciale të ekonomisë shqiptare ka një vëmendje të veçantë e të vazhduar në Bankën e Shqipërisë. Ky proces realizohet rregullisht dhe në mënyrë periodike, bazuar në statistikat më të fundit të përditësuara dhe duke përdorur metoda të ndryshme vlerësimi: të grupuara në metoda statistikore dhe gjysmë-strukturore. Në rivlerësimet më të fundit (2025) janë përdorur seritë e llogarive kombëtare të PBB-së dhe nën-komponentëve të prodhimit dhe kërkesës agregate. Këto seri kanë përjetuar rishikime të rëndësishme metodologjike (INSTAT në fund të vitit 2024)**.*

Tabela e mëposhtme paraqet normat faktike të rritjes ekonomike dhe vlerësimet e rritjes potenciale sipas të gjitha metodave të aplikuara.

Tabelë 2. Rritja potenciale sipas metodave të ndryshme në vite

Periudha	Rritja faktike e PBB-së	Rritje potenciale (mesatare e gjithë metodave)
2016-2019	3.0%	3.4%
2020	-3.3%	-2.4%
2021	9.0%	9.9%
2022	4.8%	4.6%
2023	4.0%	3.6%
2024	4.0%	3.5%
2025 - Gjashtëmuaji I	3.5%	3.4%
2023-2025-GjH	3.8%	3.5%

Burimi: INSTAT dhe vlerësime të Bankës së Shqipërisë.

Tabela më sipër evidenton dy konkluzione kryesore.

- Së pari, ritmi i rritjes faktike ka qenë – përgjithësisht – në linjë dhe i përafërt me ritmin e rritjes potenciale gjatë dekadës së fundit. Kjo sugjeron se, pavarësisht goditjeve të shumta me të cilat ekonomia shqiptare është përballur gjatë kësaj periudhe, miksi i politikave monetare, fiskale dhe financiare ka arritur të mbajë nivelin e aktivitetit ekonomik pranë atij potencial, duke plotësuar një nga parakushtet kryesore të ruajtjes së ekuilibrave makroekonomikë.
- Së dyti, me përjashtim të periudhës së pandemisë, ritmi i rritjes potenciale ka qenë relativisht i qëndrueshëm gjatë kësaj periudhe, pranë nivelit 3.5%. Megjithatë, ndërmarra e reformave strukturore është e nevojshme për të gjeneruar një trend më të shpejtë konvergjence me standardet e Bashkimit Evropian. Si e tillë, ajo duhet të mbetet një objektiv i vazhdueshëm i punës, si për autoritetet publike edhe për sektorin privat.



Dekompozimi i rritjes potenciale sipas faktorëve të prodhimit: puna (P), kapitali (K) dhe produktiviteti total (PT), ofrojnë një udhëzues fillestar mbi prioritetet e këtyre reformave. Vlerësimet tona tregojnë se kontributi i faktorit punë ka ardhur në rënie gjatë kësaj periudhe, duke pasqyruar reduktimin e popullsisë totale dhe të asaj në moshë pune (sipas të dhënave nga Censi-2023). Nga ana tjetër, ky reduktim është kompensuar kryesisht nga rritja e kontributit të kapitalit dhe pjesërisht nga rritja e kontributit të produktivitetit, duke sugjeruar si një ritëm më të shpejtë të grumbullimit të kapitalit, ashtu edhe një adoptim më të shpejtë të teknologjive të reja dhe një rishpërndarje të burimeve nga bujqësia në shërbime dhe industri.

Tabelë 3. Dekompozimi i rritjes potenciale sipas faktorëve të prodhimit*

Periudha	Kontributet në rritje (pp)			Rritje potenciale (%) (metodat 1/2 strukturore)
	Puna	Kapitali	Produktiviteti T.	
2016-2019	2.00	0.90	0.40	3.30
2020	-1.48	-0.52	-0.70	-2.70
2021	2.00	5.30	2.00	9.30
2022	1.48	2.25	0.57	4.30
2023	1.49	1.32	0.60	3.40
2024	1.41	1.59	0.60	3.60
2025-Gj-I	1.30	1.61	0.59	3.50
2023-2025Gj-I	1.40	1.50	0.60	3.50

Burimi: Banka e Shqipërisë - vlerësime të autorëve.

* Rritja potenciale e përdorur në këtë rast përfshin metodën gjysmë-strukturore, si e vetmja metodë që lejon një dekompozim të tillë. Për këtë arsye, seria e rritjes potenciale e paraqitur në Tabelën 3 ndryshon nga ajo e Tabelës 2, ku rritja mesatare paraqitet si mesatare e rezultateve të të gjitha metodave në përdorim.

Rënia e kontributit të punësimit, e lidhur me trendet e pafavorshme demografike dhe procesin e emigrimit, përbën një zhvillim që kërkon vëmendje, për sa kohë ai ndikon negativisht në ritmin e rritjes potenciale. Në këtë kontekst, hartimi dhe zbatimi i reformave strukturore, të cilat targetojnë dy faktorët e tjerë, mbetet thelbësor. Së pari, këto reforma duhet të synojnë të zgjerojnë kapacitetin akumulues të kapitalit, nëpërmjet përmirësimit të mëtejshëm të klimës së biznesit dhe rritjes së atraktivitetit të vendit për investime të huaja direkte, sidomos në sektorë prodhues. Së dyti, ato duhet të synojnë të rrisin produktivitetin e ekonomisë, nëpërmjet investimeve të mëtejshme në arsim, teknologji dhe inovacion. Rritja e kontributit të këtyre dy faktorëve është esenciale për një konvergencë sa më të shpejtë e të qëndrueshme me Bashkimin Evropian.

* Për informacion të detajuar mbi metodat shihni materialin në lidhjen:

https://www.bankofalbania.org/Botime/Botime_Kerkimore/Materialet_studimore/Prodhimi_dhe_rritja_potenciale_hendeku_i_prodhimit_dhe_i_papunesise_ne_Shqiperi_analize_krahasuese_e_vleresimeve_te_reja_2015.html

** Seritë janë zgjatuar para në kohë deri në vitin 1995. Gjithashtu, INSTAT-i ka rishikuar dhe publikuar seritë e tregut të punës nga viti 2023 e në reflektim të të dhënave të Censit të Popullsisë dhe Banesave (2023). Për të mundur aplikimin e metodave vlerësuese, seritë para vitit 2023 janë vlerësuar nga stafi i BSh-së, duke u bazuar në dinamikën e raportuar nga statistikat.





2.1.3 TREGU I PUNËS

Tregu i punës vijoi të shfaqë rritje të punësimit dhe të pagave në sektorin privat jobujqësor, ndërsa papunësia mbeti pranë niveleve minimale historike. Kushtet në këtë treg mbetën përgjithësisht të shtrënguara, duke reflektuar kërkesën e lartë për punë dhe mungesa strukturore në segmente të caktuara të fuqisë punëtore.

Punësimi në sektorin privat jobujqësor u zgjerua me 4.7% gjatë tre tremujorëve të parë të vitit, i mbështetur kryesisht nga rritja me 6.9% e punësimit në sektorët e shërbimeve. Ndërkohë, rënia e punësimit në sektorin bujqësor – e shoqëruar me zhvendosjen e fuqisë punëtore drejt sektorëve të tjerë të ekonomisë – ndikoi në rënien e punësimit total, i cili rezultoi rreth 0.8% më i ulët se një vit më parë.

Norma e papunësisë qëndroi në nivelin mesatar prej 8.4% gjatë tre tremujorëve të parë të vitit, nga 8.5% në vitin 2024. Qëndrueshmëria e saj buron nga rritja e pjesëmarrjes në forcën e punës, e cila ka kompensuar rënien e punësimit në sektorin bujqësor.

Paga mesatare në sektorin privat u rrit me 9.6% gjatë nëntë muajve të parë të vitit 2025, nga 8.6% në vitin 2024. Kontributet kryesore në këtë rritje erdhën nga sektorë me paga nën mesataren e ekonomisë, kryesisht ndërtimi dhe disa degë të shërbimeve. Edhe paga reale shënoi përshejtim, duke u rritur në 7.4% për të njëjtën periudhë, nga 6.4% për gjithë vitin 2024, çka përkthehet në rritje të fuqisë blerëse të të punësuarve. Gjatë vitit 2025, bizneset raportuan si kërkesë të lartë për punë dhe mungesa në fuqinë punëtore, duke sinjalizuar kushte të shtrënguara në tregun e punës dhe presione për rritje të pagave, duke sugjeruar se kjo e fundit po përdoret si instrument për tërheqjen dhe mbajtjen e fuqisë punëtore.




2.1.4 INFLACIONI DHE FAKTORËT PËRCAKTUES TË TIJ

Inflacioni i çmimeve të konsumit shënoi një vlerë mesatare prej 2.2% në vitin 2025. Presionet e huaja inflacioniste u dobësuan më tej, të ndikuara nga rënia e përshpejtuar e çmimeve të produkteve bazë në tregjet ndërkombëtare dhe forcimi i kursit të këmbimit. Nga ana tjetër, presionet e brendshme erdhën në rritje, duke u materializuar në vlerat më të larta se një vit më parë të inflacionit bazë.

Inflacioni i çmimeve të konsumit regjistroi një nivel mesatar vjetor prej 2.2% në vitin 2025, duke qëndruar në të njëjtin nivel me një vit më parë. Nga këndvështrimi i shportës së konsumit, kjo qëndrueshmëri pasqyroi rënien e inflacionit të ushqimeve të papërpunuara dhe rritjen e inflacionit të qirave, të disa shërbimeve të lidhura me turizmin dhe të naftës. Nga këndvështrimi makroekonomik, inflacioni i importuar vijoi të ulët – i ndikuar nga ecuria e çmimeve ndërkombëtare dhe forcimi i kursit të këmbimit – ndërsa inflacioni i brendshëm dhe ai bazë u rritën, kryesisht si pasojë e çmimeve të qirave. Presionet e tjera nga ambienti i brendshëm mbetën në përgjithësi të qëndrueshme, duke reflektuar – ndër të tjera – edhe pritjet e ankoruara inflacioniste.


Profili i inflacionit në Shqipëri ishte i njëjtë me atë të ekonomive të rajonit dhe BE-së, i diktuar kryesisht nga luhatjet e çmimeve të ushqimeve dhe të karburanteve. Megjithatë, inflacioni në Shqipëri ka mbetur më i ulët se ai i vendeve të rajonit, në pasqyrim të forcimit të kursit të këmbimit, si edhe të çmimeve të rregulluara të energjisë elektrike për konsumatorët familjarë.



Struktura e artikujve të shportës sipas intervaleve të inflacionit tregon një rritje të peshës së intervaleve “nën 2%” dhe “mbi 4%”, dhe ulje të peshës së



Grafik 14. Struktura e artikujve të shportës së IÇK-së sipas intervaleve të inflacionit



Burimi: INSTAT dhe Banka e Shqipërisë.


artikujve në intervalin “2% deri 4%”³. Më konkretisht, pesha e artikujve me inflacion mbi 4% u rrit me 3 pikë përqindje, duke zënë rreth 23% të totalit. Pesha e artikujve me inflacion nën 2% u zgjerua me 6 pikë përqindje, duke përfshirë pjesën më të madhe, rreth 49% të shportës totale. Ndërkohë, pesha e artikujve me inflacion 2% - 4% u tkurr me 9 pikë përqindje, duke zënë vetëm 28% të shportës së IÇK-së gjatë vitit 2025.

Në kahun rritës të inflacionit, zhvillimi më i spikatur i vitit 2025 ishte rritja e inflacionit të qirave, i cili dha një kontribut shtesë prej 0.3 pikësh përqindjeje në inflacionin total (Tabela 2). Presionet rritëse mbi këto çmime erdhën nga rritja e kërkesës për banesa me qira dhe oferta e kufizuar për qira afatgjata, së bashku me stabilitetin më të madh të kursit të këmbimit

dhe rritjen e çmimeve të banesave në vend (Grafik 15, djathtas). Në muajin dhjetor, kjo kategori shënoi vlerat maksimale historike, me inflacion 7.7% dhe kontribut prej 1 pikë përqindjeje (Grafik 15, majtas).

Gjithashtu, me rritje – ndonëse me ritme të përmbajtura – rezultoi edhe inflacioni i disa shërbimeve, kryesisht atyre të lidhura me turizmin. Në kategorinë e ushqimeve, “Ushqimet e përpunuara” dhanë një kontribut më të lartë krahasuar me një vit më parë, me rritje të theksuar në nënkategoritë “qumësht, djathë dhe vezë” dhe “vajra dhe yndyra”. Po ashtu, çmimet e karburanteve u rritën lehtë, duke kaluar në territor pozitiv në muajt e fundit të vitit – një zhvillim ky që nuk ishte regjistruar prej muajit korrik të vitit 2024.

Grafik 15. Kontributi i qirave në inflacionin total (majtas) dhe indekseve të çmimeve të banesave dhe qirave në vend



Burimi: INSTAT, Banka e Shqipërisë dhe llogaritje të Bankës së Shqipërisë.

Shënim: Indeksi i çmimit të banesave nga vrojimi 6-mujor i BSH-së, “Ecuria e Tregut të Pasurive të Paluajtshme në Shqipëri”.

³ Vlerësimi është bërë mbi bazën e të dhënave të inflacionit vjetor për një detajim në nivel 4-shifror sipas klasifikimit COICOP (2025) të artikujve të shportës së IÇK-së, detajim me një numër total prej 96 mallrash dhe shërbimesh.



Në kahun rënës të inflacionit ndikuan kryesisht “Ushqimet e papërpunuara”, të cilat dhanë një kontribut prej 0.2 pikë përqindjeje më të ulët në inflacion, duke shënuar një nga nivelet më të ulëta të viteve të fundit. Brenda kësaj kategorie, fruta – perimet regjistruan norma të ulëta inflacioni, duke kaluar në vlera negative në fund të vitit. Po ashtu, nënkategoria “bukë e drithëra” dha një kontribut më të ulët, pas një periudhe dyvjeçare stabiliteti. Në të njëjtën linjë, “Mallrat e konsumit afatgjatë” dhe “Mallrat me çmime të rregulluara” ushtruan presione rënëse. Kategoria e fundit pasqyroi efektet e tarifave të reja të energjisë elektrike për konsumatorët familjarë, të zbatuara prej muajit shkurt. Efekti i tij i drejtpërdrejtë gjatë vitit 2025 rezultoi në një reduktim mesatar të inflacionit me 0.1 pikë përqindjeje (Tabelë 4).

Tabelë 4. Kontributi i kategorive kryesore në inflacionin vjetor (në pikë përqindje)


	Kontribute mesatare sipas viteve					Kontribute mesatare sipas tremujorëve - viti 2025				Inflacioni vjetor 2025 (në %)
	2021	2022	2023	2024	2025	T1	T2	T3	T4	
Ushqime të përpunuara	0.6	2.8	1.4	0.5	0.7	0.7	0.8	0.7	0.6	2.6
Ushqime të papërpunuara	0.8	1.6	2.2	0.6	0.4	0.5	0.6	0.3	0.1	2.4
Shërbime	0.2	0.5	0.5	0.3	0.4	0.4	0.4	0.5	0.4	2.4
Mallra me çmime të rregulluara	0.0	0.0	0.0	0.1	-0.1	0.0	0.0	-0.1	-0.1	0.0
Strehim (qira)	0.1	0.3	0.4	0.3	0.6	0.2	0.3	0.8	0.9	4.2
Mallra konsumi joushqimor	0.2	1.3	-0.2	0.1	0.0	0.0	0.0	0.0	0.1	0.0
Mallra konsumi afatgjatë	0.1	0.2	0.5	0.3	0.2	0.2	0.2	0.2	0.2	3.1
Inflacioni (%)	2.0	6.7	4.8	2.2	2.2	2.0	2.3	2.4	2.2	2.2

Burimi: INSTAT dhe Banka e Shqipërisë.


Në terma makroekonomikë, faktorët me origjinë të brendshme dhe ndikim më afatgjatë në inflacion, mbetën dominues dhe në rritje krahasuar me një vit më parë. Nga ana tjetër, faktorët me origjinë të huaj dhe ndikim më afatshkurtër në inflacion patën një kontribut në rënie, duke tërhequr për poshtë inflacionin total dhe duke e mbajtur atë nën objektivin 3%.

Inflacioni bazë dhe ai i brendshëm konverguan rreth nivelit 2.7% në vitin 2025, duke u zgjeruar përkatësisht me 0.5 dhe 0.3 pikë përqindjeje krahasuar me një vit më parë. Rolin kryesor në këtë ecuri e luajti rritja e inflacionit të grupit të qirave gjatë gjysmës së dytë të vitit. Ndërkohë, rritja e mëtejshme e kërkesës dhe rritja e pagave u reflektuan në rritje të inflacionit të disa shërbimeve, kryesisht atyre të lidhura me turizmin, transportin dhe argëtimin. Inflacioni bazë kontribuoi me rreth 1.9 pikë përqindjeje në inflacionin mesatar të vitit 2025, kundrejt kontributeve minimale dhe në zvogëlim nga inflacioni jobazë (Grafik 16, majtas).

Presionet e importuara u dobësuan gradualisht gjatë vitit, duke kaluar në kahun negativ gjatë gjatëgjatë të vitit. Inflacioni i importuar u tkurr në -2.7% në këtë periudhë, nga 2.6% në gjysmën e parë. Rënia e çmimeve të lëndëve të para, veçanërisht e ushqimeve në tregjet e huaja, si dhe forcimi i mëtejshëm i kursit të këmbimit, bënë që kontributi i inflacionit të importuar të ishte minimal, duke regjistruar një ndër vlerat më të ulëta historike. Në këto




kushte, inflacioni total u diktua thuajse plotësisht nga inflacioni i brendshëm, i cili kontribuoi me rreth 2.2 pikë përqindjeje.



Ekonomia vijoi të qëndrojë në një fazë pozitive të ciklit të biznesit edhe gjatë vitit 2025, ndonëse ritmi i rritjes është afruar gradualisht me nivelin e saj potencial. Ky vlerësim mbështetet edhe nga raportimet e bizneseve: ndonëse mbeten mbi mesataret afatgjata, norma e shfrytëzimit të kapaciteteve dhe mungesat në fuqinë punëtore kanë ardhur në rënie.

Nga ana tjetër, nivelet minimale historike të normës së papunësisë dhe rritja e shpejtë e pagave sugjerojnë një treg pune me kushte të shtrënguara.




Megjithatë, përcjellja e rritjes së pagave në çmimet e konsumit ka qenë e pjesshme. Ajo është zburur nga përmirësimi i produktivitetit dhe ngushtimi i marzheve të fitimit të bizneseve, ndërkohë që pritjet e qëndrueshme për inflacionin kanë kufizuar efektin e raundit të dytë të rritjes së kostove mbi inflacion.

Ecuria e pritjeve për inflacionin të bizneseve dhe të agjentëve financiarë tregon një ankorim më të mirë drejt objektivit 3% gjatë vitit 2025⁴. Bizneset dhe agjentët financiarë presin që inflacioni pas një viti të jetë përkatësisht 3.3% dhe 2.7%. Agjentët financiarë presin që inflacioni në periudhën afatmesme të stabilizohet pranë nivelit 3%. Ndërkohë, pritjet e konsumatorëve mbetën të pandryshuara krahasuar me vitin e mëparshëm, duke qëndruar në nivele më të larta se ato të agjentëve të tjerë të ekonomisë, rreth 9.4%.

⁴ Pritjet për inflacionin maten nëpërmjet vrojtimeve të drejtpërdrejta të realizuara me bizneset, konsumatorët dhe agjentët financiarë.



Grafik 18. Ecuria e pritjeve të agjentëve ekonomikë për inflacionin



Burimi: Banka e Shqipërisë.

2.1.5 BILANCI I PAGESAVE DHE POZICIONI I JASHTËM I EKONOMISË

Pozicioni i jashtëm i ekonomisë së Shqipërisë ka shfaqur përmirësim gjatë vitit 2025. Rritja e mëtejshme e eksporteve, e remitançave dhe e të ardhurave nga puna, ndikoi në kalimin në suficit të llogarisë korrente gjatë nëntë muajve të parë të vitit. Po ashtu, flukset e investimeve të huaja direkte vijuan të zgjerohen, duke përbërë burimin kryesor të financimit të huaj. Këto zhvillime forcuan qëndrueshmërinë e sektorit të jashtëm, duke u reflektuar edhe në rritjen e mjeteve të rezervës valutore.

Llogaria korrente shënoi një suficit prej 0.3% të PBB-së për nëntë muajt e parë të vitit 2025, në përmirësim krahasuar me deficitin prej 1.3% të regjistruar gjatë së njëjtës periudhë të vitit 2024. Ecuria pozitive u mbështet kryesisht nga rritja e eksporteve, me kontribute shtesë nga rritja e të ardhurave parësore dhe dytësore.

Eksportet totale u rritën me 9.6% gjatë kësaj periudhe, të mbështetura nga rritja e eksportit të shërbimeve dhe kryesisht atyre të turizmit. Rritja e kërkesës së jashtme për këto shërbime evidentohet si në rritjen e numrit të vizitorëve, ashtu edhe të të ardhurave të shpenzuara për vizitor. Për këtë periudhë, eksportet e turizmit gjeneruan rreth 4.4 miliardë euro të ardhura për ekonominë, me një rritje vjetore prej 14.5%. Njëkohësisht, eksportet e tjera të shërbimeve u zgjeruan me 12.9%, të nxitura nga shërbimet e tjera të biznesit, shërbimet e transportit dhe shërbimet e përpunimit. Ecuri të kundërt paraqitën eksportet e mallrave, të zvogëluara me 9.9%, kryesisht të ndikuara nga kategoria "Materiale ndërtimi dhe metale".

Nga ana tjetër, importet totale u rritën me 6.2%, me kontribute të qenësishme si nga mallrat ashtu edhe nga shërbimet. Importet e mallrave u zgjeruan me 3.6%, të ndikuara nga importet më të larta për "Ushqime, pije dhe duhan"



dhe “Minerale, lëndë djegëse, energji elektrike”. Ndërkohë, rritja me 11.3% e importeve të shërbimeve u nxit kryesisht nga turizmi dalës.

Llogaritë e të ardhurave kontribuuan gjithashtu në përmirësimin e llogarisë korrente gjatë tre tremujorëve të parë të vitit. Rritja e të ardhurave nga puna çoi në zvogëlimin e deficitit të llogarisë së të ardhurave parësore, i cili qëndroi në nivelin 0.3% të PBB-së, në krahasim me një mesatare prej 1.4% të pesë viteve të fundit. Në të njëjtën kohë, remitancat u zgjeruan me 5.7% dhe arritën në 816.5 milionë euro.

Flukset hyrëse të investimeve të huaja direkte (IHD) u rritën në 1.2 miliardë euro gjatë nëntëmuajorit të parë, me një rritje vjetore prej 4.3%. IHD-të mbetën burimi kryesor financues i deficitit të llogarisë korrente dhe kanë natyrë jo-borxh-krijuese, duke kontribuar në forcimin e stabilitetit makroekonomik. Gjatë së njëjtës periudhë, investitorët e huaj riinvestuan 631.9 milionë euro fitime në ekonominë vendase, duke reflektuar perspektivën e qëndrueshme të ekonomisë së vendit. Flukset e IHD-ve u përqendruan kryesisht në sektorin e pasurive të paluajtshme (rreth 1/3 e totalit të fluksit), ndjekur nga flukset në sektorin financiar, në tregti dhe industri nxjerrëse.

Treguesit e qëndrueshmërisë së borxhit të jashtëm u përmirësuan më tej gjatë kësaj periudhe. Raporti i stokut ndaj PBB-së zbriti në 38.9%, duke qëndruar 1.7 pikë përqindje poshtë nivelit të shënuar në fund të vitit 2024. Borxhi afatgjatë vazhdon të jetë mbizotërues, duke përbërë 89.7% të totalit. Stoku i borxhit të jashtëm llogaritet në 10.4 miliardë euro në fund të tremujorit të tretë të vitit, me rritje vjetore 3.5%. Rritja e stokut total lidhet kryesisht me ecurinë e borxhit të Qeverisë së Përgjithshme.

Treguesit e aftësisë ripaguese afatgjatë janë përmirësuar, si pasojë edhe e ecurisë së mirë të eksporteve dhe të ardhurave fiskale. Raporti i stokut të borxhit ndaj eksportit të mallrave dhe shërbimeve zbriti në 93.9% në fund të tremujorit të tretë të vitit 2025, nga 97.2% në fund të vitit 2024. Gjithashtu, raporti i stokut të borxhit ndaj të ardhurave fiskale u pakësua në 136.9%, nga 142.4% në fund të vitit të mëparshëm. Në fund të dhjetorit 2025, mjetet e rezervës ishin të mjaftueshme për të mbuluar 7.8 muaj importe mallrash dhe shërbimesh ose 351% të borxhit të jashtëm afatshkurtër bruto.

Tabelë 5. Ecuria e treguesve kryesorë të bilancit të pagesave dhe të borxhit të huaj (në % ndaj PBB-së)

	2020	2021	2022	2023	2024	2025:T1-T3
Llogaria korrente	-8.6	-7.7	-6.2	-1.7	-2.4	0.3
Tregtia në mallra e shërbime	-14.4	-13.4	-10.6	-5.9	-6.9	-4.4
Eksporte	22.6	31.1	36.9	38.1	36.3	38.3
Importe	37.0	44.5	47.5	43.9	43.2	42.8
Remitanca hyrëse	5.0	5.0	4.6	4.3	4.2	4.1
IHD hyrëse	7.0	6.8	7.6	6.9	6.3	6.1
Borxhi i huaj	63.9	64.0	54.0	46.2	40.6	38.9


Burimi: Banka e Shqipërisë.



2.1.6 TREGJET FINANCIARE DHE TREGUESIT MONETARË

Tregu financiar u karakterizua nga kushte të favorshme likuiditeti, norma interesi në rënie, prime të ulëta rreziku dhe moderim i mbiçmimit të kursit të këmbimit gjatë vitit 2025. Vijimi i kursit akomodues të politikës monetare kontribuoi në lehtësimin e kushteve të financimit dhe thellimin e ndërmjetësimit financiar.

Normat e interesit në tregun ndërbankar qëndruan të ankoruara pranë normës bazë dhe shfaqën luhatshmëri të ulët, në prani të primeve të ulëta të rrezikut të likuiditetit. Reduktimi i normës bazë në muajin korrik u reflektua menjëherë në këtë treg, duke siguruar premisat për përcjelljen e politikës monetare në segmentet e tjera. Banka e Shqipërisë vijoi të furnizojë tregun me likuiditetin e nevojshëm, nëpërmjet repove javore dhe atyre tremujore. Nevojat e sistemit bankar për likuiditet ishin më të pakta krahasuar me dy vitet e kaluara dhe nivelet e deficitit të likuiditetit në sistemin bankar kanë qenë, në tërësi, të përshtatshme për një përcjellje të mirë të politikës monetare.




Yield-et e letrave me vlerë të qeverisë regjistruan nivele mesatare më të ulëta krahasuar me një vit më parë, përtej reduktimit të normës bazë, duke konfirmuar primet në rënie të rrezikut në tregun vendas. Yieldi 12-mujor rezultoi mesatarisht 2.67% gjatë vitit 2025, ose 0.6 pikë përqindje më pak se një vit më parë. Paralelisht me to, yield-et e maturiteteve 2-5 vjet shënuan një rënie mesatare prej 1.0 pikë përqindjeje, kurse ato me maturitet 7-15 vjet ranë me mbi 1.2 pikë përqindjeje. Kjo ecuri e yield-eve u pasqyrua në zhvendosjen poshtë dhe sheshimin e mëtejshëm të kurbës së yield-eve gjatë vitit 2025.

Edhe gjatë këtij viti vijoi zhvendosja e emetimeve të qeverisë drejt titujve me maturitete afatgjata, e cila gjeti mbështetje të lartë nga investitorët. Në këtë drejtim, vlen të veçohet emetimi për herë të parë i obligacionit 20-vjeçar,



emetim i cili rezultoi i suksesshëm. Gjithashtu, nxitur edhe nga përmirësimi i fundit i vlerësimeve të agjencive ndërkombëtare për kreditin sovran të vendit, u evidentua rritja e interesit të investitorëve të huaj për tituj borxhi emetuar brenda vendit dhe për eurobondin e emetuar në tregun ndërkombëtar⁵.




Presionet mbiçmuese mbi kursin e këmbimit ishin të pranishme edhe gjatë vitit 2025, por ritmi i forcimit të Lekut erdhi duke u moderuar. Kursi eur/lek rezultoi në nivelin mesatar 97.8, nga 100.7 vitin që shkoi, ndërsa mbiçmimi vjetor ra në 2.8%, nga 7.4% dhe 8.7% që ishte në dy vitet paraardhëse. Leku ruajti pozita të forta ndaj Dollarit amerikan, kryesisht si rrjedhojë e nënçmimit të këtij të fundit në tregjet ndërkombëtare. Kursi i këmbimit të Dollarit amerikan, gjatë vitit 2025, rezultoi mesatarisht 86.7 lekë/USD, me një mbiçmim të Lekut prej 6.8%.

Presionet mbiçmuese të monedhës vendase e kanë origjinën në përmirësimin e bilancit të shkëmbimeve ekonomike dhe tregtare me jashtë. Kështu, prurjet e rritura valutore nga turizmi, të ardhurat nga puna dhe remitancat prodhuan një suficit të llogarisë korrente për nëntë muajt e parë të vitit, ndërkohë që rritja e mëtejshme e investimeve të huaja direkte gjeneroi një suficit të lartë në bilancin e pagesave. Prania e shtuar e Bankës së Shqipërisë në tregun valutor frenoi shpejtësinë e mbiçmimit të Lekut dhe mundësoi një funksionim normal të tregut. Tregu valutor shfaqti luhatshmëri të ulët dhe spread-e kuotimi brenda intervalit normal, ndërsa vëllimet e tregimit vazhduan rritjen dyshifrore, prej 14% këtë vit. Një shtjellim më të gjerë mbi ecurinë e kursit të këmbimit, faktorët që e ndikuan dhe reagimin e Bankës së Shqipërisë e gjeni në Hapësirën Informativë 1.

⁵ Në muajin shkurt 2025 u emetua një eurobond me vlerë 650 mln euro, me kupon 4.75% dhe yield 5.0%. Kërkesa për të investuar në këtë titull ishte disa herë më e lartë se shuma e emetuar.



Normat e interesit të kredive dhe depozitave shënuan rënie gjatë vitit 2025, në ndjekje të sinjaleve të politikës monetare. Rënia e normave të interesit ishte më e dallueshme te kreditë për individë, segment i cili vazhdoi të ishte dinamik sa i takon kërkesës për financim dhe ofertave të bankave. Interesi mesatar i kredive konsumatore regjistroi rënie më të shpejtë, në mesatarisht 8.6% këtë vit, nga 9.1% një vit më parë. Interesi mesatar i kredive hipotekare zbriti me 0.2 pikë përqindje, në 3.8%. Nga ana tjetër, interesat e kredive për biznese vijuan të shfaqen më të luhatshme, duke qëndruar në nivelin mesatar 6.5% gjatë vitit. Zhvillim pozitiv ishte rënia e interesave të kredive për biznese me shumë deri në 35 milionë lekë, e cila përaftron kreditë për bizneset e vogla. Interesi mesatar për këtë segment zbriti gradualisht në 6.4% në tremujorin e fundit të vitit, nga 7.5% në vitin 2024. Kontribut në uljen e interesave për këtë kategori kanë dhënë edhe kreditë e disbursuara në kuadër të Programit të Financimit të Biznesit Mikro, të Vogël dhe të Mesëm, ofruar nga Banka e Shqipërisë, të cilat kanë pasur një normë interesi tavan prej 3.5%⁶.



Normat e interesit të kredive në Euro shënuan gjithashtu rënie gjatë vitit 2025, në ndjekje të lehtësimit të politikës monetare në Eurozonë. Ato regjistruan mesatarisht 5.8% për bizneset dhe 4.9% për kredite hipotekare të individëve, duke rënë përkatësisht me 0.8 dhe 0.5 pikë përqindje krahasuar me vitin 2024. Interesat e kredive në Euro kanë qenë në rënie prej gjysmës së dytë të vitit 2024. Diferenca mes interesit të kredisë në Lekë dhe atij të kredive në Euro për bizneset është pozitive, por e vogël, ndërsa mbetet negative për kredite hipotekare të individëve. Në tërësi, këto diferenca kanë shkruajuar kreditimin në valutë të huamarrësve të pambrojtur ndaj kursit të këmbimit.

Kushtet e favorshme financiare kanë ndihmuar thellimin e ndërmjetësimit financiar. Për pasojë, zgjerimi monetar në ekonomi është rritur, duke qëndruar në nivelet më të larta të dekadës së fundit.

Kredia për sektorin privat⁷ ka vijuar të rritet me norma të larta rritjeje, duke regjistruar nivelin 14.7% në muajin dhjetor, në pasqyrim si të kërkesës së lartë për financim nga agjentët ekonomikë, ashtu edhe të gatishmërisë së bankave për të kredituar. Në raport me PBB-në, kredia për sektorin privat u rrit në 34%, duke arritur nivelin më të lartë të regjistruar në periudhën pas pandemisë COVID. Ky raport është 2.5 pikë përqindje më i lartë se në vitin 2024.

Kredia për individë ishte segmenti me rritjen më të shpejtë, prej 18.3% në terma vjetorë, duke reflektuar normat e larta të rritjes së kredisë për konsum (20.5%) edhe të kredisë për blerje banese (17.5%). Dinamika pozitive e këtyre segmenteve është mbështetur nga kërkesa e lartë për financim, në përgjigje të rritjes së të ardhurave, kostove të ulëta të kredive dhe besimit për të ardhmen. Po kështu edhe kushtet e ofertës për kredi kanë qenë të favorshme, të nxitura nga rritja e konkurrencës mes bankave.

Kredia për biznese pati një rritje vjetore prej 12.3% gjatë vitit 2025, duke pasqyruar rritjen me 14.4% të kredisë për investime⁸ dhe rritjen me 8.7% të portofolit të kredisë për likuiditet. Në veçanti, kredia për investime vijon të shënojë norma të larta rritjeje dhe të përbëjë destinacionin kryesor të kredive bankare. Si rezultat, pesha e këtij segmenti arriti në 62.3%, duke u rritur me 1.3 pikë përqindje nga fundi i vitit 2024.


Dinamika e **portofolit sipas monedhave** shfaqet e ekuilibruar - duke reflektuar edhe qëndrueshmërinë e spread-eve midis normave të interesit të dy monedhave kryesore të kredimarrjes. Kështu, kredia në Lekë është rritur me 16.6% duke shfaqur një normë rritjeje të njëtrajtshme përgjatë gjithë vitit, ndërsa kredia në

⁷ Të dhënat e kredisë bazohen në të dhënat monetare, të cilat merren nga bilanci të bankave dhe i referohen financimit për sektorin privat rezident. Prej vitit 2022, në linjë me metodologjinë e BQE-së, analiza e portofolit të kredisë bazohet në flukset reale të kredisë, të rregulluara si nga lëvizjet e kursit të këmbimit, ashtu edhe nga kredite e nxjerra nga bilanci.

⁸ Po kështu, kredia për investime mbart edhe shuarjen e efektit statistikor të një kredie të madhe të dhënë gjatë vitit të kaluar. Me përjashtim të këtij eventi të izoluar, normat e rritjes së këtij portofoli do të ishin më të qëndrueshme dhe pranë niveleve historikisht të larta.



valutë u rrit me 14.4%. Këto zhvillime kanë ndihmuar në rritjen në 58.2% të peshës së kredisë në Lekë ndaj totalit.



Në aspektin sektorial, rritje më të shpejtë të kredisë kanë pasur sektorët e tregtisë, të industrisë dhe të bujqësisë, ndërkohë që sektori i ndërtimit dhe ai i shërbimeve të tjera kanë pasur ritme më të ulëta rritjeje.

Tabelë 6. Kredia e bankave për bizneset, sipas sektorëve të ekonomisë

Kredi per biznese	Pesha ndaj kredisë për biznese (në %)					Ndryshim vjetor (në %)				
	Bujqësia	Industria	Ndërtimi	Tregtia	Shërbime të tjera	Bujqësia	Industria	Ndërtimi	Tregtia	Shërbime të tjera
2020	1.6	25.1	13.3	42.9	17.2	15.8	8.2	8.10	9.4	17.8
2021	1.7	25.0	15.8	43.0	14.5	15.3	8.0	29.64	8.8	-8.0
2022	1.7	22.4	17.6	43.8	14.4	6.9	-3.0	22.12	10.5	7.8
2023	1.6	22.0	17.3	43.2	15.8	2.8	6.3	6.35	6.3	22.7
2024	1.3	21.8	16.6	43.8	16.5	-4.8	14.5	10.72	18.7	10.4
2025	1.3	22.4	15.5	45.1	15.8	10.3	15.1	4.72	16.0	7.7

Burimi: Banka e Shqipërisë.

Në një plan më afatgjatë, portofoli i kredive për biznese dominohet nga sektori i tregtisë dhe ai i akomodimit e restoranteve, të cilat së bashku përbëjnë rreth 45% të totalit. Pas tyre renditet industria me 22.4%, ndërsa ndërtimi dhe shërbimet e tjera zënë rreth 15%. Edhe pse financimi për bujqësinë është rritur me ritme të larta, ky sektor vazhdon të ketë peshën më të ulët të kredive – vetëm 1.3% –për shkak të problemeve strukturore, ofertës së kufizuar, aksesit të kufizuar në banka dhe kostove të larta të financimit.

Kursimet e familjeve dhe bizneseve në formën e depozitave bankare shfaqën rritje të lartë gjatë vitit 2025. Rritja e tyre vjetore prej 10.7% ishte rreth 2 pikë përqindje më e lartë se një vit më parë, duke reflektuar përmirësim të normave të rritjes në të gjithë komponentët dhe duke mbështetur zgjerimin e kërkesës për



para. Zgjerimi i depozitave u mbështet nga përmirësimi i normave të rritjes së depozitave në Lekë, të cilat u rritën me 11.7% ose rreth 4 pikë përqindje më shumë se një vit më parë. Kjo ecuri ka reflektuar qëndrueshmërinë e normave të interesit për depozitat në Lekë, zhvendosjen e preferencave të individëve nga investimet në letrat me vlerë drejt bankave, si dhe likuiditetin e lartë të injektuar nga Banka e Shqipërisë në treg.

Po kështu me norma më të larta janë rritur dhe depozitat në valutë. Rritja e tyre vjetore prej 9.7% ishte lehtësisht më e lartë se ajo e shënuar në fund të vitit 2024. Ecuria e tyre e mirë reflekton më së shumti rritjen e depozitave të biznesit.

Ecuria e depozitave sipas maturitetit tregon për përshpejtim të normave të rritjes së depozitave pa afat, ndërsa ato me afat patën një zgjerim më të moderuar. Depozitat pa afat u rritën me 11.5% në nivel vjetor, ndërsa depozitat me afat janë rritur me 9.6%, duke reflektuar preferencën për mjete monetare më likuide të agjentëve ekonomikë. Ndërkohë, depozitat mbi dy vjet kanë shfaqur ngadalësim të ritmeve të rritjes në kushtet e pasigurive të shtuara dhe nevojës për të mbajtur likuiditet. Rritja e tyre prej 9.6% ishte rreth 4 pikë përqindjeje më e ulët, se ajo e vërejtur një vit më parë dhe pesha e tyre qëndroi në 18.3% ndaj depozitave totale.


HAPËSIRË INFORMUESE 3

PROGRAMI I FINANCIMIT PËR BIZNESIN MIKRO, TË VOGËL DHE TË MESËM

Objektivat e programit

Bizneset mikro, të vogla dhe të mesme (BVM) janë shtylla kryesore e ekonomisë shqiptare. Ato përbëjnë rreth 99.9% të numrit total të bizneseve, gjenerojnë rreth 78.2% të vlerës së shtuar në ekonomi dhe punësojnë rreth 82.5% të të punësuarve me pagë. Megjithatë, ata përfitojnë më pak se gjysmën e kredisë bankare për biznesin (46.8%), dhe vetëm 27% të kredisë totale për sektorin privat.*

Grafik 23. Kontributi i BMV-ve në vlerën e shtuar dhe në rritjen e kredisë për biznese



Burimi: Banka e Shqipërisë.



Ky hendek midis peshës së tyre ekonomike dhe aksesit në financë pasqyron disa probleme strukturore, si: nivel i lartë informaliteti, mungesë kolaterali dhe historiku marrëdhëniesh me bankat, si dhe njohuri të kufizuara financiare. Këto probleme e bëjnë qasjen e BVM-ve në tregun financiar më të vështirë dhe më të kushtueshme.

Në këtë kontekst, në fillim të vitit 2025, Banka e Shqipërisë (BSH) miratoi Programin e Financimit për Biznesin Mikro, të Vogël dhe të Mesëm (PFBVM), në zbatim të detyrave ligjore për përmirësimin e kushteve monetare dhe kredituese, në mbështetje të stabilitetit dhe zhvillimit ekonomik të vendit**.

Konkretisht, programi synon të: (i) ulë koston e kredive për BVM-të, duke i bërë ato më të përballeshme dhe më të aksesueshme; (ii) forcojë marrëdhënien mes bizneseve dhe sektorit bankar, duke nxitur ndërtimin gradual të një historiku financiar; (iii) nxisë investimet dhe rritjen e produktivitetit të këtij segmenti; dhe (iv) krijojë hapësirë për reforma strukturore, që përmirësojnë në mënyrë të qëndrueshme mjedisin ku operon ky segment.

Parametrat dhe aspektet operacionale


Programi është ndërtuar mbi kuadrin ligjor të Bankës së Shqipërisë dhe parimet e ekonomisë së tregut. Ai është i hapur për të gjitha bizneset mikro, të vogla dhe të mesme, në të gjithë sektorët e ekonomisë. Ky rregullim synon të ruajë neutralitetin sektorial dhe të garantojë trajtim të barabartë për BVM-të që plotësojnë kriteret.

Struktura e programit bazohet në një ndarje të qartë rolesh:

- Banka e Shqipërisë ofron likuiditet afatgjatë për bankat tregtare të licencuara dhe të mbikëqyra prej saj, me kushte më të favorshme se ato të tregut të depozitave afatgjata. Ky likuiditet ofrohet kundrejt kolateralit standard të përdorur në operacionet tona monetare, duke mos e ngarkuar Bankën e Shqipërisë me rrezik krediti. Në këmbim, bankat angazhohen që këtë financim ta përdorin ekskluzivisht për kredi për investime për BVM.
- Bankat tregtare, të cilat zgjedhin të bëhen pjesë e këtij programi, mbajnë tërësisht mbi vete rrezikun e kredisë dhe janë ekskluzivisht përgjegjëse për miratimin e kredive individuale. Ato vlerësojnë aplikimet, përzgjedhin klientët dhe menaxhojnë rrezikun e kreditit, në përputhje me politikat e tyre të brendshme dhe standardet mbikëqyrëse në fuqi. Rreziku i kredisë mbetet plotësisht në bilanci të tyre, duke ruajtur disiplinën e tregut dhe standardet e shëndosha të kreditimit.
- Çdo biznes, i cili plotëson kriteret e të qenit BVM***, nga çdo sektor i ekonomisë, është i lirë të aplikojë pranë çdo banke tregtare për të përfituar kredi nga ky program. Megjithatë, shqyrtimi dhe miratimi i aplikimeve mbetet e drejtë ekskluzive e bankave tregtare, për sa kohë këto mbartin edhe rrezikun e kreditit.



Parametrat kryesorë të programit – kufijtë sasiore, kostoja e financimit dhe afatet kohore – paraqiten të përmbledhura në diagramin në vijim.



Burimi: BSH.

Programi është konceptuar si një instrument i përkohshëm, me kufizime të qarta në kohë dhe në sasi, në mënyrë që të ruajë efektivitetin e tij dhe përputhshmërinë me objektivat për të cilët është krijuar. Ky dizajn i kujdesshëm siguron që ndërhyrja të mbetet e targetuar dhe proporcionale, pa cenuar orientimin e politikës monetare dhe pa krijuar deformime në tregun financiar. Në këtë mënyrë, mbështetja për kreditimin e BVM-ve harmonizohet me objektivin themelor të Bankës së Shqipërisë për ruajtjen e stabilitetit monetar dhe financiar.

Disa vëzhgime mbi ecurinë dhe zbatimin e programit


Zbatimi operacional i programit nisi në tremujorin e dytë të vitit 2025, pas një periudhe të nevojshme përshtatjeje me kërkesat procedurale dhe kriteret e tij. Me rritjen e familjarizimit të bankave dhe bizneseve me mekanizmin e programit, kreditimi ka ndjekur një trajektore graduale rritjeje.

Gjatë vitit u akorduan 131 kredi, me një vlerë totale prej 1.8 miliardë lekësh, ose rreth 7.2% e fondit të përgjithshëm. Rreth 98% e këtyre kredive janë financime të reja, çka konfirmon se programi ka shërbyer si instrument për nxitjen e investimeve shtesë dhe jo si mekanizëm për rifinancimin e detyrimeve ekzistuese.

Struktura e kreditimit tregon një përqendrim kryesisht tek bizneset e vogla dhe të mesme, të cilat kanë përfutur rreth 85% të fondeve, ndërsa segmenti mikro mbetet më pak i përfaqësuar. Nga pikëpamja sektoriale, fondet janë orientuar drejt industrisë (33.7%), tregtisë (30.5%) dhe bujqësisë (22.9%), duke reflektuar potencialin e tyre për rritje produktiviteti. Rreth gjysma e financimeve është përdorur për blerje pajisjesh dhe makinerish, duke treguar fokus të qartë në zgjerimin e kapaciteteve prodhuese dhe modernizimin e aktivitetit. Shpërndarja gjeografike paraqitet relativisht e balancuar, me përqendrim në qendrat kryesore ekonomike të vendit, ndërsa rreth 83% e portofolit ka maturitet 5-vjeçar, duke dëshmuar orientim afatgjatë të investimeve. Të gjitha bankat e sistemit kanë marrë pjesë aktive në program.



Grafik 24. Ecuria e programit sipas madhësisë së biznesit, sektorit ekonomik dhe përdorimi i fondeve



Në vlerësimin tonë, PFBVM ka kontribuar në përmirësimin e aksesit të bizneseve mikro, të vogla dhe të mesme në financim, duke ofruar kushte më të favorshme kreditimi dhe duke mbështetur investime të reja. Megjithatë, niveli ende i ulët i përdorimit të fondit sugjeron se kufizimi kryesor i aksesit të BVM në kredi lidhet me faktorë strukturorë. Këta faktorë përfshijnë informalitetin, mungesën e kolateralit të mjaftueshëm, kapacitetet e kufizuara menaxheriale dhe planifikimin financiar të pamjaftueshëm të bizneseve, si edhe perceptimin e rrezikut nga bankat.

Për rrjedhojë, përmirësimi i qëndrueshëm i aksesit në financë kërkon më shumë sesa instrumente likuiditeti. Ai kërkon një qasje të koordinuar ndërmjet politikave ekonomike publike dhe reformave strukturore që forcojnë formalizimin, rrisin transparencën financiare, përmirësojnë klimën e biznesit dhe reduktojnë pasiguritë ligjore e administrative. Në këtë kuadër, PFBVM përfaqëson një ndërhyrje të targetuar dhe të përkohshme, por nuk zëvendëson nevojën për reforma strukturore më të thella.

Banka e Shqipërisë do të vijojë ta monitorojë nga afër programin dhe të kryejë në vazhdimësi analizën e rezultateve.

* INSTAT, publikimi "Statistika mbi ndërmarrjet e vogla dhe të mesme", 2023.

** Ligji Nr.8269, datë 23.12.1997, "Për Bankën e Shqipërisë", në nenin 3, paragrafi 2, shprehet si në vijim: "Banka e Shqipërisë, në përputhje me objektivin e saj kryesor dhe mbi bazën e tregut të brendshëm bankar, nxit dhe mbështet zhvillimin e regjimit dhe të sistemit të këmbimeve valutore, tregun e brendshëm financiar, sistemin e pagesave, si dhe ndihmon në përmirësimin e kushteve monetare e kredituese, në mbështetje të stabilitetit dhe të zhvillimeve ekonomike të vendit".

*** Identifikimi i bizneseve që konsiderohen BVM në kuadër të këtij programi bazohet në përcaktimet e Ligjit nr. 43, datë 21.4.2022 "Për zhvillimin e ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme".



Tabelë 7. Tregues kryesorë makroekonomikë dhe financiarë

	2020	2021	2022	2023	2024	2025*
Inflacioni (mesatar)						
Inflacioni total (mesatare, në %)	1.6	2.0	6.7	4.8	2.2	2.2
Inflacioni bazë (mesatare, në %)	1.4	1.7	6.5	5.3	2.5	2.7
Rritja ekonomike						
Rritja reale e PBB-së (vjetore në %)	-3.3	9.0	4.8	4.0	4.0	3.7*
Tregu i punës¹						
Shkalla e pjesëmarrjes në forcën e punës				75.4	75.7	76.5*
Norma e papunësisë (15+)				9.5	8.5	8.4*
Sektori fiskal						
Balanca buxhetore (me grantet, % të PBB)	-6.7	-4.6	-3.6	-1.3	-0.7	-1.8
Të ardhurat buxhetore (në % të PBB-së)	25.7	27.4	26.7	27.2	28.2	28.4
Shpenzimet buxhetore (në % të PBB-së)	32.4	32.0	30.3	28.5	28.9	30.2
Borxhi publik (në % të PBB-së)**	73.9	74.1	64.1	57.6	54.2	52.8
Sektori i jashtëm						
Llogaria korrente (përfshijë transferatat zyrtare, në % të PBB-së)	-8.6	-7.7	-6.2	-1.7	-2.4	0.3*
Importet në mallra (fob, në % të PBB-së)	28.2	33.4	34.3	29.2	29.0	27.7*
Eksportet në mallra (fob, në % të PBB-së)	5.9	8.2	10.4	8.0	6.7	5.8*
Investimet e huaja direkte (% PBB-së)	7.0	6.8	7.6	6.9	6.3	6.0*
Sektori monetar e financiar						
Norma e repo-s (fund periudhe)	0.50	0.50	2.75	3.25	2.75	2.50
Agregati M3 (ritje vjetore, fund periudhe)	10.6	9.3	7.5	6.3	7.4	11.3
Kredia për sektorin privat (ritje vjetore, fund periudhe) ²	8.9	10.3	10.6	10.2	15.7	14.7
Depozita/PBB-së ³	77.3	75.5	69.6	66.7	66.2	68.3
Kredi/PBB-së ³	35.0	33.7	31.4	29.9	31.6	34.0
Yieldi 12-mujor (mesatar)	1.9	1.8	3.2	3.7	3.3	2.7
Kursi i këmbimit, lek/usd (mesatar)	108.7	103.5	113.0	100.7	93.04	86.7
Kursi i këmbimit, lek/euro (mesatar)	123.8	122.5	119.0	108.7	100.7	97.8
Kursi nominal efektiv, NEER ((mesatar)	89.9	86.4	78.6	67.9	60.0	56.3
Sektori Bankar						
Raporti i kredive me probleme (%)	8.1	5.6	5.0	4.7	4.17	3.8

Burimi: INSTAT, Banka e Shqipërisë, Ministria e Financave.

*Të dhënat për rritjen ekonomike dhe për sektorin e jashtëm i përkasin 9-mujorit të parë të vitit 2025.

1/ "Rezultate të Anketës së Forcave të Punës", publikim i INSTAT-it, mungon për vitin 2024.

2/ Bazuar në të dhënat e flukseve monetare publikuar nga Departamenti i Statistikave Financiare.

Të dhënat janë rregulluar për efektin e kursit të këmbimit dhe kreditë e nxjerra nga bilanci.

3/ Vlerësim i PBB-së për vitin 2025. Të dhënat në raport me PBB-në janë llogaritur mbi këtë vlerësim, përveç rasteve kur specifikohet ndryshe.



2.2. OPERACIONET MONETARE


Zbatimi i politikës monetare nga Banka e Shqipërisë realizohet nëpërmjet instrumenteve të grupuara në: operacione të tregut të hapur, lehtësira të përhershme dhe rezerva e detyruar. Operacioni kryesor i tregut është marrëveshja e riblerjes dhe e anasjelltë e riblerjes me maturim 7-ditor, norma e interesit të së cilës përcaktohet nga Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë dhe referohet si norma bazë e interesit.

OPERACIONET NË TREG TË HAPUR DHE ADMINISTRIMI I NEVOJAVE PËR LIKUIDITET

Operacionet e tregut të hapur shërbejnë për përmbushjen e objektivit operacional të Bankës së Shqipërisë (BSH): orientimin e normave afatshkurtra të interesit të tregut ndërbankar pranë normës bazë të interesit dhe minimizimin e luhatjeve të tyre.

Në tërësinë e tyre bëjnë pjesë operacioni kryesor i rifinancimit, në formën e marrëveshjes së (anasjelltë) të riblerjes me kohëzgjatje 7-ditore, operacione rregulluese me kohëzgjatje 1-ditore dhe ato me kohëzgjatje nga 8 ditë deri 3 muaj, si dhe operacionet strukturore të shitblerjes me të drejta të plota të titujve në tregun sekondar.

Gjatë vitit 2025, vëllimi mesatar i likuiditetit të injektuar – përmes operacioneve me maturim deri në 3 muaj – ka rezultuar 36 miliardë lekë, ndërsa numri mesatar i bankave pjesëmarrëse në injektimet javore ka qenë 4.3. Në krahasim me një vit më parë, vërehet një rënie e numrit të bankave pjesëmarrëse dhe e vëllimit të injektuar,⁹ si pasojë e një mungese më të vogël të likuiditetit në sistemin bankar dhe e rritjes së financimit në tregun ndërbankar, falë limiteve më të larta të tregtimit



⁹ Numri i bankave pjesëmarrëse ka qenë 5, ndërsa vëllimi mesatar 44 miliardë lekë.



ndërmjet bankave. Kërkesa për likuiditet ka qenë e përqendruar – në masën 90% – në injektimet javore dhe 10% në ato me maturim mbi 1 javë deri në 3 muaj.

Norma mesatare e interesit në injektimet javore ka qenë rreth 2.91 pikë bazë mbi normën bazë dhe ka rezultuar në nivel pothuaj të njëjtë me një vit më parë. Ndërkohë, diferenca e normës maksimale – prej rreth 5.5 pikë bazë ndaj normës bazë – ka ardhur në rënie, e ndikuar nga rritja e ndërmjetësimit dhe menaxhimi i kujdesshëm i likuiditetit nga bankat dhe Banka e Shqipërisë.

Tabelë 8. Struktura e operacioneve injektuese të likuiditetit nga Banka e Shqipërisë

	2016	2017	2018	2019	2020	2021	2022	2023	2024	2025
Instrumenti kryesor	80.7%	61.6%	54%	61%	56%	59%	63%	65%	74%	90%
Injektimet afatgjata	19.3%	39.4%	46%	39%	44%	41%	37%	35%	26%	10%

Burimi: Banka e Shqipërisë.

LEHTËSITË E PËRHERSHME

Lehtësitë e përhershme – depozita njëditore dhe kredia njëditore pranë BSH-së – u shërbejnë bankave të nivelit të dytë për të administruar likuiditetin në bazë ditore. Këto lehtësi përcaktojnë një korridor brenda të cilit luhaten normat e interesit në tregun ndërbankar.

Gjatë vitit 2025, Banka e Shqipërisë uli një herë normën bazë të interesit, duke e çuar në 2.50%, ndërsa mbajti të pandryshuar korridorin mes normës së depozitës njëditore dhe kredisë njëditore me gjerësi prej +/- 100 pikësh. Paralelisht me uljen e normës bazë, BSH-ja uli dhe normat e depozitës dhe kredisë njëditore.

Instrumenti i depozitës njëditore ka gjetur përdorim në 572 raste, me vëllim mesatar prej 2.87 miliardë lekësh. Ndërkohë, kredia njëditore u përdor në 66 raste, me vëllim total të kërkuar prej 67.74 miliardë lekësh, kundrejt 68.78 miliardë dhe 75 miliardë lekë në dy vitet e mëparshme.

REZERVA E DETYRUAR

Rezerva e detyruar është instrumenti me anë të të cilit Banka e Shqipërisë synon të rregullojë gjendjen e likuiditetit të sistemit bankar dhe të ndihmojë në stabilizimin e normave të interesit në tregun ndërbankar.

Përqindja e detyrimeve në lekë dhe valutë që bankat duhet të mbajnë si rezervë të detyruar në Bankën e Shqipërisë, ka mbetur e pandryshuar nga një vit më parë.¹⁰

Gjatë vitit 2025, bankat kanë përdorur deri në 70% të likuiditetit në llogarinë e rezervës së detyruar në lekë, sipas nevojës, por gjithmonë duke ruajtur nivelin minimal ditor prej 30% të rezervës së detyruar.

¹⁰ Ndryshimi i fundit rregullator ishte në vitin 2018, në kuadër të programit të de-euroizimit, ku norma e rezervës së detyruar u ul në 7.5% për detyrimet në monedhën vendase dhe u rrit në 12.5% për monedhën Euro, nga niveli i padiferencuar 10% i aplikuar më parë.



Në përputhje me kuadrin rregullativ në fuqi, bankat tregtare kanë vijuar të remunerohen për rezervën e detyruar në Lekë në masën 100% të normës bazë, ndërsa për rezervat e detyruara në valutë, bankat nuk janë remuneruar.



2.3. STABILITETI FINANCIAR DHE POLITIKA MAKROPRUDENCIALE

Sipas kuadrit ligjor në fuqi, Banka e Shqipërisë ndjek dhe kujdeset për mbarëvajtjen e sistemit bankar në veçanti dhe sistemit financiar në përgjithësi, duke kontribuar në ruajtjen e stabilitetit financiar në vend. Për të arritur këtë objektiv, Banka e Shqipërisë harton dhe zbaton politikën makroprudenciale, e cila synon të identifikojë, vlerësojë, zbusë dhe parandalojë rreziqet sistemike në sistemin financiar. Objektivat e ndërmjetëm, treguesit e rreziqeve, instrumentet që mund të përdoren për secilin rrezik dhe detaje të tjera mbi instrumentet makroprudenciale përshkruhen në mënyrë të hollësishme në Strategjinë e Politikës Makroprudenciale.

Në raportet e rregullta dhe analizat e vrojtimeve që publikon Banka e Shqipërisë si autoritet makroprudencial, ofrohet informacion mbi zhvillimet kryesore në sistemin financiar dhe sektorin bankar, rreziqet potenciale dhe ato të evidentuara gjatë analizave, instrumentet e zbatuara për të zbutur dhe parandaluar rreziqet, situatën financiare të sektorit të bizneseve dhe familjeve, rezultatet e ushtrimeve të provës së rezistencës së sektorit bankar ndaj skenarëve të pafavorshëm makrofinanciarë, si edhe ndikimin e masave makroprudenciale në fuqi. Banka e Shqipërisë publikon gjithashtu edhe rregulloret, vendimet dhe metodologjitë përkatëse në hapësira të posaçme kushtuar funksionit të stabilitetit financiar.

Sektori financiar shqiptar ruajti një pozicion të fortë financiar, me tregues të mirë likuiditeti, përfitueshmërie dhe kapitali, si dhe shënoi një përmirësim të mëtejshëm të cilësisë së portofolit të kredisë. Rreziqet me natyrë sistemike vlerësohen të jenë nën kontroll, ndërkohë që sektori bankar ka kapacitete të mjaftueshme për të përballuar goditje potenciale.

2.3.1. ZHVILLIMET KRYESORE NË SISTEMIN FINANCIAR DHE SEKTORIN BANKAR

Gjatë vitit 2025, aktivet e sistemit financiar, të dominuara nga aktivet e sektorit bankar, janë zgjeruar më shpejt sesa rritja e Produktit të Brendshëm Bruto (PBB). Në fund të tremujorit të tretë, raporti i aktiveve të sistemit ndaj PBB-së vjetore ishte rreth 97% ose 5 pikë përqindje më i lartë se një vit më parë. Brenda sistemit financiar, sektori bankar vijon të dominojë me afro 90% të aktiveve totale. Të gjitha segmentet e sistemit financiar kanë zgjeruar aktivet, por rritja më e shpejtë është regjistruar në aktivet e fondeve të investimit dhe shoqërive të kursim-kreditit. Treguesit e cilësisë së aktiveve dhe të përfitueshmërisë së subjekteve financiare mbeten në nivele të mira dhe ekspozimet neto brenda sistemit financiar dhe midis sistemit financiar dhe sektorëve të tjerë rezidentë dhe jorezidentë janë të kontrolluara.



Sektori bankar e mbylli vitin 2025 me një rezultat financiar pozitiv, me një nivel të mirë të kapitalizimit të veprimtarisë të pasqyruar në një normë të mjaftueshmërisë së kapitalit prej 20.36%, dhe me tregues të përmirësuar të cilësisë së kredisë. Rritja me 9% e aktiveve të bankave u mbështet nga rritja e depozitave dhe kapitalit, çka ka mundësuar rritjen e investimeve në kredi dhe letra me vlerë. Rritja e kredisë ishte më e shpejtë në Lekë (me 16%) në krahasim me rritjen e kredisë në valutë (11%), ndërkohë që normat e rritjes së kredisë sipas afateve dhe sektorëve kanë qenë të ngjashme¹¹. Raporti i kredive me probleme ra në 3.8% në fund të vitit, nga 4.2% një vit më parë. Fitimi i raportuar nga sektori bankar në fund të vitit shënoi 36 miliardë lekë, ose 3% më pak nga një vit më parë. Kjo ecuri u ndikua nga rritja më e shpejtë në interesat e paguara dhe shpenzimet operacionale, në krahasim me rritjen e të ardhurave nga interesat dhe fitimi nga investimet në mjete financiare. Tkurrja e shpenzimeve për provigjione për kreditë e humbura dhe rritja e nivelit të rimarrjeve nga provigjionet për instrumente të tjera financiare dhanë një kontribut pozitiv në rezultatin financiar të sektorit bankar.

Aktualisht, bankat janë të detyruara të përmbushin disa kërkesa për nivelet e kapitalit, përfshirë shtesat makroprudenciale të kapitalit, si dhe kërkesat për instrumentet dhe detyrimet rregullatore të kapitalit (MREL). Për të forcuar pozicionet e tyre të kapitalit, gjatë vitit 2025, bankat kanë injektuar kapital, kanë rritur rezervat dhe fitimet e pashpërdara, si dhe kanë shtuar përdorimin e borxhit të varur. Sektori bankar, në tërësi, arriti të përmbushë kërkesat rregullatore për kapitalin në fund të vitit, sipas kalendarit të përcaktuar, dhe regjistroi një tepricë pozitive kapitali.

Tabelë 9. Tregues të aktivitetit të sistemit financiar

	2020	2021	2022	2023	2024	2025
Tregues të shëndetit financiar (sektori bankar)						
Kapitali rregullator ndaj aktiveve të peshuara me rrezik (%)	19	19	19	19	20	20
Huatë me probleme bruto ndaj totalit të huave (%)	8.1	5.7	5.0	4.7	4.2	3.8
Kthimi nga kapitali (bazë vjetore, %)	10.4	12.6	11.8	16.9	17.9	15.9
Aktive likuide ndaj detyrimeve afatshkurtra (%)	47	46	41	43	42	43
Depozita/Kredi (%)	211	214	212	217	202	194
Pozicioni i hapur neto në valutë ndaj kapitalit rregullator (%)	7.9	8.9	4.8	6.1	4.5	6.7
Pesha e aktiveve ndaj PBB-së (%)*						
Sektori bankar	97.8	93.9	87.8	84.5	83.0	87.5
IFJB dhe SHKK	4.9	4.7	4.5	4.4	4.3	4.2
Shoqëri sigurimi	2.4	2.2	2.0	2.0	2.2	2.4
Fonde pensioni dhe fonde investimi	4.4	4.3	2.2	2.3	2.9	3.2
Sistemi financiar	109.5	105.1	96.5	93.1	92.5	97.2

Burimi: Banka e Shqipërisë.

¹¹ Të dhënat e kredisë i referohet gjendjes së llogarisë "marrëdhënie me klientët", sipas bilancit të bankave në fund të periudhës së analizuar. Ato përfshijnë kreditë e dhëna nga sektori bankar për subjektet jofinanciare, private dhe publike, rezidente dhe jorezidente. Shifrat ndikohet nga largimi i kredive me probleme nga bilancet, si dhe nga luhatjet e kursit të këmbimit, ndaj mund të ndryshojë nga të dhënat e përdorura në analizën makroekonomike.



2.3.2. VLERËSIMI I RREZIQEVE SISTEMIKE DHE MASAT MAKROPRUDENCIALE

VLERËSIMI I RREZIQEVE SISTEMIKE

Zbutja dhe parandalimi i përhapjes së rreziqeve sistemike është objektivi kryesor i politikave makroprudenciale dhe kushti thelbësor për ruajtjen e stabilitetit financiar. Për këtë arsye, identifikimi i burimeve të këtyre rreziqeve dhe vlerësimi i intensitetit dhe i kanaleve të përhapjes së tyre kërkojnë një angazhim të rëndësishëm të kohës dhe burimeve të Bankës së Shqipërisë (BSH), si autoritet makroprudencial. Harta Makroprudenciale e Rreziqeve Sistemike, analizat mujore të treguesve të shëndetit financiar dhe ato tremujore të qëndrueshmërisë së sektorit bankar, së bashku me ushtrimet e provave të rezistencës shërbejnë si bazë për diskutimet dhe vendimmarrjen makroprudenciale, ndërsa materialet që publikohen si Raporti i Stabilitetit Financiar dhe analizat e vrojtimeve, përveç vendimmarrjes, mbështesin njëkohësisht transparencën dhe llogaridhënien e BSH-së ndaj publikut dhe sistemit financiar.

Sipas analizave të zhvilluara në mënyrë periodike deri në tremujorin e fundit të vitit, **situata financiare e sektorit bankar dhe e sistemit financiar është paraqitur e qëndrueshme, ndërsa ekspozimi ndaj rreziqeve sistemike ka qëndruar përgjithësisht në nivele** që sinjalizojnë rrezik disi më të lartë se ai i moderuar. Zonat më të nxehta të Hartës Makroprudenciale të Rreziqeve Sistemike lidhen me ecurinë e kredisë për pasuri të paluajtshme kryesisht rezidenciale dhe me ecurinë e çmimeve të këtyre pronave, nivelin e lartë të portofolit të kredisë në valutë – me gjithë vijimin e rënies së peshës së kredisë së pambrojtur në valutë – si dhe me hendekët e maturimit midis aktiveve dhe pasiveve. Edhe pse prirjet e konstatuara gjatë vitit 2025 tregojnë një zbutje të rreziqeve ose qëndrueshmëri në raport me periudhat pararendëse, këta tregues qëndrojnë ende në nivele mbi mesataret historike.

Në bazë të këtyre analizave, Banka e Shqipërisë vendosi të ruajë masat ekzistuese në formën e kërkesave të kapitalit, dhe të zbatojë për herë të parë kufij të sipërm ndaj raporteve të standardeve të kreditimit për pasuri të paluajtshme rezidenciale. Kështu, BSH ka vijuar të zbatojë masat makroprudenciale të kapitalit të mbështetura në rregulloren 41/2019 “Për shtesat makroprudenciale të kapitalit” dhe vendimeve të Guvernatorit “Për caktimin e shtesave makroprudenciale të kapitalit”. Sipas rregullores 41/2019, të gjitha bankat janë subjekt i plotësimit të kërkesës për: (i) shtesën konservuese të kapitalit (KONS) në nivelin maksimal të saj prej 2.5%; (ii) shtesën kundërciklike të kapitalit (KUNC), të barabartë me 0.5% të ekspozimeve të peshuara me rrezik; dhe (iii) shtesën e kapitalit për rëndësinë sistemike (SIST), e cila mban vlera në intervalin 0.5% deri në 1.5% dhe duhej të plotësohej prej tre nga katër bankat e shpallura si banka sistemike deri në fund të vitit 2025¹². Sipas vendimeve të Guvernatorit të shpallura gjatë vitit 2024, në fund të tremujorit të parë, të dytë,

¹² Kërkesa për shtesën për rëndësinë sistemike në masën 0.5% për një bankë të sistemit fillon të zbatohet nga data 1 janar 2026.



të tretë dhe atij të katërt të vitit 2025, të gjitha bankat vendase ishin subjekt i mbajtjes së shtesës kundërciklike të kapitalit (KUNC) prej përkatësisht 0%, 0.25% 0.25% dhe 0.5%. Rritja e normës së KUNC-it reflektoi nevojën për të zbutur rreziqet që burojnë nga zgjerimi i ciklit financiar dhe rritja e shpejtë e kreditimit.

Banka e Shqipërisë vlerëson që zbatimi i këtyre masave, i ndërthurur me përmbushjen e kërkesave të reja të lidhura me funksionin e ndërhyrjes së jashtëzakonshme në banka, ka ndihmuar forcimin e qëndrueshmërisë dhe shëndetit të sektorit bankar në vend.


Më 7 maj 2025, Këshilli Mbikëqyrës miratoi për herë të parë vendosjen e kufijve maksimalë për raportet “Kredi ndaj vlerës së kolateralit” dhe “Shërbimi i borxhit ndaj të ardhurave”, të cilat janë dy nga standardet më të rëndësishme të kredisë me objekt blerjen ose investimin në pasuri të paluajtshme rezidenciale. Zbatimi i këtyre kufijve pritet të sjellë uljen e rrezikut të mospagimit të kredisë nga ana e huamarrësve dhe të humbjeve të bankave, në rastin e zhvillimeve të pafavorshme në çmimet e pasurive të paluajtshme dhe në mjedisin makroekonomik të vendit. Këta kufij marrin në konsideratë dhe janë përshtatur për të adresuar në mënyrë proporcionale rrezikun, në varësi të llojit të pronës dhe monedhës në të cilën jepet kredia. Banka e Shqipërisë do të vlerësojë rregullisht përmbushjen e këtyre kërkesave nga ana e bankave, në bazë të raportimit të formularëve të miratuar me rregulloren 44/2023 “Për raportimin e të dhënave, identifikimin dhe monitorimin e treguesve mbi kredidhënien dhe investimet për pasuri të paluajtshme”.

Tabelë 10. Kufijtë për raportet “Kredi ndaj vlerës së kolateralit” dhe “Shërbimi i borxhit ndaj të ardhurave” në disbursim

Monedha e kredisë	Qëllimi i kredisë	Kufiri maksimal për:	
		Kredi/ Kolateral	Shërbimi i borxhit/ Të ardhura
Lek	Blerja e banesës së parë	≤ 85%	≤ 40%
Lek	Blerja e banesës së dytë dhe në vijim / për qëllime investimi	≤ 80%	≤ 35%
Monedhë e huaj	Blerja e banesës së parë	≤ 75%	≤ 35%
Monedhë e huaj	Blerja e banesës së dytë dhe në vijim / për qëllime investimi	≤ 70%	≤ 30%

2.3.3. KUADRI REGULLATIV DHE METODOLOJIK

Gjatë vitit 2025, Banka e Shqipërisë ka punuar për hartimin dhe rishikimin e disa ligjeve dhe akteve rregullative që lidhen me sistemin financiar dhe tregjet financiare. Ky proces është zhvilluar në përputhje me kuadrin ligjor dhe rregullativ të Bashkimit Evropian (BE), me synim përafrimin e mëtejshëm të *acquis* të BE-së. Këto akte përfshijnë projektligjin “Për institucionet e kreditit në Republikën e Shqipërisë, i cili synon të rregullojë veprimtarinë dhe mbikëqyrjen e institucioneve të kreditit. Ndërkohë, përfshirja e instrumenteve makroprudenciale në projektligjin “Për institucionet e kreditit në Republikën e Shqipërisë” forcon mandatin makroprudencial të BSH-së, si dhe siguron



një përafrim të konsiderueshëm, në aspektin cilësor dhe sasior, me kuadrin makroprudencial të BE-së.

Në kuadër të zbatimit të objektivave të përcaktuar në Strategjinë Afatmesme të Bankës së Shqipërisë "Për administrimin dhe mbikëqyrjen e rreziqeve financiare të lidhura me klimën në sektorin financiar gjatë 2023-2025", u punua për rishikimin e saj për periudhën 2026–2028. Përmes kësaj strategjie, synohet forcimi i integritit të implikimeve që rrjedhin nga ndryshimet klimatike në funksionet kryesore të BSH-së, si dhe në aktivitetin e sektorit bankar. Strategjia parashikon avancimin në tre drejtime kryesore: (i) mbikëqyrjen prudenciale dhe përfshirjen e rreziqeve klimatike në proceset e mbikëqyrjes dhe menaxhimit të rrezikut; (ii) stabilitetin financiar dhe vlerësimin e ndikimit të rreziqeve të klimës në rezultatet e provave të rezistencës; dhe (iii) zhvillimin e mjeteve analitike dhe aktiviteteve kërkimore për mbështetjen e politikave të gjelbra. Një ndër iniciativat kryesore të strategjisë është hartimi i Taksonomisë së Gjelbër të Shqipërisë, i cili do të kryhet në bashkëpunim me Bankën Evropiane të Investimeve. Për këtë qëllim, Banka e Shqipërisë ka ngritur një grup pune që do të koordinojë zhvillimin e kornizës së klasifikimit të aktiviteteve të qëndrueshme, të harmonizuar me standardet e BE-së. Korniza fillestare e taksonomisë pritet të përmbillet gjatë pjesës së parë të vitit 2027.



2.4. MBIKËQYRJA BANKARE

Funksioni mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë ka si objektiv kryesor identifikimin e hershëm dhe marrjen e masave për reduktimin e rreziqeve të aktivitetit të sektorit bankar: rrezikut të kredisë, rrezikut të likuiditetit, rrezikut operacional, rrezikut të normës së interesit, rrezikut të kapitalit dhe të përfitueshmërisë, atij të reputacionit dhe të pastrimit të parave etj. Gjithashtu, ky funksion synon dhe vlerësimin e efektivitetit të kontrolleve të brendshme dhe të qeverisjes së korporatave, si faktorë të rëndësishëm të zbutjes së rreziqeve në të gjithë sferën e veprimtarisë së bankave në veçanti, por edhe të subjekteve të tjera jobanka, të cilat licencohen nga Banka e Shqipërisë.

Veprimi në kohën e duhur, marrja e masave rregulluese efektive, nëpërmjet mbikëqyrjes së vazhdueshme, dhe zbatueshmëria e tyre, mbeten hallkat më të rëndësishme për të finalizuar me sukses qëllimin fundor: ruajtjen e shëndetit të subjekteve financiare.

2.4.1. ECURIA E SEKTORIT BANKAR DHE PRIORITETET MBIKËQYRËSE

SHËNDETI I SEKTORIT BANKAR

Viti 2025 shënoi zhvillime pozitive, veçanërisht në drejtim të përmirësimit të cilësisë së portofolit të kredisë së sistemit bankar. Në fund të vitit, treguesi i kredive me probleme zbriti në 3.8%, duke shënuar nivelin më të ulët historik që prej vitit 2008. Gjatë vitit, ky tregues u ul me 0.37 pikë përqindjeje, zhvillim ky që eci përkrah me rritjen e lartë të portofolit të kredisë me 13.45% në terma bruto¹³. Nivelet e kapitalizimit të sistemit bankar mbetën të larta dhe shënuan rritje përgjatë vitit. Në muajin dhjetor, treguesi i mjaftueshmërisë së kapitalit arriti në 20.36%, përkundrajt 19.52% në fund të vitit të kaluar, duke reflektuar forcimin e mëtejshëm të qëndrueshmërisë financiare të sektorit. Likuiditeti i sistemit bankar mbeti ndjeshëm mbi kërkesat minimale rregullatore, sikurse dëshmohet nga treguesi i mbulimit me likuiditet (273.3% nga 100%), raporti neto i financimit të qëndrueshëm (198% nga 100%), dhe treguesi i likuiditetit (43.3% nga 20%).

Rezultati financiar i sistemit rezultoi 36 miliardë lekë, ndërsa treguesit e përfitueshmërisë RoA dhe ROE ishin 1.64% dhe 15.94%.

Deri në fund të vitit vijuan të operojnë 11 banka tregtare, një numër i konsoliduar ky që prej fundit të vitit 2022. Megjithatë, panorama e sistemit bankar pritet të ketë ndryshime në reflektim të miratimeve paraprake të Bankës së Shqipërisë (BSH) për degën e bankës së huaj "Dega e Bankës Turkiye Cumhuriyeti Ziraat Bankasi A.S., Albania" dhe bankën "Jet Bank".

¹³ Të dhënat e kredisë i referohen gjendjes së llogarisë "marrëdhënie me klientët", sipas bilancit të bankave në fund të periudhës së analizuar. Ato përfshijnë kreditë e dhëna nga sektori bankar për subjektet jofinanciare, private dhe publike, rezidente dhe jorezidente. Shifrat ndikohet nga largimi i kredive me probleme nga bilancet, si dhe nga luhatjet e kursit të këmbimit, ndaj mund të ndryshojë nga të dhënat e përdorura në analizën makroekonomike.



KONTRIBUTI NË PROCESIN E INTEGRIMIT EVROPIAN

Në kuadër të procesit të integritimit në strukturat evropiane, është kryer një punë voluminoze për rishikimin dhe hartimin e kuadrit ligjor e rregullativ, e cila synon përafrimin e plotë të kërkesave të *acquis* të Bashkimit Evropian (BE). Njëkohësisht, ky proces ka synuar edhe adresimin e problematikave të ndeshura në subjektet e mbikëqyrura nga Banka e Shqipërisë. Pjesë e rëndësishme e këtyre proceseve ka qenë puna për hartimin e ligjit të ri për bankat në Republikën e Shqipërisë, i cili do të përafrojë plotësisht kërkesat e Direktivës 2013/36/EU (CRD IV/V/VI), dhe të disa dispozitave relevante të akteve të tjera të BE-së, si Rregullores 575/2013/EU (CRR) dhe Direktivës 2001/24/EC. Po kështu, gjatë vitit të kaluar ka filluar puna për hartimin e ndryshimeve të ligjit "Për shërbimet e pagesave", me qëllim sigurimin e përputhshmërisë së plotë me kërkesat e Direktivës të Shërbimeve të Pagesave të BE-së 2015/2366/EU (PSD2) dhe të disa dispozitave të Direktivës së Parasë Elektronike 2009/110/EC (EMD2).

RISHIKIMI I KUADRIT MBIKËQYRËS LIDHUR ME DIGJITALIZIMIN DHE SIGURINË KIBERNETIKE

Siguria e informacionit përbën një element kritik për stabilitetin operacional, besueshmërinë dhe pajtueshmërinë rregullatore të sektorit bankar. Në këtë kontekst, me qëllim përmirësimin e masave mbrojtëse të sektorit bankar në lidhje me rrezikun kibernetik dhe forcimin e vigjilencës mbikëqyrëse, Banka e Shqipërisë, në bashkëpunim me Zyrën e Asistencës Teknike të Thesarit Amerikan, ka hartuar dokumentin "Udhërrëfyesi i Vetëvlerësimit të Rrezikut Kibernetik", i cili është në përputhje me standardin ISO/IEC 27002. Ky dokument është subjekt zbatimi nga bankat dhe, bazuar në rezultatet e prodhuara nga ky proces, Banka e Shqipërisë ka hartuar një vlerësim të konsoliduar, me synim ofrimin e një pamjeje horizontale dhe të unifikuar mbi nivelin e maturitetit të proceseve dhe kontrolleve që lidhen me rrezikun kibernetik, si dhe mbi adresimin e problematikave që burojnë prej tij.

Gjithashtu, është hartuar projektregullorja "Për qëndrueshmërinë operacionale digjitale", në përputhje me kërkesat e Rregullores së BE-së 2022/2554/EU (DORA), si dhe me standardet teknike plotësuese të parashikuara në disa rregullore të deleguara të BE-së. Në zbatim të këtyre kërkesave, bankave do t'u duhet të përshtatin sistemet, strukturat dhe procedurat e brendshme në funksion të rritjes së qëndrueshmërisë operacionale digjitale dhe administrimit më të mirë të teknologjisë së informacionit e të komunikimit, si dhe menaxhimit më efektiv të rrezikut kibernetik.

FINANCA E GJELBËR

Në kuadër të financës së gjelbër dhe strategjisë së hartuar për përfshirjen e saj në proceset mbikëqyrëse, gjatë vitit 2025, bankat kanë raportuar formularin e vetëvlerësimit mbi përputhshmërinë e kuadrit të proceseve të tyre të brendshme të administrimit të rrezikut me pritshmëritë mbikëqyrëse. Ky raportim u realizua në përputhje me përcaktimet e udhëzuesit të publikuar një vit më herët. Bazuar mbi këto raportime, për secilën bankë është kryer një vlerësim i detajuar i nivelit



të përputhshmërisë dhe cilësisë së vetëvlerësimit. Njëkohësisht janë adresuar mangësitë e konstatuara dhe - atëherë kur ka qenë e nevojshme - është kërkuar ndryshimi i planeve për përmbushjen e kërkesave të udhëzuesit, veçanërisht në drejtim të shkurtimit të kohës së vënies së tyre në zbatim.

Po kështu, është punuar për hartimin e objektivave të strategjisë së ardhshme mbikëqyrëse për rritjen e përfshirjes së financave të gjelbra në proceset mbikëqyrëse dhe në vlerësimet e mëtejshme të bankave.

NDJEKJA E REKOMANDIMEVE TË MONEYVALIT

Gjatë vitit 2025 u punua për plotësimin e pyetësorëve të MoneyVal-it, si dhe për hartimin e disa ndryshimeve rregulatore për përmbushjen e rekomandimeve të vlerësimit të mëparshëm. Plotësimi i pyetësorit teknik dhe i efektivitetit do t'i paraprijë vlerësimit të Shqipërisë në këtë fushë (raundi 6).

Përmirësimet në kuadrin mbikëqyrës të kushteve dhe kriterëve të licencimit për zyrat e këmbimit valutor, rritja e kontrolleve, dhe e cilësisë së raportimit në fushën e parandalimit të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit – duke përfshirë dhe bashkëpunimin ndërinstitucional, veçanërisht me Autoritetin e Inteligjencës Financiare (AIF) – kanë qenë ndër prioritetet kryesore të Bankës së Shqipërisë. Këto prioritete përputhen me rekomandimet e MoneyVAL-it dhe i paraprijnë vlerësimit të radhës, i cili do të kryhet gjatë vitit 2026.

MBROJTJA KONSUMATORE

Në funksion të mbrojtjes së konsumatorit janë forcuar kërkesat për transparencë në produktet dhe shërbimet financiare, veçanërisht në drejtim të informimit të klientëve për normat e interesit, kostot totale, komisionet dhe kushtet kontraktuale. Subjektet janë orientuar në drejtim të përdorimit të një gjuhe më të qartë dhe të unifikuar, në mënyrë që konsumatorët të marrin vendime të informuara.

Në këtë drejtim vijon të evidentohet rënia e normës efektive të interesit, si rezultat i masave të marra për vendosjen e limitit maksimal të kësaj norme për ekspozimet me natyrë konsumatore. Si rezultat i kësaj ndërhyrjeje, norma efektive e interesit e institucioneve jobanka paraqitet në nivelin prej rreth 62%, përkundrajt nivelit 95% që ishte në fund të vitit 2024.

VLERËSIMI I EKVALENCËS SË KUADRIT MBIKËQYRËS RREGULLATIV

Në kuadër të vlerësimit të përshatshmërisë së kuadrit ligjor e rregullativ dhe praktikave mbikëqyrëse me standardet më të avancuara evropiane, gjatë vitit 2025 është vijuar me procesin e ekuivalencës. Nëpërmjet këtij procesi, Autoriteti Bankar Evropian (EBA), bën vlerësimin e proceseve mbikëqyrëse sipas një metodologjie të raportuar prej tij. Aktualisht, Banka e Shqipërisë është në ndjekje të hapave dhe orientimeve të EBA-s lidhur me proceset e parashikuara prej saj.



BASHKËPUNIMI ME AUTORITETET NDËRKOMBËTARE

Bashkëpunimi me autoritetet homologe, në kuadër të kolegjeve mbikëqyrëse, ka vijuar edhe këtë vit. Ky mekanizëm i ngritur prej disa vitesh, mundëson mbledhjen e mbikëqyrësve nga vende të ndryshme për të diskutuar mbi ecurinë dhe problematikat që lidhen me veprimtarinë e një institucioni të caktuar bankar në juridiksionin përkatës.

Gjatë vitit 2025, Banka e Shqipërisë ka marrë pjesë rregullisht në këto takime. Në veçanti, për grupin e Bankës Raiffeisen, kolegji i mbikëqyrësve u organizua në Shqipëri, në ambientet e Bankës së Shqipërisë¹⁴. Në të morën pjesë mbikëqyrës nga disa vende të Evropës, ku grupi është i pranishëm.

2.4.2. EKZAMINIMET NË VEND

Gjatë vitit 2025 janë kryer në total 12 ekzaminime në vend, konkretisht: 3 ekzaminime të plota dhe 1 ekzaminim i pjesshëm në banka; 3 ekzaminime të plota dhe 1 ekzaminim i pjesshëm në subjekte jobanka; 2 ekzaminime të plota në institucione të parasë elektronike; dhe 2 ekzaminime të pjesshme në shoqëri kursim-kreditit (SHKK).

Tabelë 11. Numri i ekzaminimeve sipas tematikës, për vitin 2025

Inspektive të kryera në subjekte	Rreziku Strategjik	Rreziku Organizativ	Rreziku i Kredisë	Rreziku i Likuiditetit	Rreziku i Normës së Interesit	Rreziku i Tregut	Teknologjia e Informacionit dhe e Komunikimit	Rreziku Operacional	Rreziku Reputacional	Përfutshmeria	Kapitali
2023	8	8	8	8	4	8	7	7	61*	8	8
2024	11	10	9	11	3	11	8	8	48**	11	11
2025	3	11	12	12	3	11	8	9	35***	11	11

* Në vitin 2023 janë kryer ekzaminime në 50 zyra të këmbimit valutor për Rrezikun Reputacional dhe 11 ekzaminimet e tjera për këtë rrezik janë kryer në banka dhe institucione financiare jobanka.

** Në vitin 2024 janë kryer ekzaminime në 37 zyra të këmbimit valutor për Rrezikun Reputacional dhe 11 ekzaminimet e tjera për këtë rrezik janë kryer në banka dhe institucione financiare jobanka.

*** Në vitin 2025 janë kryer ekzaminime në 26 zyra të këmbimit valutor për Rrezikun Reputacional dhe 9 ekzaminimet e tjera për këtë rrezik janë kryer në banka dhe institucione financiare jobanka.

Gjatë vitit u realizuan ekzaminime për dy banka sistemike dhe dy banka josistemike. Ekzaminimet e plota kanë mbuluar të gjitha aspektet e veprimtarisë së bankave, ndërsa fokusi i ekzaminimit të pjesshëm ka qenë menaxhimi i rrezikut të portofolit të kredisë, cilësia e aktiveve të tjera në bilancin e bankës dhe rreziku i likuiditetit. Vëmendje e veçantë në ekzaminime i është kushtuar marrëdhënieve me palët e lidhura me bankën dhe zbatimit të parimeve të

¹⁴ College of Supervisors Meeting organized by the European Central Bank (ECB); hosted by the Bank of Albania



kujdesit nga ana e bankave, për zhvillimin e këtyre marrëdhënieve në kushte të ngjashme me klientët e zakonshëm.

Ajo që vihet re në lidhje me zhvillimet e vazhdueshme në kuadër të procesit të digjitalizimit dhe të ndërthurjes së sistemeve e teknologjive të ndryshme të përdorura gjatë aktivitetit të bankave është nevoja për të balancuar sa më mirë nivelin e shpenzimeve të nevojshme kapitale e operacionale në këtë drejtim me objektivat dhe vëllimet e synuara të biznesit, me qëllim arritjen e niveleve të pranueshme të aktivitetit, që justifikojnë investimet e kryera dhe nivelin e rrezikut operacional e kibernetik të marrë përsipër.

Në përfundim të proceseve të ekzaminimeve janë lënë një sërë rekomandimesh, si dhe janë marrë masa administrative si gjopa dhe vërejtje për administratorët, apo edhe kufizime të veprimtarive të caktuara, të cilat janë konsideruar të nevojshme për një qasje prudençiale, në drejtim të zhvillimit të veprimtarisë së shëndetshme bankare.

Edhe gjatë vitit 2025, ekzaminimet e subjekteve të tjera, përveç bankave, janë orientuar nga mbulimi i kategorive të ndryshme të veprimtarisë, në përputhje me pjesën e tregut që zotërojnë sipas aktivitetit përkatës (subjekte jobanka, shoqëri kursim-kredit, institucione të parasë elektronike). Në fokus ka qenë modeli i biznesit, sistemet e qeverisjes, rreziku i kredisë, rreziqet e tregut dhe ato operacionale, saktësia e raportimeve në BSH, transparencë me klientët dhe rreziku i pastrimit të parave. Në veçanti, për subjektet që ekzaminohen për herë të parë, vëmendje i është kushtuar realizimit të parashikimeve që kanë shoqëruar aplikimin për licencë dhe qëndrueshmërisë së modelit të biznesit ku mbështetet aktiviteti.

Në përgjithësi, aktiviteti i këtyre subjekteve gjeneron të ardhura të qëndrueshme që kanë mbështetur kapitalin në vazhdimësi. Megjithatë, nevojiten përmirësime në drejtim të cilësisë së qeverisjes, plotësimit të kuadrit të brendshëm organizativ dhe rregullator, mbështetjes me sisteme të automatizuara dhe teknologji etj. Të gjitha këto elemente duhet të zhvillohen dhe plotësohen në përputhje me rritjen e aktivitetit.

Për shkeljet dhe mangësitë e evidentuara, Banka e Shqipërisë ka marrë masat përkatëse mbikëqyrëse, konkretisht, rekomandime me afate konkrete për adresimin e dobësive, gjobitjen e 2 institucioneve të parasë elektronike, pezullimin e aktivitetit për një subjekt jobankë dhe revokimin e licencave për një SHKK, dy subjekte jobanka dhe një institucion pagese.

Ndërkohë, është kryer procesi i inspektimeve në vend për 26 zyra të këmbimit valutor (ZKV) – proces i cili përfshin edhe ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve – ndërsa në një ZKV është kryer një inspektim i përbashkët me AIF-në. Për ZKV-të, gjatë periudhës shkurt–mars, është zhvilluar fushata e ndjekjes së raportimeve në BSH. Si rezultat i këtij procesi, janë marrë 200 masa administrative, si dhe, në disa raste, subjekteve u është hequr licenca.



2.4.3. RISHIKIMI I KUADRIT RREGULLATIV DHE METODOLOGJIK

Gjatë vitit 2025, Banka e Shqipërisë vijoi angazhimin për përmirësimin dhe konsolidimin e kuadrit rregullativ, përmes hartimit të akteve të reja nënligjore dhe rishikimit të rregulloreve ekzistuese. Ky proces u orientua nga nevoja për përafrimin e mëtejshëm të legjislacionit vendas me *acquis* të BE-së, si dhe nga adresimi i zhvillimeve dhe problematikave të evidentuara gjatë ushtrimit të funksionit mbikëqyrës ndaj bankave dhe subjekteve të tjera financiare të licencuara dhe të mbikëqyrura prej saj.

Gjatë vitit, u hartuan dhe rishikuan disa akte nënligjore që synojnë të rregullojnë veprimtarinë dhe mbikëqyrjen e ofruesve të shërbimeve të pagesave. Gjithashtu, u punua edhe për hartimin e kuadrit rregullativ për administrimin e rrezikut operacional për bankat, institucionet e pagesave dhe institucionet e parasë elektronike, si dhe rishikimin e kërkesave për administrimin e rrezikut operacional për subjektet financiare jobanka dhe shoqëritë e kursim-kreditit, shoqëruar edhe me rishikimin e sistemeve raportuese përkatëse.

Në mënyrë më të detajuar, zhvillimet në kuadrin rregullativ gjatë vitit 2025, paraqiten në vijim.

I. Rishikimi i kërkesave për mbrojtjen e konsumatorëve:

- Miratimi i disa ndryshimeve në rregulloren “Për kredinë konsumatore dhe kredinë hipotekare”, që konsistojnë në përfshirjen e disa kërkesave të shtuara, me qëllim reduktimin e kostove në ngarkim të konsumatorit në kontratat e kredisë konsumatore me këste, kryesisht në vlera të vogla (në fashën 0-200.000 lekë).
- Miratimi i disa ndryshimeve në rregulloren “Mbi transparencën për produktet dhe shërbimet bankare e financiare”, që konsistojnë në përfshirjen e disa kërkesave të shtuara për rritjen e transparencës ndaj konsumatorëve, që në fazën e reklamimit të produkteve e shërbimeve për këta të fundit, nëpërmjet standardizimit të kërkesave për subjektet, si dhe duke dalluar sipas tipologjisë së produktit apo shërbimit që po reklamohet.

- #### II. Përmirësimi dhe forcimi i kërkesave licencuese dhe mbikëqyrëse,
- me qëllim parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit. Këtu përfshihet miratimi i disa ndryshimeve në rregulloren “Për licencimin, organizimin, veprimtarinë dhe mbikëqyrjen e zyrave të këmbimit valutor”, që konsistojnë në përmirësimin e procesit të licencimit dhe të mbikëqyrjes së këtyre subjekteve, për sa lidhet me aspektet e parandalimit të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, por edhe në drejtim të forcimit të rregullave të hyrjes në treg të subjekteve që janë financiarisht të qëndrueshme dhe me integritet.



2.4.4. KUADRI LICENCUES DHE MIRATIMET

Sektori bankar, edhe gjatë vitit 2025, vazhdoi të mbizotërohet nga prania e filialeve të grupeve të huaja bankare, me origjinë të kapitalit kryesisht nga BE-ja, ndërkohë që numri i bankave që operojnë në vend nuk ka ndryshuar, krahasuar me një vit më parë. Në fund të vitit 2025, në vend operonin 11 banka.

Tabelë 12. Struktura e pronësisë së bankave, numri i bankave (fund i periudhës)

	2017	2018	2019	2020	2021	2022	2023	2024	2025
Bankat në Shqipëri, prej të cilave:	16	14	12	12	12	11	11	11	11
I. Me kapital privat me shumicën e pronësisë¹ së huaj	13	11	8	8	8	6	6	6	6
• nga vendet e BE-së	9	7	6	6	6	5	5	5	5 ²
• nga Turqia	1	1	1	1	1	1	1	1	1 ³
• nga një institucion financiar ndërkombëtar (Arabia Saudite)	1	1	1	1	1 ⁴				
II. Me kapital privat me shumicën e pronësisë vendase	3	3	4	4	4	5	5	5	5⁵

Burimi: Banka e Shqipërisë.

¹ "Shumicë" është në çdo rast shumica e thjeshtë e 50% të votave plus 1 votë.

² Bankat me origjinë të kapitalit nga vendet e BE-së, në fund të vitit 2025, janë nga: Italia (Banka Intesa Sanpaolo Albania), Austria (Banka Raiffeisen), Gjermania (Banka Procredit), Hungaria (Banka OTP Albania), Bullgaria (Banka e Parë e Investimeve, Albania).

³ Banka Kombëtare Tregtare.

⁴ Banka e Bashkuar e Shqipërisë.

⁵ Bankat me shumicë kapitali vendas, në fund të vitit 2025, janë: Banka Union, Banka Credins, Banka Amerikane e Investimeve, Banka Tirana dhe Banka e Bashkuar e Shqipërisë.

Gjatë vitit 2025, Banka e Shqipërisë dha miratimet paraprake përkatësisht: për licencimin e degës së bankës së huaj (Ziraat Bank) dhe licencimin e bankës digjitale (JET Bank), si dhe për riorganizimin e bankës, nëpërmjet bashkimit me përthithje (subjekti financiar jobankë NOA sh.a. përthithet nga Banka Amerikane e Investimeve). Gjithashtu, miratimet u dhanë edhe për: transferimin e pjesëmarrjes influencuese (kontrolluese)/ të tërthortë të 1 banke; transferimin e pjesëmarrjes influencuese (kontrolluese)/ ndryshimin e strukturës së kapitalit të 2 subjekteve financiare jobanka dhe të 2 institucioneve të parasë elektronike; ndryshimet në statutet e 2 bankave; emetimin e borxhit të varur nga 7 banka; dhe shlyerjen e borxhit të varur nga 2 banka; miratimin e emërimit të ekspertëve kontabël të autorizuar (audituesit ligjorë) për auditimin e pasqyrave financiare të vitit 2025 të të gjithë bankave.

Banka e Shqipërisë dha miratimet për 32 administratorë të bankave, të cilët, sipas pozicioneve, renditen në: 14 anëtarë të këshillave drejtues, 9 anëtarë të komiteteve të kontrollit dhe 9 drejtues ekzekutivë dhe drejtues të kontrollit të brendshëm të bankave.

Gjatë vitit, rrjeti i bankave u zgjerua me 8 degë të reja brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, duke e çuar numrin total degëve / agjencive bankare në 408, në fund të vitit.

Mbështetur në aplikimet e paraqitura, Banka e Shqipërisë licencoi 1 institucion të ri të parasë elektronike Happy Pay sh.a. dhe miratoi ushtrimin e veprimtarisë financiare shtesë (shërbimi i inicimit të pagesës dhe shërbimi i informimit të



llogarisë) për 1 institucion të parasë elektronike.

Në fund të vitit 2025, ushtronin veprimtarinë financiare 36 subjekte financiare jobanka (përfshirë dhe institucione financiare të mikrokredisë), institucione të pagesave dhe institucione të parasë elektronike, pas revokimit të licencës së dy subjekteve.

Për subjektet financiare jobanka dhe institucionet e parasë elektronike, u dhanë gjithashtu miratimet paraprake për 10 administratorë, 2 kryetarë të këshillit mbikëqyrës dhe 2 kryetarë të komitetit të kontrollit.

Gjithashtu, u dhanë miratimet për emërimet e ekspertëve kontabël të autorizuar për auditimin e pasqyrave financiare të fundvitit 2025 për institucionet e pagesave dhe institucionet e parasë elektronike.

Vendimmarrja e Bankës së Shqipërisë, në kuadër të përmbushjes së funksionit licencues, për shoqëritë e kursim-kreditit (SHKK) dhe unionet e shoqërive të kursim-kreditit, konsistoi në dhënien e miratimit për riorganizimin juridik të një SHKK-je, nëpërmjet bashkimit me përhithje të një SHKK-je tjetër, dhënien e miratimit për emërimin/riemërimin e 5 administratorëve të SHKK-ve, 4 kryetarë të Këshillit Drejtues, si dhe 4 kryetarë të Komitetit të Kontrollit.

Në fund të vitit, ushtronin veprimtari 1 union i shoqërive të kursim-kreditit dhe 15 shoqëri të kursim-kreditit (6 me status të pezulluar), pas revokimit të licencës së 1 shoqërie të kursim-kreditit.

Gjatë vitit, u licencuan 33 zyra të reja të këmbimit valutor dhe iu revokua licenca 83 zyrave ekzistuese. Në fund të vitit 2025, ushtronin aktivitetin 592 zyra të këmbimit valutor.

Tabelë 13. Numri i bankave, subjekteve financiare jobanka, shoqërive të kursim-kreditit dhe zyrave të këmbimit valutor të licencuara nga Banka e Shqipërisë (fund i periudhës)

	2017	2018	2019	2020	2021	2022	2023	2024	2025
Banka	16	14	12	12	12	11	11	11	11
Subjekte financiare jobanka	31	30	32	30	35	38	39	37	36
Zyra të këmbimit valutor	426	463	503	538	556	583	621	642	592
Unione të shoqërive të kursim-kreditit	1	1	1	1	1	1	1	1	1
Shoqëri të kursim-kreditit	13	13	14	14	16	16	16	16	15

Burimi: Banka e Shqipërisë.



2.5. NDËRHYRJA E JASHTËZAKONSHME

Ligji “Për rimëkëmbjen dhe ndërhyrjen e jashtëzakonshme në banka në Republikën e Shqipërisë” i jep Bankës së Shqipërisë kompetencën e Autoritetit të Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme në vend.

Ky mandat ligjor synon të sigurojë një ndërhyrje të jashtëzakonshme të organizuar tek bankat me paaftësi paguese, duke shmangur ndikimin e tyre negativ në sistemin financiar dhe në ekonominë reale, duke minimizuar përdorimin e parave të taksapaguesve, si edhe duke garantuar mbrojtje të depozitave të siguruara dhe të aktiveve të klientëve.

Gjatë vitit 2025, Banka e Shqipërisë (BSH) vijoi punën në drejtim të fuqizimit të aftësisë së bankave për zbatimin e ndërhyrjes së jashtëzakonshme. Në këtë kuadër, ajo mbajti një dialog të qëndrueshëm me sektorin bankar, duke monitoruar rregullisht përmbushjen e programit vjetor të punës për zhvillimin e kapaciteteve të tij, si pjesë e procesit të planifikimit të ndërhyrjes së jashtëzakonshme, dhe në përmbushje të rekomandimeve të komunikuara, si pjesë e procesit vjetor të inspektimit në banka.

Gjatë vitit rezulton të jetë bërë një progres i rëndësishëm në rritjen e aftësisë dhe kapacitetit të bankave për të mbështetur ekzekutimin e ndërhyrjes së jashtëzakonshme. Monitorimi i kërkesës minimale për instrumente të kapitalit rregullator dhe detyrimeve të pranuar – MREL, konstatoi përmbushjen e nivelit të ndërmjetëm nga të gjitha bankat e identifikuara me strategji ndërhyrjen e jashtëzakonshme. Nëpërmjet bashkëpunimit me institucione ndërkombëtare, si Banka Botërore (FinSAC) dhe BERZH, Banka e Shqipërisë është përqendruar në operacionalizimin e instrumenteve të ndërhyrjes së jashtëzakonshme dhe në përgatitjen e dokumenteve udhëzuese apo manualeve, duke synuar rritjen e zbatueshmërisë së saj, me qëllim ruajtjen e stabilitetit financiar në vend.

Në fund të vitit 2025, “Fondi i ndërhyrjes së jashtëzakonshme”, i cili është krijuar dhe rritur nga kontributet vjetore të bankave, arriti në 7.02 miliardë lekë, pas pagimit të kontributit vjetor nga të gjitha bankat e sektorit në shumën 1.041 miliardë lekë.

Banka e Shqipërisë, e angazhuar në reformat dhe proceset për përafrimin e legjislacionit të ndërhyrjes së jashtëzakonshme në Shqipëri me atë të BE-së, dhe e asistuar nga programi TALEX i Komisionit Evropian, ka filluar punën për rishikimin e kuadrit ligjor të ndërhyrjes së jashtëzakonshme.

Në mbështetje të marrëveshjes së bashkëpunimit të nënshkruar me Bordin e Përbashkët të Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme, në vitin 2025, Banka e Shqipërisë mori pjesë në mbledhjet e Kolegjeve të Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme për dy grupe bankare evropiane që operojnë me filiale në Shqipëri.



2.5.1. FUQIZIMI I AFTËSISË PËR NDËRHYRJE TË JASHTËZAKONSHME

PLANET E NDËRHYRJES SË JASHTËZAKONSHME

Në zbatim të kuadrit ligjor e rregullator, Banka e Shqipërisë përditëson çdo vit planet e ndërhyrjes së jashtëzakonshme për të gjitha bankat që operojnë në Shqipëri. Gjatë ciklit të vitit 2025, BSH-ja i përditësoi ato sipas informacionit periodik të raportuar nga bankat për qëllime të ndërhyrjes së jashtëzakonshme, raportimet për qëllime mbikëqyrëse e statistikore, si dhe rezultatet dhe informacionet e përfuara gjatë procesit të inspektimit në vend, të realizuar gjatë muajit qershor 2025.

Si pjesë e procesit vjetor të planeve, gjatë vitit 2025 u realizua identifikimi dhe vlerësimi i funksioneve ekonomike me rëndësi kritike për sektorin bankar, si dhe vlerësimi i interesit publik për të gjitha bankat. Ky test vlerëson përmbushjen e objektivave të ndërhyrjes së jashtëzakonshme për të gjitha bankat, të cilat kryejnë të paktën një funksion kritik. Gjithashtu, për zbatimin e strategjisë së preferuar për ndërhyrje të jashtëzakonshme, janë vlerësuar masat që duhet të ndërmarrin bankat në drejtim të aftësisë së tyre për zbatimin e saj. Në përfundim të këtij procesi, secilës bankë i është komunikuar përmbledhja ekzekutive e planit të ndërhyrjes së jashtëzakonshme, duke u fokusuar në vlerësimin e aftësisë që ka banka për të zbatuar në mënyrë eficiente strategjinë e ndërhyrjes së jashtëzakonshme.

Gjatë vitit 2025, bankat kanë përparuar në mënyrë sistematike në drejtim të rritjes së kapaciteteve për përthithjen e humbjeve dhe rikapitalizimin e tyre. Ato kanë shënuar zhvillime pozitive në përgatitjen për sigurimin e vazhdimësisë operacionale dhe ruajtjen e aksesit në tregun financiar, në përmirësimin e metodologjisë së parashikimit të nevojave për likuiditet në ndërhyrje të jashtëzakonshme, në identifikimin dhe mobilizimin e kolateraleve, si dhe në planin e komunikimit në ndërhyrje të jashtëzakonshme. Në përmbushje të përparësive për ciklin e planeve të vitit, bankat punuan për përgatitjen e manualit operacional për rikapitalizimin nga brenda.

Banka e Shqipërisë ka përcaktuar dhe u ka komunikuar bankave prioritetet për vitin 2026, të cilat lidhen me përfundimin e manualit operacional për rikapitalizimin nga brenda dhe përgatitjen e të dhënave të nevojshme për realizimin e vlerësimit në ndërhyrje të jashtëzakonshme.

INSPEKTIMET NË BANKA

Banka e Shqipërisë ka vijuar punën për zhvillimin e aftësisë për ndërhyrje të jashtëzakonshme në banka, edhe nëpërmjet procesit të inspektimeve. Në këtë kuadër, gjatë muajit qershor 2025, ajo realizoi inspektimin vjetor pranë bankave, të cilat ofrojnë funksione kritike për ekonominë, duke u fokusuar në vlerësimin e përmbushjes së rekomandimeve të komunikuar gjatë ciklit të vitit 2024 dhe të prioritetëve për ciklin e planeve për ndërhyrjen e jashtëzakonshme për vitin 2025. Në vijim të këtij procesi, BSH-ja përgatiti raportet individuale



për secilën bankë, duke u mbështetur në progresin e arritur për rritjen e aftësisë për të zbatuar ndërhyrjen e jashtëzakonshme, sipas strategjisë dhe instrumentit të përzgjedhur në planin përkatës.

Gjatë këtij viti, u evidentuan një sërë masash të ndërmarra nga bankat në drejtim të hartimit dhe ndjekjes së programit vjetor të punës për: (i) rritjen e aftësisë së tyre për zbatimin e ndërhyrjes së jashtëzakonshme; (ii) përmirësimin e proceseve të qeverisjes në ndërhyrje të jashtëzakonshme; (iii) sigurimin e cilësisë së informacionit, nëpërmjet përfshirjes së njësisë së kontrollit të brendshëm; (iv) garantimin e burimeve të mjaftueshme financiare për zbatimin e strategjisë së preferuar për ndërhyrje të jashtëzakonshme, nëpërmjet përmbushjes së nivelit vjetor të kërkesës për MREL etj.

Krahas hapave pozitivë të ndërmarrë përgjatë vitit, në përfundim të procesit të ekzaminimit, Banka e Shqipërisë evidentoi dhe i komunikoi secilës bankë rekomandimet përkatëse, në drejtim të rritjes së aftësisë së tyre për zbatimin e ndërhyrjes së jashtëzakonshme, për përmbushjen dhe adresimin e të cilave bankat kanë raportuar në mënyrë periodike.


2.5.2. KËRKESA MINIMALE PËR INSTRUMENTE TË KAPITALIT RREGULLATOR DHE DETYRIME TË PRANUARA (MREL)

“Kërkesa minimale për instrumente të kapitalit rregullator dhe detyrime të pranuar” – MREL si një nga elementet kryesore për përgatitjen financiare të bankave lidhur me aftësinë për ndërhyrje të jashtëzakonshme – ka qenë në fokus të punës së Bankës së Shqipërisë. Nëpërmjet përmbushjes së kësaj kërkesë, sektori bankar vijon të ndërtojë në mënyrë graduale kapacitetet financiare për të përthithur humbjet dhe për t’u rikapitalizuar përmes burimeve të brendshme, në rast se i nënshtrohet ndërhyrjes së jashtëzakonshme.


Në zbatim të kuadrit rregullator, gjatë periudhës së ndërmjetme të përmbushjes së kërkesës MREL brenda vitit 2027, Banka e Shqipërisë iu komunikoi bankave nivelin vjetor të ndërmjetëm për t’u plotësuar brenda 12 muajve të ardhshëm.

Gjatë vitit 2025, sektori bankar përmbushi nivelin e ndërmjetëm të kërkesës për MREL, të komunikuar në vitin 2024, duke përdorur instrumente të kapitalit rregullator dhe detyrime të pranuar. Në dhjetor, kapaciteti i MREL-it në nivel të agreguar arriti në 25.1% të ekspozimeve të ponderuara me rrezik, kundrejt objektivit mesatar vjetor të ndërmjetëm prej 20.2%, të përcaktuar nga BSH-ja, për të gjitha bankat që i nënshtrohen kërkesës për MREL.

Grafik 26. Kapaciteti MREL (në përqindje të aktiveve të ponderuara me rrezik)



Burimi: Banka e Shqipërisë.



Në dhjetor 2025, bankave iu komunikua vendimi për nivelin e ndërmjetëm të kërkesës për MREL, i cili duhet të plotësohet për vitin 2026. Përbushja në vijimësi e objektivit të ndërmjetëm, përbën një hap të rëndësishëm drejt objektivit përfundimtar, për financimin e plotë të kësaj kërkesë rregullatore brenda vitit 2027. Banka e Shqipërisë monitoron në mënyrë periodike aftësinë e sektorit bankar për të përbushur kërkesën për MREL, si pjesë e procesit vjetor të hartimit të planeve të ndërhyrjes së jashtëzakonshme.

HAPËSIRË INFORMUESE 4


BURIMET E FINANCIMIT TË KËRKESËS MREL GJATË VITIT 2025

Gjatë vitit 2025, sektori bankar ka vijuar të diversifikojë strategjinë e financimit të kërkesës MREL, duke rritur financimin përmes burimeve në tregun ndërkombëtar. Gjatë vitit 2025, u realizua me sukses emetimi nga sektori bankar i obligacioneve "të paguarantuar", të pranuar për qëllime të MREL, në monedhën Euro dhe Lek. Emetimet e reja shënuan rreth 13 miliardë lekë. Për rrjedhojë, në fund të vitit 2025, stoku i "detyrimeve të pranuar" në bilancin e sektorit bankar arriti në 29.7 miliardë lekë, nga 16.7 miliardë lekë që shënonte një vit më parë.

Në reflektim të këtyre zhvillimeve, në fund të vitit 2025, struktura e MREL përbëhej nga rreth 77.8% instrumente të kapitalit të nivelit të parë, 7.8% instrumente të kapitalit të nivelit të dytë dhe 14.5% detyrime të pranuar, në ndryshim nga viti 2024, ku rreth 83.9% e kësaj kërkesë financohej me instrumente të kapitalit të nivelit të parë, 6.5% me instrumente të kapitalit të nivelit të dytë dhe 9.6% me detyrime të pranuar. Kjo strukturë evidenton zhvillimin e financimit të kërkesës për MREL, e cila në vitin 2022, si vit i parë i përbushjes së saj, kontribuues kryesorë të financimit kishte kapitalin e nivelit të parë dhe të dytë, përkatësisht me 92.6% dhe 5.2%, dhe detyrimet e pranuar në masën 2.3%.

Këto zhvillime reflektojnë përbushjen në vijimësi të kërkesave rregullative të sektorit bankar dhe qëndrueshmërinë në diversifikimin e burimeve të financimit të aktivitetit të bankave, e cila rrit qëndrueshmërinë financiare dhe forcon bilancin e tyre.

Grafik 27. Burimet e financimit të MREL në miliardë lekë për grupin e bankave që i nënshtrohen kësaj kërkesë (majtas) dhe struktura e MREL në dhjetor 2025 (djathtas)



2.5.3. **PLOTËSIMI I KUADRIT RREGULLATOR DHE METODOLOGJIK PËR NDËRHËRJEN E JASHTËZAKONSHME**

Në kuadër të zhvillimit të kuadrit rregullator dhe metodologjik, gjatë vitit 2025, BSH-ja punoi për plotësimin e mëtejshëm të tij, në funksion të operacionalizimit të instrumenteve të ndërhyrjes së jashtëzakonshme dhe të zhvillimit të kapaciteteve për zbatimin e saj.

- a. Në zbatim të rregullores nr.78/2020 “Për kërkesën minimale për instrumente të kapitalit rregullator dhe detyrime të pranuara” (MREL) dhe në përputhje me ciklin vjetor të konsultimit, BSH-ja dërgoi pranë bankave dokumentin “Mbi metodologjinë, politikat dhe mënyrën e përmbushjes së kërkesës minimale për instrumente të kapitalit rregullator dhe detyrime të pranuara” për ciklin vjetor të vitit 2025. Në vijim të dialogut të përvitshëm me bankat, metodologjia për llogaritjen e kërkesës për MREL nuk pësoi ndryshime.
- b. Në kuadër të operacionalizimit të instrumenteve të ndërhyrjes së jashtëzakonshme, BSH-ja, nëpërmjet asistencës teknike të Bankës Botërore (*FinSAC*), hartoi udhëzuesin operacional për zbatimin e instrumentit të rikapitalizimit nga brenda, së bashku me kërkesat minimale për të dhënat e nevojshme për këtë qëllim. Ky udhëzues adreson veprimet e brendshme dhe të jashtme që ndërmerren për të zbatuar në mënyrë efektive instrumentin e rikapitalizimit nga brenda dhe shërben si një dokument orientues për bankat, për hartimin e një udhëzuesi të posaçëm operacional nga ana e tyre, në zbatimin e këtij instrumenti.
- c. Nëpërmjet bashkëpunimit me Bankën Botërore (*FinSAC*), BSH-ja filloi punën për hartimin e udhëzuesit për operacionalizimin e instrumentit të bankës urë, i cili pritet të përfundojë gjatë vitit 2026.


Përgjatë vitit 2026, Banka e Shqipërisë do të vazhdojë të punojë për rishikimin e ligjit 133/2016 “Për rimëkëmbjen dhe ndërhyrjen e jashtëzakonshme në banka në Republikën e Shqipërisë”, me qëllim përafrimin e legjisllacionit të ndërhyrjes së jashtëzakonshme me direktivën e BE-së që rregullon rimëkëmbjen dhe ndërhyrjen e jashtëzakonshme në banka, e asistuar nga programi TAIEK i Komisionit Evropian. Gjithashtu, duke synuar rritjen e aftësisë së bankave për zbatueshmërinë e strategjisë dhe instrumenteve të ndërhyrjes së jashtëzakonshme dhe përmbushjen e prioriteteve vjetore të planifikimit të ndërhyrjes së jashtëzakonshme, BSH-ja parashikon hartimin e një sërë manualesh dhe dokumentesh metodologjike.



2.5.4. OPERACIONALIZIMI I FONDIT TË NDËRHYRJES SË JASHTËZAKONSHME

Në fund të vitit 2025, mjetet financiare të Fondit të Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme arritën në 7.02 miliardë lekë. Që prej vitit 2018, sektori bankar ka kontribuar çdo vit për përmbushjen e nivelit të synuar të Fondit, në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi. Sipas këtij kuadri, niveli i synuar i Fondit të Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme, që duhet të arrihet deri në vitin 2027, është 0.5% e totalit të detyrimeve të sektorit bankar.

Grafik 28. Fondi* për ndërhyrjen e jashtëzakonshme dhe niveli i synuar në vitin 2027, milionë Lekë



Burimi: Banka e Shqipërisë.
*Viti 2025 - të dhëna paraprake.

Në vitin 2025, niveli i synuar i Fondit vlerësohej rreth 8.86 miliardë lekë. Kontributi vjetor i bankave, i paguar në muajin prill, në vlerën 1.041 miliardë lekë, e çoi nivelin e tij në 79.2% të objektivit për vitin 2027.

Banka e Shqipërisë monitoron rregullisht ecurinë e mjeteve financiare të Fondit të Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme, bazuar në raportimet periodike të Agjencisë së Sigurimit të Depozitave. Mbështetur në politikën e investimit të miratuar nga BSH-së, ASD-ja ka administruar Fondin e Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme, për të garantuar sigurinë e mjeteve financiare, likuiditet të lartë dhe profil të ulët rreziku.



2.6. EMETIMI I MONEDHËS


Banka e Shqipërisë ka të drejtën ekskluzive të nxjerrjes dhe të qarkullimit të monedhës kombëtare "Lek". Ajo përcakton format, peshat, masat, modelin dhe karakteristikat e tjera të kartëmonedhave dhe monedhave metalike shqiptare, me kurs ligjor brenda vendit.

Banka e Shqipërisë garantoj në mënyrë efektive plotësimin e nevojave të ekonomisë me para të gatshme gjatë vitit 2025, duke forcuar besimin e publikut në monedhën kombëtare, Lekun. Rritja e monedhës në qarkullim, përpunimi dhe zëvendësimi sistematik i kartëmonedhave të papërshtatshme, si dhe niveli historikisht i ulët i falsifikimit dëshmojnë se Banka ka garantuar një qarkullim të mjaftueshëm, cilësor dhe të sigurt të Lekut, duke mbështetur funksionimin normal të ekonomisë.

KARTËMONEDHA DHE MONEDHA NË QARKULLIM¹⁵ DHE VLERA E TYRE

Monedha kombëtare në qarkullim arriti në rreth 504 miliardë lekë gjatë vitit 2025, duke shënuar një rritje prej 63 miliardë lekësh, krahasuar me fundin e vitit 2024 (14.3%). Kjo sasi përbëhej nga rreth 178 milionë kartëmonedha me vlerë 496 miliardë lekë, dhe 311 milionë monedha metalike.

Në krahasim me vitin 2024, numri i kartëmonedhave u rrit me rreth 17 milionë copë (+10.5%), ndërsa ai i monedhave metalike me 20 milionë copë (6.9%). Rritja e numrit dhe e vlerës së kartëmonedhave në qarkullim tregon një zhvendosje së strukturës drejt prerjeve më të mëdha, kryesisht 5,000 dhe 10,000 lekë. Si rrjedhojë, vlera mesatare e një kartëmonedhe në qarkullim, në fund të vitit 2025, arriti 2,785 lekë, nga 2,691 lekë një vit më parë, ndërsa vlera mesatare e një monedhe metalike në qarkullim u rrit në 25.5 lekë për copë.




¹⁵ Është numri dhe vlera e kartëmonedhave dhe monedhave të hedhura në qarkullim nga Banka e Shqipërisë.



RICIKLIMI I PARASË FIZIKE, CILËSIA E KARTËMONEDHËS DHE QARKULLIMI I SAJ


Gjatë vitit 2025, u përpunuan rreth 91.1 milionë copë kartëmonedha, kundrejt 94.2 milionë në vitin 2024, të cilat u kontrolluan për autenticitet dhe përshtatshmëri për riqarkullim. Norma e papërshtatshmërisë¹⁶ rezultoi 21.3%, kundrejt 21.5% në vitin 2024. Kartëmonedhat e papërshtatshme për qarkullim janë zëvendësuar rast pas rasti me kartëmonedha të reja të përshtatshme për qarkullim.

Grafik 30. Treguesit e përpunimit dhe papërshtatshmërisë së kartëmonedhave dhe koeficienti i qarkullimit



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 31. Ecuria e treguesit të falsifikimit të kartëmonedhave në qarkullim



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Koeficienti¹⁷ i qarkullimit të kartëmonedhës për vitin 2025 rezultoi në vlerën 0.55, që do të thotë se një kartëmonedhë kthehet mesatarisht më pak se një herë në vit në sportelet e BSH-së. Ky koeficient është më i lartë – mbi 1 – për prerjet 500 dhe 1,000 Lekë, dhe më i vogël për prerjen 5,000 dhe 10,000 Lekë

MBROJTJA E KARTËMONEDHËS DHE MONEDHËS METALIKE NGA FALSIFIKIMI


Gjatë vitit 2025 u sekuestruan në qarkullim 107 kartëmonedha kombëtare të falsifikuara, kundrejt 156 copëve në vitin 2024, si dhe 119 copë monedha metalike. Koeficienti i kartëmonedhave të falsifikuara për 1 milion copë në qarkullim vijoi trendin rënës, duke zbritur në 0.64 në 2025, nga rreth 1 në vitin 2024. Ky nivel përbën një minimum të ri historik dhe dëshmon standardin e lartë cilësor të kartëmonedhës shqiptare.

¹⁶ Është raporti i numrit të kartëmonedhave të papërshtatshme mbi numrin total të kartëmonedhave të përpunuara gjatë një viti.

¹⁷ Është raporti i numrit të kartëmonedhave të arkëtuara në sportelet e Bankës së Shqipërisë mbi gjendjen mesatare vjetore të numrit të kartëmonedhave në qarkullim.



Sipas shpërndarjes strukturore, pjesën më të madhe të kartëmonedhave të falsifikuara e përbëjnë prerjet 5,000 Lekë, të ndjekura nga prerjet 2,000 Lekë dhe 1,000 Lekë. Në rastin e monedhave metalike, prerja 50 Lekë mbetet e vetmja e evidentuar si e falsifikuar, në sasi të ulët dhe të papërfillshme. Nga pikëpamja teknike, falsifikimet e identifikuara janë riprodhime të thjeshta, të realizuara me pajisjeve digjitale komerciale, pothuajse vetëm me tekniken *ink-jet* me ngjyra, të shoqëruara me ndërhyrje artizanale për imitimin e elementeve të dukshme të sigurisë. Elementet e sigurisë të lexueshme nga pajisjet autentifikuese nuk rezultojnë të jenë imituar në asnjë rast, çka konfirmon efektivitetin e teknologjive mbrojtëse të përdorura.



2.7. SISTEMET E PAGESAVE

Operimi, mbikëqyrja dhe zhvillimi i sistemeve të pagesave është një funksion kryesor i Bankës së Shqipërisë. Nëpërmjet ushtrimit të tij, garantohet siguria, qëndrueshmëria dhe efikasiteti i infrastrukturës bazë të pagesave. Ky është një parakusht i domosdoshëm për funksionimin e aktivitetit tregtar, ekonomik e financiar, për përçimin e politikës monetare dhe ruajtjen e stabilitetit financiar.

Në përmbushje të këtyre funksioneve, përtej operimit të qëndrueshëm të sistemeve të pagesave, Banka i ka kushtuar vëmendje të veçantë rolit mbikëqyrës dhe katalizator, në përmbushje të Strategjisë Kombëtare të Pagesave me Vlerë të Vogël.

Zhvillimet në fushën e pagesave kanë marrë vëmendje të madhe në veprimtarinë e Bankës së Shqipërisë, gjatë vitit 2025. Këtë vit përfundoi projekti për përditësimin e sistemeve kombëtare të pagesave me standardin ndërkombëtar ISO 20022, si dhe ndryshoi kuadri rregullator i funksionimit të tyre, përfshirë rishikimin e tarifave për pagesa për klientët. Gjithashtu, pas anëtarësimit të Shqipërisë në zonën gjeografike të Tregut Unik të Pagesave në Euro (SEPA¹⁸), të gjitha bankat në Republikën e Shqipërisë nisën kryerjen e transfertave SEPA në 7 tetor 2025, duke i mundësuar qytetarëve dhe bizneseve shqiptarë të shkëmbejnë transfertat me vendet SEPA më shpejt, më sigurt dhe me kosto disa herë më të ulët.

2.7.1. ECURIA E SISTEMEVE TË PAGESAVE

Banka e Shqipërisë luan rol thelbësor në funksionimin normal të sistemeve të pagesave, nëpërmjet operimit dhe administrimit të tre infrastrukturave kryesore për procesimin e pagesave ndërbankare dhe një infrastrukture për shlyerjen e titujve (AFISaR). Sistemi AIPS është infrastruktura e vetme për shlyerjen në kohë reale të pagesave me vlerë të madhe në Lek dhe infrastrukturë kritike për ruajtjen e stabilitetit financiar. Nëpërmjet kësaj infrastrukture mundësohen edhe shlyerjet e transaksioneve të segmenteve të ndryshme në tregun e brendshëm financiar. Sistemi AECH mundëson klerimin e transaksioneve ndërbankare me vlerë më të vogël të individëve dhe bizneseve. Sistemi AIPS EURO bën të mundur shlyerjen bruto, në kohë reale, të transaksioneve të klientëve të bankave për pagesat në Euro, brenda territorit të Shqipërisë.

Në muajin shtator 2025 përfundoi përditësimi i këtyre sistemeve me standarde teknike më moderne dhe me funksione të reja. Arritja kryesore ishte migrimi në standardin ndërkombëtar të komunikimit ISO 20022. Zbatimi i tij rrit sigurinë e transaksioneve dhe siguron uniformitet në shkëmbimin e të dhënave në nivel global. Ky përditësim ka rritur dhe automatizimin e proceseve dhe fleksibilitetin

¹⁸ Në mbledhjen e datës 21 nëntor, Këshilli Evropian i Pagesave (European Payments Council, EPC) mori vendimin për të pranuar Shqipërinë në zonën gjeografike SEPA.




për administrimin e likuiditetit. Ndonëse projekti preku të tri sistemet njëkohësisht, ai nuk ndikoi efikasitetin e funksionimit të tyre gjatë vitit. Të gjitha sistemet kanë ofruar disponueshmëri maksimale, duke funksionuar normalisht dhe në përputhje me rregullat dhe oraret e operimit.

SISTEMI I SHLYERJES SË PAGESAVE NDËRBANKARE ME VLERË TË MADHE (AIPS)

Funksionimi i sistemit AIPS ka treguar eficiencë të lartë gjatë vitit 2025, duke bërë të mundur shlyerjen e veprimeve në kohë reale. Vlera totale e likuiditetit të qarkulluar në sistem ishte rreth 14,610 miliardë lekë. Kjo vlerë është rreth 5.5 herë më e lartë se Produkti i Brendshëm Bruto (PBB)¹⁹, duke evidentuar rëndësinë e këtij sistemi në ekonominë shqiptare.

Numri i transaksioneve të kryera shënoi një rritje vjetore të lehtë prej rreth 0.8%, duke reflektuar rënien graduale të tyre në tremujorin e fundit. Ndryshimet rregullatore të sistemeve parashikojnë rritjen e pragut të pagesave të klientëve nëpërmjet sistemit të pagesave me vlerë të vogël, nga 1.5 milionë lekë në 10 milionë lekë. Ky ndryshim ka bërë që një pjesë e pagesave për klientë të zhvendosen nga sistemi AIPS në sistemin AECH, i cili ka kosto ndjeshëm më të ulët. Ky konfigurim është tipik për sistemet e pagesave me vlerë të madhe dhe në kohë reale, të cilat përdoren kryesisht për shlyerjen e transaksioneve në tregun financiar.



SISTEMI I SHLYERJES SË PAGESAVE NË EURO BRENDA VENDIT (AIPS EURO)

Qëllimi kryesor i krijimit të sistemit AIPS Euro²⁰ ishte t'u mundësonte qytetarëve shqiptarë kryerjen e pagesave në Euro brenda vendit me kosto më të ulët dhe

¹⁹ PBB-ja për vitin 2025 është vlerësim i Bankës së Shqipërisë.


²⁰ Sistemi AIPS EURO filloi funksionimin më 24 janar 2022.



me një afat kohor shumë më të shkurtër, krahasuar me procesin e kryer më parë, nëpërmjet bankave korrespondente.

Në sistemin AIPS EURO janë procesuar një vëllim pagesash prej 398,757 transaksionesh, me vlerë rreth 6,329.4 milionë euro, gjatë vitit 2025. Krahasuar me vitin e kaluar, ecuria e tij pasqyron rritje të numrit të transaksioneve dhe të vlerës së tyre, përkatësisht me 23% dhe 21%. Zgjerimi i përdorimit të sistemit ndihmon nxitjen e përfshirjes financiare dhe promovimin e pagesave elektronike në vend. Gjithashtu, në dallim nga përdorimi i bankave korrespondente, përdorimi i sistemit AIPS Euro për pagesat në Euro brenda vendit mbulohet nga një kuadër ligjor më prudencial për mbrojtjen e konsumatorit.

Grafik 33. Numri dhe vlera e transaksioneve të procesuara në AIPS EURO



SISTEMI I KLERIMIT TË PAGESAVE ME VLERË TË VOGËL (AECH)


Përdorimi i sistemit AECH reflekton kryesisht përdorimin e transfertave bankare në jetën e përditshme të individëve dhe bizneseve. Volumi dhe vlera e transaksioneve që kryhen nëpërmjet këtij sistemi ka njohur rritje progresive. Kjo prirje është favorizuar edhe nga ndryshimet rregullative të ndërmarra nga Banka e Shqipërisë vitet e fundit²¹.

Krahas ndryshimeve teknike të sistemit, BSH-ja rriti gati 7-fish kufirin e pagesave për klientë që mund të kryhen në sistemin AECH, si dhe prezantoi një set ndryshimesh lidhur me komisionet me të cilat bankat ngarkojnë klientët për transfertat. Këto ndryshime konsistojnë në uljen gati 10-fish të komisioneve maksimale dhe minimale, si dhe në diferencimin midis pagesave që iniciohen

²¹ Ndryshimi më i fundit rregullativ i vitit 2025 përcakton që kufiri i pagesave me vlerë të vogël të iniciuara në mënyrë elektronike (home-banking), për të cilin aplikohet komision 0 lekë, të rritet në 40.000 lekë, nga 20.000 lekë që ishte vendosur në vitin 2020. Ndryshimet përfshijnë edhe rritjen e limitit të pagesave të pranuar në sistemin AECH nga 1.5 milionë lekë në 10 milionë lekë, i cili ka ndikuar në rritjen e ndjeshme të vlerës totale të pagesave të kleruara në këtë sistem gjatë vitit 2025.



në degë dhe ato elektronike, në favor të këtyre të fundit²². Eliminimi total i komisioneve për pagesa të iniciuara elektronikisht, fillimisht për ato deri në 20,000 lekë e më pas për ato deri në 40,000 lekë, ka reflektuar rritjen e peshës së numrit të këtyre transaksioneve në 40% të totalit të transaksioneve në AECH në vitin 2025, nga 27% që ishte në vitin 2020²³.



SISTEMI I SHLYERJES SË TITUJVE (AFISAR)

Sistemi AFISaR, i cili funksionon që prej viti 2015, është sistemi qendror i shlyerjes dhe regjistrimit të transaksioneve me titujt e qeverisë. Ky sistem operohet nga Banka e Shqipërisë në cilësinë e agjentit fiskal. Banka e Shqipërisë, nëpërmjet sistemit AFISaR, i ofron emetuesit (Ministrisë së Financave) dhe tregut organizimin e ankandeve të emetimit të titujve të Shtetit Shqiptar në monedhën kombëtare dhe në monedhën evropiane. Në këtë sistem, kolateral janë titujt e Shtetit Shqiptar dhe marrëveshjet e anasjella të riblerjes me objekt këta tituj. Përveç sa më sipër, ofrohen edhe shërbimet e mbledhjes së taksave në burim për të ardhurat nga titujt, ngjarjet e pagesave të interesit dhe informimi i mbajtësve të llogarive në këtë sistem, mbi gjendjen dhe lëvizjet në këto llogari.

Në fund të vitit 2025, sistemi AFISaR regjistron 14 institucione financiare pjesëmarrëse të drejtpërdrejta nga të cilat: 1 emetues (Ministria e Financave) dhe 1 bankë qendrore (BSH), 6 institucione financiare pjesëmarrëse të tërthorta me llogari nëpërmjet BSH-së, dhe 1 bursë private e tregtimit të titujve. Në fund të vitit 2025, numri i llogarive të individëve në sistemin AFISaR, të hapura nëpërmjet BSH-së, ishte 20,009.

Vlera nominale totale e emetimeve të titujve të Shtetit Shqiptar në monedhën


²² Shiko Hapësirën informative 5.

²³ Për herë të parë, koncepti i eliminimit të komisioneve për pagesa nën një vlerë të caktuar u prezantua në ndryshimet rregullative të vitit 2020 të Bankës së Shqipërisë.



kombëtare në sistemin AFISaR ishte 838,034 miliardë lekë, duke u rritur me 6.29% nga fundi i 2024. Në fund të vitit 2025 nuk ka pasur tituj të emtuar në monedhën Euro në sistemin AFISaR.

Grafik 35. Ecuria e sistemit AFISaR sipas numrit dhe të vlerës së transaksioneve të proçesuara (majtas), dhe në përqindje ndaj PPB-së (djathtas)



Burimi: Banka e Shqipërisë.

HAPËSIRË INFORMUESE 5

PËRDITËSIMI I SISTEMEVE KOMBËTARE TË PAGESAVE

Në kuadër të modernizimit të infrastrukturës së pagesave dhe përafrimit me praktikat më të mira ndërkombëtare, Banka e Shqipërisë ka ndërmarrë një reformë me synim jo vetëm rritjen e efikasitetit dhe sigurisë në tregun vendas, por edhe krijimin e parakushteve të nevojshme për integrimin në hapësirën evropiane të pagesave. Pjesë e kësaj reforme ishte dhe projekti për përmirësimin e sistemeve të pagesave që operohen nga BSH-ja. Përmirësimet mundësojnë jo vetëm migrimin në standardin ISO 20022, por rritjen e automatizimit të proceseve dhe fleksibilitetit për administrimin e likuiditetit. Sistemet kanë adoptuar standardet e SEPA-s, duke bërë që këto standarde të zbatohen edhe në tregun vendas të pagesave.

Sistemet e reja AIPS, AIPS Euro dhe AECH dolën live më 15 shtator. Disa nga risitë konsistojnë në:

1. Përafrim me standardet evropiane

Përditësimet më të fundit në sistemet e pagesave kanë adresuar nevojën për të pasur sisteme në përputhje me standardet më të mira në fushën e pagesave. Implementimi i standardit ISO 20022 është një hap madhor në drejtim të përputhshmërisë me këto standarde. Në të njëjtën linjë, implementimi i standardit në mesazhet financiare sipas rregullave të vendosura nga SEPA në sistemin e pagesave me vlerë të vogël (AECH), është një zhvillim i rëndësishëm që ecën paralelisht me pjesëmarrjen e Shqipërisë në SEPA.

2. Automatizim i funksioneve dhe veprimeve manuale

Përditësimi i sistemeve të pagesave i ka dhënë vëmendje të veçantë rritjes së qëndrueshmërisë funksionale të sistemit, si dhe plotësimit me procese më të



automatizuara. Kjo me qëllim rritjen e efikasitetit dhe uljen e rrezikut operacional.

3. Përmirësim i administrimit të rezervës së detyruar

Funksionalitetet e reja për administrimin e rezervës së detyruar lidhen me krijimin e fleksibilitetit për periudhat e vendosjes së rezervës, vendosjes së interesave, e gjobave etj. në përputhje me praktikën e BQE-së. Ato pritet të sigurojnë një administrim më të efektshëm të kërkesave rregullative dhe operacionale.

4. Përmirësim i administrimit të likuiditetit dhe rrezikut të kreditit

Në kuadër të administrimit më të mirë të këtyre rreziqeve janë implementuar mekanizma për krijimin e rezervave dhe mënjanimin e rasteve që bllokojnë shlyerjen e fondeve. I rëndësishëm ka qenë adresimi i rrezikut të një efekti zinxhir.

5. Fleksibilitet në tarifim dhe faturim

Një element i rëndësishëm i risive është mundësia për të vendosur tarifa më fleksibël, në varësi të formës së inicimit të instruksionit dhe intervaleve të vlerave të transfertave. Kjo qasje synon t'i krijojë bankave hapësirë për të aplikuar komisione më konkurruese për klientët.

Krahas përmirësimeve infrastrukturale, Banka e Shqipërisë ka rishikuar dhe komisionet për pagesat nga klientët, duke synuar, ndër të tjera, dhe nxitjen e pagesave elektronike në ekonominë shqiptare. Kjo reformë është pjesë e vizionit për të krijuar një treg financiar më efikas, gjithëpërfshirës dhe të përafuar me standardet e Bashkimit Evropian. Me këto ndryshime, qytetarët dhe bizneset do të përfitojnë nga shërbime më të shpejta, më të lira dhe më të sigurt, duke reduktuar ndjeshëm kostot e përdorimit të pagesave elektronike.

Ndryshimet e reja sjellin një model tarifimi shumë më të favorshëm për përdoruesit. Në pagesat në Lek, qytetarët do të gëzojnë zero komision për transaksionet elektronike deri në 40,000 lekë. Për pagesat më të larta, tarifatat janë reduktuar në nivele minimale, deri në 10 herë më pak se më parë.

- Pagesat elektronike deri në 40,000 lekë: pa komision
- Pagesat elektronike mbi 40,000 deri në 10 milionë lekë: vetëm 0.005% e vlerës, por jo më shumë se 500 lekë
- Pagesat elektronike mbi 10 milionë lekë: maksimumi 750 lekë

Edhe për pagesat në Euro, si brenda vendit ashtu edhe në zonën gjeografike SEPA, kostot janë reduktuar ndjeshëm. Këto tarifa janë njehsuar, duke i bërë pagesat ndërkombëtare në këtë monedhë njësoj të kushtueshme sa ato kombëtare. Ulja e barrierave financiare në transferimin e fondeve i vjen në ndihmë si individëve, ashtu edhe bizneseve që kanë marrëdhënie tregtare ndërkombëtare.

- Deri në 100,000 €: 0.01% e vlerës
- Mbi 100,000 €: jo më shumë se 25 €
- Transaksionet hyrëse nga SEPA: 0–3 € maksimumi

Një element nxitës është edhe politika e re tarifore për transaksionet e kryera në sportel. Për këto raste, komisionet do të jenë sa dyfishi ose dhe më shumë, i atyre të aplikuara për transaksionet e iniciuara elektronikisht, duke inkurajuar qytetarët dhe bizneset të kalojnë drejt përdorimit të kanaleve digjitale, më të shpejta dhe më ekonomike.




2.7.2. INSTRUMENTET E PAGESAVE

Gjatë vitit 2025 janë realizuar rreth 59.2 milionë pagesa në sistemin bankar, me një vlerë totale prej 7,595 miliardë lekësh. Në krahasim me vitin pararendës, këto shifra përfaqësojnë një rritje prej 22.7% në numrin e pagesave dhe 17.9% në vlerën e tyre.²⁴

Prirja rritëse e fortë e pagesave në formë elektronike ka vijuar edhe këtë vit. Numri i pagesave elektronike të kryera nëpërmjet bankave arriti në 53.2 milionë, me një vlerë totale prej 3,187 miliardë lekësh. Numri i pagesave elektronike ka shënuar një rritje prej 25.6% krahasuar me një vit më parë, ndërsa vlera e tyre ka shënuar një rritje prej 13.7%. Njëkohësisht, institucionet elektronike të pagesave kanë realizuar 9.2 milionë pagesa me para elektronike në nëntëmujorin e parë²⁵. Kjo ecuri reflekton tendencat në rritje të digjitalizimit të shërbimeve financiare dhe lehtësimit të transaksioneve elektronike për individët dhe bizneset.

Zhvillimet pozitive në fushën e pagesave elektronike kanë sjellë rritje të treguesit të përdorimit të tyre, ku treguesi i “pagesave elektronike për frymë” gjatë një viti arriti në 29. Ndonëse ky tregues mbetet nën atë të vendeve të Bashkimit Evropian, ecuria e tij evidenton përmirësimin në aksesin në pagesa elektronike dhe në pranimin e instrumenteve moderne të pagesave.



PAGESA OFRUAR NGA SISTEMI BANKAR

Bankat kanë qenë aktive në promovimin e instrumenteve digjitale të pagesave, në përputhje me preferencat e klientëve për një qasje më të shpejtë, më të


²⁴ Duke qenë se të dhënat nga institucionet e pagesave kanë një vonesë kohore, ato analizohen veçmas në raport.

²⁵ Të dhënat për institucionet e parasë elektronike janë të disponueshme deri në shtator 2025.



sigurt dhe më të lehtë ndaj shërbimeve financiare. Kështu, aplikacionet “home banking” janë tashmë të disponueshme nga të gjitha bankat dhe po gjejnë një përdorim gjithnjë e më të gjerë në tregun shqiptar. Përveç funksioneve bazë, si informimi mbi gjendjen e llogarisë, ato po përdoren dhe për kryerjen e pagesave online. Pesha e numrit të transfertave të kreditit në distancë ndaj totalit të transfertave të kreditit (në formë letër dhe elektronike) shënon 66%.

Grafik 37. Pesha e instrumenteve të pagesave sipas numrit të transaksioneve (majtas) dhe përdoruesit (biznese-individë) sipas tipologjisë së instrumenteve të pagesave, gjatë vitit 2025 (djathtas)



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Gjatë vitit 2025, numri i pagesave dhe vlera e transaksioneve të realizuara përmes “home banking” janë rritur me përkatësisht 23.2% dhe 14.5%. Prirja në rritje e transfertave online është nxitur edhe nga masat e marra nga BSH-ja për uljen e komisioneve për këtë tipologji transaksionesh²⁶, zhvillimi i infrastrukturës, zgjerimi i aksesit në internet dhe rritja e njohurive të klientëve mbi përdorimin e tij.

Numri i llogarive të aksesueshme në distancë është rritur në mënyrë të konsiderueshme, me 44.4% në vitin 2025, duke zënë 46.8% të totalit të gjithë llogarive të klientëve në banka. Me inovacionet e vazhdueshme dhe automatizimin e shërbimeve, Home Banking pritet të vazhdojë të rritet, duke ofruar një përvojë gjithnjë e më efikase dhe të personalizuar për klientët.

Pagesat me para elektronike në sistemin bankar kanë shënuar një rritje prej 17.8% në numrin e transaksioneve dhe 3.4% në vlerë krahasuar me vitin e kaluar, duke reflektuar tendencën në rritje të digjitalizimit të pagesave. Megjithatë, vlera e këtyre pagesave ndaj totalit të gjithë pagesave të kryera nga sistemi bankar mbetet ende në nivele të ulëta. Deri më tani, kjo tipologji pagesash ofrohet nga pak banka dhe përdoret ekskluzivisht nga individët.

²⁶ Referuar diferencimit të komisioneve midis pagesave online dhe atyre me prani fizike pranë degëve të bankave.




PËRDORIMI I KARTAVE BANKARE DHE INFRASTRUKTURA (ATM DHE POS-E) E TYRE

Rreth 67% e numrit total të pagesave nëpërmjet bankave janë kryer duke përdorur karta debiti dhe krediti. Krahasuar me të njëjtin periudhë të një viti më parë, numri i pagesave me kartë është rritur me 27.5%. Përdorimin më të lartë të kartave e shfaqin individët (në 94% të numrit të pagesave me kartë).

Të 11 bankat që operojnë në treg janë të licencuara si emetuese kartash, ndërkohë që 9 prej tyre janë të licencuara edhe si pranuese kartash. Në fund të vitit 2025, numri i kartave aktive në qarkullim është 1,652,474, me një rritje prej 9.4% nga viti i kaluar. Pjesën dominuese e zënë kartat me funksion debiti, rreth 88.1%. Pjesa tjetër e kartave janë karta krediti (7.3%) dhe karta me para elektronike (4.6%).

Përdorimi i kartave për blerje në терминаlet POS në vend ka shënuar rritje të vazhdueshme, si në numër ashtu edhe në vlerë (përkatësisht me 38.7% dhe 26.9%), si efekt i disa faktorëve të kombinuar: rritja e numrit të terminaleve POS, rritja e numrit të kartave të emetuara, dhe së fundmi edhe rritja e edukimit financiar të popullsisë²⁷ për përdorimin e kartave në këto terminale. Për herë të parë, në vitin 2025, kartat janë përdorur kryesisht për kryerjen e pagesave, duke thyer modelin shumëvjeçar të përdorimit të tyre kryesisht për tërheqje të parasë fizike.

Grafik 38. Përdorimi i kartave për pagesa kundrejt tërheqjeve cash në ATM, si dhe numri total i kartave.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

²⁷ Në janar 2024, Banka e Shqipërisë ka miratuar "Strategjinë e Bankës së Shqipërisë për edukimin dhe përfshirjen financiare 2024-2026", e cila promovon edukimin financiar si një të mirë publike, nxit më tej përfshirjen financiare, mbrojtjen e konsumatorëve dhe rritjen e mirëqenies financiare të individëve dhe të qëndrueshmërisë së sistemit financiar në tërësi.



Infrastruktura e ofruar nga bankat tregtare ka rezultuar me rritje të konsiderueshme për sa i përket numrit të POS-eve. Numri i tyre është rritur me 27.7%, krahasuar me fundvitin 2024. Rritja e numrit të terminaleve POS vjen edhe si pasojë e shtimit më të lartë në qarqe, ku më parë rritja e tyre ishte modeste. Ky interes më i lartë në promovimin e terminaleve POS, vjen si pasojë e rritjes së turizmit në Shqipëri gjatë viteve të fundit, dhe njëkohësisht e familjarizimit të bizneseve me përdorimin e tyre. Gjatë vitit është shtuar dhe numri i POS-eve virtuale (konkretisht me 22.1%, krahasuar me fundin e vitit 2024), tregues ky i zgjerimit të e-commerce në vend.

Numri i ATM-ve është rritur me 7.9% gjatë vitit.

Pavarësisht se ATM-të janë përdorur ndër vite kryesisht për tërheqje të parasë fizike, gjatë vitit 2025 është parë zgjerimi i ATM-ve që mundësojnë edhe shërbime të tjera. Numri i ATM-ve me funksion depozitim paraje fizike është rritur me 34 terminale, ndërsa ai i ATM-ve që ofrojnë funksionin e urdhër-transfertave është rritur me 30 terminale, krahasuar me fundvitin 2024. Përdorimi i funksioneve shpesh të ATM-ve sjell reduktim në kohën e kryerjes së transaksioneve (përkundëjt kohës së shpenzuar në sportelet e bankave) dhe në kostot përkatëse.

TRANSAKSIONET NË ZONËN UNIKE SEPA


Transaksioni i parë SEPA u krye më 7 tetor 2025, duke shënuar një moment të rëndësishëm në historinë e pagesave në vend. Numri i transfertave të nisura dhe të mbërritura me vendet e zonës SEPA ka ardhur në rritje graduale gjatë muajve tetor-dhjetor 2025, duke evidentuar përdorim të tyre si nga individët, ashtu dhe bizneset. Transaksionet në nisje drejt zonës SEPA janë iniciuar kryesisht elektronikisht / online, në 65.4% të rasteve, nxitur dhe nga tarifa më të ulëta për pagesat digjitale.

Transaksionet SEPA kanë sjellë jo vetëm një reduktim të kostove të klientëve, por edhe një reduktim të kohës së dërgimit/marrjes/vënies së fondeve në dispozicion të klientëve fundorë. Me përdorimin e skemave SEPA, transfertat kryhen brenda ditës ose në ditën pasardhëse, ndërkohë që më parë kryheshin brenda 2-4 ditëve nëpërmjet bankës korrespondente.


2.7.3. INSTITUCIONET E PARASË ELEKTRONIKE

Produktet e parasë elektronike ofrohen dhe nga institucionet financiare jobanka, të licencuara si institucione të parasë elektronike. Në tregun shqiptar, gjatë vitit 2025, kanë operuar 10 institucione të parasë elektronike, të cilat ofrojnë zgjidhje

Grafik 39. Numri i ATM-ve dhe POS-ve fizike dhe virtuale



Burimi: Banka e Shqipërisë.



të larmishme në treg për grupe të ndryshme konsumatorësh. Më 17 dhjetor 2025 u licencua institucioni më i ri i parasë elektronike në treg *Happy Pay sh.a.*, duke e çuar numrin total të këtyre institucioneve në 11, në fund të 2025.

Përdorimi i parasë elektronike sjell lehtësira kryesisht për atë pjesë të popullsisë shqiptare që nuk zotëron një llogari bankare. Avantazhet konsistojnë në rritjen e fleksibilitetit për kryerjen e pagesave, duke pasur parasysh shtrirjen e këtyre institucioneve në vend nëpërmjet agjentëve, dhe koston më të ulët për pagesat me vlerë të vogël, si pagesat e gjobave, faturave mujore utilitare etj. Gjatë nëntëmuorit të parë të vitit 2025²⁸, këto institucione, së bashku, kanë procesuar një volum prej afërsisht 9.2 milionë pagesash me para elektronike.

Gjatë këtij viti filloi operacionalizimi i bankingut të hapur (*open banking*) nga dy prej këtyre institucioneve. Bankingu i hapur është një risi në praktikat bankare bashkëkohore dhe u mundëson qytetarëve të aksesojnë të dhënat e llogarisë së tyre dhe të iniciojnë pagesa nga bankat dhe institucionet e tjera financiare, nëpërmjet ofruesve të shërbimit të palëve të treta. Në këtë mënyrë, ai i jep klientit më shumë zgjedhje për të kryer pagesa më të thjeshtuara, më të shpejta dhe me kosto më të ulët.

2.7.4. ROLI REFORMATOR DHE KATALIZATOR

Përtej operimit dhe mbikëqyrjes së sistemeve të pagesave, Banka e Shqipërisë i kushton vëmendje zhvillimit të sistemeve dhe instrumenteve të pagesave, në funksion të rritjes së eficiencës së tyre. Për këtë qëllim, ajo ndërmer masa për përmirësimin dhe forcimin e kuadrit rregullator dhe të infrastrukturës së pagesave, në përputhje me standardet evropiane. Në rolin si reformator, Banka e Shqipërisë punoi në mënyrë intensive për disa projekte, si më poshtë:

- **Finalizimin e projektit “Upgrade i sistemeve AIPS, AIPS Euro dhe AECH”,** i cili kishte si qëllim kryesor implementimin e standardeve ndërkombëtare të procesimit të mesazheve (SEPA/ISO 20022) (shiko Hapësirën informuese më sipër).
- **Anëtarësimin individual të bankave në skemat SEPA dhe operacionalizimin e transaksioneve ndërkufitare SEPA.** Në 7 tetor nisën transaksionet e para SEPA, duke sjellë përfitime për bizneset dhe çdo qytetar, në terma të uljes së tarifave, rritjes së shpejtësisë dhe përmirësimin të sigurisë për transfertat ndërkufitare në Euro²⁹.
- **Zhvillimin e infrastrukturës për pagesat e menjëhershme, TIPS Clone.** Banka e Shqipërisë ka nisur projektin për krijimin e sistemit të pagesave

²⁸ Të dhënat për paranë elektronike janë të disponueshme deri në muajin shtator 2025. Të dhënat vjetore do të gjenerohen pas muajit mars 2026.

²⁹ Për një trajtim më të zgjeruar të përfitimeve nga anëtarësimi në SEPA, referojuni Hapësirës Informuese 7 “Pjesëmarrja e Shqipërisë në SEPA”, në Raportin Vjetor 2023 të Bankës së Shqipërisë.



të menjëhershme³⁰, nëpërmjet ngritjes së një sistemi klon të sistemit TIPS (*Target Instant Payment System*) të përdorur në BE. Sistemi do të ndërtohet nga Banka e Italisë (Bdl) dhe do të ketë tiparet e sistemit TIPS, në mënyrë që në të ardhmen të migrohet lehtësisht drejt këtij të fundit. Në këtë projekt marrin pjesë edhe banka të tjera qendrore të rajonit: Banka e Kosovës, Banka e Malit të Zi, Banka e Bosnje-Hercegovinës dhe Banka e Maqedonisë së Veriut. Projekti pritet të përfundojë brenda vitit 2026.

Me qëllim rritjen e efikasitetit dhe besueshmërisë së tregjeve të pagesave dhe infrastrukturave përkatëse, Banka e Shqipërisë luan rolin e katalizatorit në fushën e pagesave. Ajo shfrytëzon ekspertizën e saj dhe e ndan atë me aktorët e tregut, nëpërmjet konsultimeve të rregullta dhe takimeve të koordinuara me përfaqësues të sektorit privat dhe publik. Në këtë rol, ajo kryeson Komitetin Kombëtar të Sistemit të Pagesave (KKSP). Në 16 dhjetor 2025 u zhvillua mbledhja e njëmbëdhjetë vjetore e KKSP-së ku u trajtua ecuria e zbatimit të *Open Banking* dhe e Sistemit të pagesave të menjëhershme (*TIPS Clone*), si dhe iniciativa më e fundit e qeverisë për nxitjen e pagesave digjitale "*Cashless Albania*".

³⁰ Pagesat e menjëhershme (*instant payments*) janë shlyerje elektronike e pagesave me vlerë të vogël të disponueshme 24/7/365, çka nënkupton shlyerjen e menjëhershme ose pothuajse të menjëhershme ndërbankare të transaksionit.




2.8. ADMINISTRIMI I REZERVËS VALUTORE

Banka e Shqipërisë është autoriteti kombëtar përgjegjës për mbajtjen dhe administrimin e rezervave valutore të Shqipërisë. Ajo përdor mundësitë e saj më të mira për të arritur dhe ruajtur një nivel të caktuar të rezervës valutore, e cila mbështet qëndrueshmërinë financiare të vendit dhe është në përputhje me politikën monetare.

Në fund të vitit 2025, stoku i rezervës valutore bruto u rrit në 7,305.46 milionë euro, nga 6,268.01 milionë euro një vit më parë. Rritja e rezervave valutore mundëson përmirësimin e aftësisë paguese të vendit.

Rregullorja “Për politikën dhe mënyrën e administrimit të rezervës valutore”, miratuar nga Këshilli Mbikëqyrës, bën një përcaktim të qartë të qëllimeve për të cilat mbahet rezerva valutore. Në përputhje me praktikën më të mira ndërkombëtare, rezerva valutore mbahet me qëllim zbatimin dhe mbështetjen e politikës monetare dhe politikës së kursit të këmbimit, si dhe për ruajtjen e stabilitetit financiar. Ndërkohë, objektiva parësorë të procesit të administrimit të rezervës janë likuiditeti dhe siguria. Sigurimi i të ardhurave nga administrimi i rezervës përfaqëson objektivin e tretë, për sa kohë nuk cenohen objektivat e likuiditetit dhe të sigurisë. Këshilli Mbikëqyrës miraton gjithashtu parimet dhe kriteret cilësore për zhvillimin e aktivitetit të administrimit të rezervës valutore.



Në përputhje me kriteret cilësore të miratuara nga Këshilli Mbikëqyrës, emrat e lejuar në të cilët investohet rezerva valutore miratohen nga Komiteti i Investimit. Këto emra përfshijnë qeveritë e SHBA-së, Japonisë, Britanisë së Madhe, Kanadasë, Australisë dhe Eurozonës, të cilat përgjithësisht janë të renditura të paktën A- (për qeveritë e Eurozonës, renditja minimale e pranuar është BBB-³¹). Në emrat e lejuar për investim përfshihen dhe agjenci apo institucione të lidhura me qeveritë, institucione shumëpalëshe apo të tjera subjekte të renditura të paktën AA- (për banka/institucione të tjera financiare, renditja minimale e pranuar A-).

Në fund të dhjetorit 2025, stoku i rezervës valutore bruto përfshin edhe rreth 116.99 mijë onz ose 3.64 ton ar monetar.

PËRBËRJA E PORTOFOLIT TË REZERVËS SIPAS MONEDHAVE

Në fund të vitit 2025, përbërja sipas monedhave e rezervës valutore bruto është: USD 22.3%, EUR 60.3%, GBP 2.5%, JPY 2%, RMB 2.7%, AUD 0.6%,

³¹ Emrat/instrumentet e renditura deri në BBB- përfshihen në kategorinë “Për investim” (Investment Grade).



SRD 3.7% dhe Ar monetar 5.9%. Në funksion të ruajtjes së përbërjes së një pjese të rezervës në përputhje me shportën e SDR-së, pesha e monedhës RMB shpërndahet në dy monedha, RMB dhe AUD, sipas një raporti që miratohet në vijimësi nga Komiteti i Investimit.

PËRBËRJA E PORTOFOLIT TË REZERVËS SIPAS AFATIT TË MATURIMIT


Rezerva valutore është e investuar në aktive likuide, kryesisht me afat maturimi 1-3 vjet dhe 3-5 vjet. Pesha e investuar në instrumente të borxhit me afat mbi 5 vjet rezulton me rritje, duke përfaqësuar rreth 13.4% të portofolit të rezervës së investuar në tituj, në mbyllje të vitit.

Portofoli i administruar nga administratori i jashtëm (IBRD) ka vijuar të investohet kryesisht në instrumente borxhi të emetuara nga qeveri dhe agjenci qeveritare, kundrejt një portofoli referencë 1-3 vjet emetime të thesarit amerikan. Në funksion të rritjes së rezervës valutore, në muajin dhjetor u realizua ndryshimi i portofolit që administrohet nga IBRD-ja, duke iniciuar mandatin e ri të investimit në tituj të mbështetura në kredi hipotekare (Mortgage Backed Securities, MBS). Ky mandat investimi do të zbatohet me një horizont kohor investimi 5 vjet.

PËRBËRJA E PORTOFOLIT TË REZERVËS SIPAS RENDITJES DHE LLOJIT TË EMETUESVE/ KUNDËRPALËVE


Në fund të vitit 2025, rreth 63.7% e portofolit të rezervës valutore rezulton e investuar në emra me renditje të cilësisë së lartë (klasa AAA dhe AA, duke përfshirë edhe ekspozimet në llogari rrjedhëse dhe SDR)³². Ekspozimet sipas llojit të emetuesit/kundërpalës me të cilën investohet, përfaqësohen nga qeveri/banka qendrore (81%), ndjekur nga banka/institucione të tjera financiare (7.7%), institucione shumëpalëshe (5.9%), agjenci (4.4%), autoritete qeveritare/organe publike (0.5%) dhe institucione të garantuara nga qeveritë (0.4%).

Grafik 41. Përbërja sipas monedhave e rezervës valutore bruto



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 42. Shpërndarja e rezervës sipas afatit të maturimit të instrumenteve*




* Në grafik nuk pasqyrohen fondet e mbajtura në llogari rrjedhëse si dhe pjesa e rezervës në ar monetar dhe Sdr. Gjendja e llogarive rrjedhëse në fund të vitit është rreth 700 milionë Eur. Burimi: Banka e Shqipërisë.

³² Ari monetar nuk përfshihet në këtë shpërndarje, ndërkohë që mbahet në ruajtje dhe/ose investohet vetëm në banka qendrore.




Grafik 43. Përbërja e portofolit të rezervës sipas vlerësimit (majtas) dhe kundërpalës (djathtas)



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 44. Kthimi i rezervës valutore



*Në llogaritjen e kthimit të rezervës nuk merret parasysh efekti i kursit të këmbimit.
Burimi: Banka e Shqipërisë.

KTHIMI NGA INVESTIMI I PORTOFOLIT TË REZERVËS

Kthimi absolut i rezervës në total për vitin 2025, përfshirë dhe fondin e administruar nga Banka Botërore, ka rezultuar pozitiv, 3.03%, duke pasqyruar si kontributin pozitiv të treguesve referencë (*benchmark*) të zgjedhur, ashtu dhe administrimin aktiv.

ZHVILLIME TË TJERA, NË KUADËR TË FUNKSIONIT TË ADMINISTRIMIT TË REZERVËS VALUTORE

Gjatë vitit 2025 ka vijuar bashkëpunimi i Bankës së Shqipërisë me Bankën Botërore, në kuadër të marrëveshjes "Për Administrim dhe Konsulencë në Investimin e Rezervës Valutore" (RAMP). Zhvillimi kryesor në këtë kuadër, në përputhje me strategjinë

afatmesme të BSH-së, ka qenë vënia në zbatim e mandatit të ri të investimit në klasën e re të instrumenteve: tituj të mbështetura në kredi hipotekare (*Mortgage Backed Securities, MBS*), përmes Bankës Botërore (IBRD), në rolin e administratorit të jashtëm. Vlera fillestare e fondit të investuar në MBS, në zbatim të marrëveshjes mes palëve, është 300 milionë USD. Ndërkohë, Banka Botërore ka vijuar të ofrojë trajnime dhe programe edukimi të specializuara, të cilat synojnë konsolidimin dhe rritjen e shkallës së profesionalizmit të punonjësve të angazhuar në procesin e administrimit të rezervës valutore, të stafit që mbështet ose monitoron ecurinë e këtij procesi, si dhe të stafit të Bankës, në përgjithësi.



Më tej, në përputhje me objektivat parësorë të procesit të administrimit të rezervës valutore, likuiditeti dhe siguria, është realizuar rinovimi i marrëveshjes së bazuar në Repo me Bankën për Rregullime Ndërkombëtare (BIS), për shumën 500 milionë euro. Vijon gjithashtu të jetë efektive marrëveshja për linjën e kreditit të kolateralizuar në shumën 400 milionë euro, nënshkruar me Bankën Qendrore Evropiane (përfaqësuar nga Banka e Francës), me afat deri në janar 2027. Këto marrëveshje i shërbejnë BSH-së për ruajtjen e disponibilitetit të likuiditetit të nevojshëm, me synim ruajtjen dhe mbështetjen e stabilitetit financiar të vendit.

Në kuadër të përpjekjeve për përmirësimin e infrastrukturës së teknologjisë së informacionit, ka vijuar projekti për sistemin e ri që do të mbështesë aktivitetet që kryhen nga Departamenti i Operacioneve Monetare, për qëllime të administrimit të rezervës valutore dhe zbatimit të politikës monetare, si dhe nga Departamenti i Sistemeve të Pagesave dhe Kontabilitetit e Financës, për qëllime të shërbimit të pagesave dhe transfertave. Për këtë qëllim, për sa i takon funksionit të administrimit të rezervës valutore, Banka e Shqipërisë mbështetet në asistencën teknike të Bankës Botërore. Ndërkohë, për dy funksionet e tjera - zbatimin e politikës monetare dhe shërbimin e pagesave dhe transfertave, sipas nevojës - merret asistencë teknike nga Banka e Italisë, në kuadër të Programit Rajonal për Forcimin e Aftësive të Bankave Qendrore të Ballkanit Perëndimor.

HAPËSIRË INFORMUESE 6

FLUKSET QË NDIKUAN REZERVËN VALUTORE, GJATË VITIT 2025

Gjatë vitit 2025, rezerva valutore bruto, e vlerësuar dhe e raportuar në monedhën Euro, është rritur me 1,038.42 milionë euro, duke regjistruar në fund të muajit dhjetor vlerën 7,305.46 milionë euro. Faktorët kryesorë që kanë ndikuar rezervën valutore bruto paraqiten të grupuar si më poshtë:

- *Veprimet e Ministrisë së Financave kanë pasur ndikim negativ në shumën 182.56 milionë euro, sipas zërave të mëposhtëm:*
 - *hyrje nga grante dhe lëvrimi i huave të dhëna 385.62 milionë euro;*
 - *hyrje nga emetimi i Eurobond-it 636.61 milionë euro;*
 - *transferta për shërbimin e borxhit dhe të tjera 1,204.79 milionë euro;*
- *Veprimet e bankave të nivelit të dytë dhe subjekteve të tjera kanë pasur ndikim pozitiv në shumën 56.53 milionë euro, sipas zërave të mëposhtëm:*
 - *derdhje nga bankat e nivelit të dytë në llogarinë e tyre pranë Bankës së Shqipërisë për plotësimin e rezervës së detyrueshme, administrimin e ekspozimeve në bilanc etj. 2,235.40 milionë euro;*
 - *transferta nga bankat e nivelit të dytë 2,179.96 milionë euro;*
 - *hyrje neto për llogari të subjekteve të tjera (ASD etj.) 1.09 milionë euro.*
- *Veprimet e Bankës së Shqipërisë kanë pasur ndikim pozitiv në shumën 1,187.08 milionë euro*, sipas zërave të mëposhtëm:*




- blerje të valutës nga bankat e nivelit të dytë dhe institucione të tjera 1,061.61 milionë euro:
 - o nga bankat e nivelit të dytë 1,047.50 milionë euro**;
 - o nga institucione të tjera 14.11 milionë euro;
- hyrje nga interesa, kuona etj. (të llogaritura në bazë paraje fizike) të krijuara nga investimi i rezervës valutore llogariten në 129.08 milionë euro;
- transferta 3.61 milionë euro.
- Faktorët e tregut kanë pasur ndikim negativ në shumën 22.63 milionë Euro, sipas zërave të mëposhtëm:
 - luhatjet në kursin e këmbimit të monedhave në përbërje të rezervës valutore kanë ndikuar në mënyrë negative vlerën e rezervës bruto të raportuar në Euro me 93.47 milionë euro;
 - efekti i rivlerësimit për portofolin, si rrjedhojë e luhatjes së normave të interesit, llogaritet në një vlerë pozitive, rreth 70.84 milionë euro***.

* Gjatë vitit 2025, Banka e Shqipërisë i ka shitur Ministrisë së Financave valutë në shumën 188.31 milionë euro dhe i ka paguar interes për depozitat në valutë në shumën 9.87 milionë euro. Këto veprime nuk ndikojnë rezervën valutore bruto.

** Këtu nuk përfshihet efekti neto i blerjeve forward për vitin në shumën 5 milionë euro.

*** Kjo vlerë ka në përmbajtje dhe efektin e krijuar nga derdhja e kuponave të titujve dhe është e korigjuar për veprimet e blerjes/shitjes/maturimit të titujve në baza paraje fizike.



2.9. STATISTIKAT

Në përputhje me përcaktimet në ligjin “Për Bankën e Shqipërisë”, Programin Zyrtar të Statistikave si dhe Ligjin për Statistikat Zyrtare, funksioni statistikor në Bankën e Shqipërisë synon nxjerrjen e statistikave të paanshme, objektive dhe të besueshme, në shërbim dhe në përmbushje të objektivave ligjorë të Bankës, si bankë qendrore e Republikës së Shqipërisë dhe si agjenci statistikore, brenda Sistemit Kombëtar Statistikor.

Funksioni statistikor, gjatë vitit 2025, është formësuar në përgjigje të tre zhvillimeve themelore: përshpejtimin të digjitalizimit të ekonomisë dhe sektorit financiar, thellimit të procesit të integritimit evropian dhe përshtatjes me standardet e reja ndërkombëtare metodologjike dhe rregullatore.

Në një mjedis ku kompleksiteti i të dhënave dhe kërkesat për granularitet janë rritur ndjeshëm, statistikave nuk përbëjnë më vetëm një produkt raportimi, por një infrastrukturë kritike të qeverisjes ekonomike dhe financiare. Për këtë arsye, gjatë vitit 2025, prioritet strategjik ka qenë modernizimi i arkitekturës së menaxhimit të të dhënave, forcimi i qeverisjes së tyre dhe harmonizimi i plotë me standardet evropiane dhe ndërkombëtare.

Arritjet e këtij viti konfirmojnë kalimin nga një fazë përgatitore metodologjike drejt realizimit konkret të objektivave të përafrimit me Bashkimin Evropian (BE) dhe Sistemin Evropian të Bankave Qendrore (SEBQ), duke materializuar angazhimet strategjike të ndërmarra në vitet e fundit.

1. Integrimi evropian dhe përmbushja e piketave mbyllëse (Kapitulli 18 - Statistikat)

Në kuadër të angazhimeve për integrimin evropian, gjatë këtij viti, u shënuan një nga arritjet më të rëndësishme në fushën e statistikave zyrtare, përmes raportimit për herë të parë në Eurostat, me statusin për publikim, të serisë katërvjeçare të të dhënave të Procedurës së Deficitit të Tejkuluar (EDP) / Statistikave Financiare të Qeverisë (GFS) – një ndër piketat kryesore mbyllëse të Kapitullit 18 – Statistikat, me ndikim të drejtpërdrejtë në përmbushjen e kërkesave të Kapitullit 17 – Politika Ekonomike dhe Monetare. Përmes këtij raportimi është garantuar përputhshmëri e plotë me standardet metodologjike të Bashkimit Evropian (ESA 2010), duke rritur transparencën dhe besueshmërinë e statistikave fiskale.

Rezultati është fryt i një bashkëpunimi të strukturuar dhe të qëndrueshëm ndërinstitucional, i cili ka forcuar koordinimin mes BSH-së, INSTAT-it dhe Ministrisë së Financave në prodhimin e statistikave makroekonomike, në përputhje me *acquis communautaire*.

Një arritje tjetër me rëndësi për përmbushjen e detyrimeve të Kapitullit 18 ishte transmetimi për herë të parë pranë Eurostat i Bilancit Mujor të Pagesave. Eurostat ka vlerësuar për të dytin vit radhazi statistikave e sektorit të jashtëm në nivelin më të lartë, duke konfirmuar standardet më të avancuara të cilësisë dhe besueshmërisë.



Statistikat e tregtisë ndërkombëtare të shërbimeve paraqesin shkallë të plotë të përafrimit teknik me *acquis* të BE-së, ndërsa statistikat e investimeve të huaja direkte arrijnë një nivel të lartë përafrimi me kërkesat evropiane.

2. Përafrimi me *acquis* të BE-së në fushën e mbikëqyrjes bankare

Në funksion të përafrimit me *acquis* të BE-së në fushën e mbikëqyrjes bankare, gjatë vitit 2025, u hartua dhe u formalizua Plani i Veprimit për përafrimin gradual të raportimit rregullator të bankave me standardet evropiane të Autoritetit Bankar Evropian (EBA) dhe Bankës Qendrore Evropiane (BQE), në bashkëpunim të ngushtë me sektorin bankar dhe partnerët ndërkombëtarë.

Ky plan përbën një kornizë të qartë dhe të fazuar të zbatimit, të ndërtuar mbi një vlerësim të thelluar të gjendjes aktuale dhe kapaciteteve të sektorit bankar, përfshirë konsultime të drejtpërdrejta me bankat mbi nivelin e përgatitjes së tyre. Duke reflektuar sfidat teknike, sistematike dhe organizative të identifikuara gjatë këtij procesi, Plani i Veprimit përcakton një trajektore realiste dhe konkrete drejt përafrimit me *acquis* të BE-së dhe me Standardet Teknike të Zbatimit (ITS) të EBA-s, duke garantuar një tranzicion të strukturuar, të qëndrueshëm dhe të menaxhuar me kujdes. Reforma synon forcimin e qeverisjes së të dhënave, përmirësimin e cilësisë, krahasueshmërisë dhe transparencës së statistikave të sektorit bankar, si dhe sigurimin e koherencës ndërmjet infrastrukturës mbikëqyrëse, statistikore dhe teknologjike të raportimit.

Kjo reformë përfaqëson një hap strukturor drejt integritit të plotë të raportimit rregullator me arkitekturën evropiane të mbikëqyrjes bankare.

3. Modernizimi strukturor i infrastrukturës statistikore

Gjatë vitit 2025, BSH-ja ka avancuar në realizimin e projekteve strategjike që synojnë modernizimin e infrastrukturës statistikore, në përgjigje të zhvillimeve të shpejta teknologjike, integritit financiar global dhe kërkesës në rritje për transparencë, cilësi dhe qëndrueshmëri të të dhënave për vendimmarrje bazuar në evidencë.

Në mbledhjen e muajit dhjetor 2025, Këshilli Mbikëqyrës miratoi bashkëpunimin me Bankën e Italisë në fushën e përpunimit të të dhënave statistikore, si pjesë e vizionit afatgjatë për modernizimin institucional dhe forcimin e kapaciteteve analitike të BSH-së. Ky vendim pasqyron angazhimin e Bankës për të ndërtuar një infrastrukturë statistikore bashkëkohore, të sigurt dhe të harmonizuar me standardet dhe praktikën e BE-së. Vendimi synon të mbështesë një proces transformimi gradual dhe të qëndrueshëm, duke rritur efikasitetin operacional, duke ulur barrën raportuese për institucionet raportuese dhe duke përmirësuar ndjeshëm kapacitetin e Bankës për të prodhuar statistika cilësore, në shërbim të politikëbërjes, transparencës dhe besueshmërisë institucionale.

Ky projekt përfaqëson një reformë strukturorë të arkitekturës së menaxhimit të të dhënave, duke mundësuar integrimin e raportimit statistikor dhe atij mbikëqyrës në një platformë të unifikuar dhe të standardizuar.



Ky hap strategjik e pozicionon BSH-në në linjë me praktikat e bankave qendrore të BE-së dhe krijon bazën për raportim të standardizuar dhe të automatizuar drejt BQE-së.

4. Zhvillimi metodologjik dhe rritja e cilësisë së statistikave

Në funksion të rritjes së cilësisë dhe integritetit të statistikave, gjatë vitit 2025, u realizuan përmirësime të rëndësishme metodologjike dhe analitike.

Me mbështetjen e SECO-s, u arritën përmirësime të ndjeshme në hartimin e statistikave të llogarive financiare, duke mundësuar prodhimin e serive kohore tremujore të harmonizuara plotësisht me statistikatat financiare të qeverisë së përgjithshme.

Në bashkëpunim me Bankën Botërore, u zhvillua studimi për zbatimin e metodologjisë së vlerësimit të qëndrueshmërisë financiare të korporatave, duke harmonizuar regjistrat administrativë për identifikimin e ekspozimeve individuale dhe duke forcuar analizën makroprudenciale.

Vijoi gjithashtu implementimi i projektit IPA 2022 mbi statistikatat e Investimeve të Huaja Direkte, duke rritur detajimin dhe përputhshmërinë metodologjike me kërkesat e Komisionit Evropian.

5. Qeverisja e të dhënave, koordinimi institucional dhe transparenca

Gjatë vitit 2025, Banka e Shqipërisë vijoi forcimin e kuadrit të qeverisjes së të dhënave, me qëllim garantimin e cilësisë, integritetit, konfidencialitetit dhe sigurisë së statistikave zyrtare. Standardizimi i proceseve të prodhimit statistikor, përmirësimi i mekanizmave të kontrollit të cilësisë dhe automatizimi progresiv i validimeve kontribuuan në rritjen e koherencës metodologjike dhe konsistencës ndërmjet statistikave monetare, financiare dhe makroekonomike.

Rishikimi i Marrëveshjes së Bashkëpunimit me INSTAT-in (shtator 2025), synon të sigurojë koordinim të plotë ndërmjet statistikave të prodhuara në kuadër të Sistemit Evropian të Statistikave dhe atyre të harmonizuara me kërkesat e SEBQ-së. Përmes qartësimit të përgjegjësive dhe forcimit të mekanizmave të bashkëpunimit, marrëveshja garanton koherencë metodologjike, shmangie të mbivendosjeve dhe përputhshmëri të plotë me kuadrin e bashkëpunimit në fushën e prodhimit të statistikave në BE.

Gjatë vitit, Banka e Shqipërisë, në cilësinë e saj si Autoritet tjetër Kombëtar në Sistemin Statistikor Kombëtar, përfundoi ushtrimin e vetëvlerësimit në kuadër të raundit 2025–2027 të Peer Review të Eurostat. Vetëvlerësimi u zhvillua mbi bazën e 15 parimeve të Kodit të Praktikave të Statistikave Evropiane dhe synoi vlerësimin e përputhshmërisë së kuadrit institucional, proceseve statistikore dhe produkteve statistikore të Bankës me standardet evropiane. Rezultatet e ushtrimit konfirmojnë një nivel të lartë përafrimi me parimet e pavarësisë profesionale, sigurimit të cilësisë, konfidencialitetit dhe transparencës, si dhe



evidentojnë fushat prioritare për zhvillim të mëtejshëm, veçanërisht në drejtim të qeverisjes së të dhënave, automatizimit të proceseve dhe forcimit të koordinimit ndërinstytucional.

Ky proces përbën një hap të rëndësishëm në konsolidimin e kuadrit statistikor të Bankës dhe në vijimin e harmonizimit të tij me praktikat e bankave qendrore të Sistemit Evropian të Bankave Qendrore.



2.10. PUNA KËRKIMORE


Banka e Shqipërisë synon të mbështesë procesin e saj vendimmarrës në themele të forta dijesh dhe njohurish mbi ekonominë shqiptare. Forcimi i kapaciteteve kërkimore rrit cilësinë e analizës, përmirëson standardet profesionale dhe konsolidon reputacionin e Bankës së Shqipërisë si një institucion që zotëron metodologji bashkëkohore dhe ekspertizën e nevojshme për të kontribuar në garantimin e stabilitetit dhe ekuilibrat makroekonomikë të vendit. Në këtë kuadër, zhvillimi i qëndrueshëm dhe aktiv i kërkimit shkencor përbën një prioritet strategjik për Bankën e Shqipërisë dhe një shtyllë themelore të zhvillimit të saj institucional.

Gjatë vitit 2025, veprimtaria kërkimore u përqendrua në analizën e zhvillimeve ekonomike dhe financiare me rëndësi për politikën monetare dhe stabilitetin financiar, duke adresuar njëkohësisht tema strukturore si emigracioni dhe ndryshimet demografike, financa e gjelbër dhe rreziqet nga ndryshimet klimatike për sistemin bankar, si edhe në thellimin e edukimit dhe përfshirjes financiare. Në përputhje me orientimin afatmesëm, kërkimi ka kontribuar në pasurimin e bazës statistikore dhe të modeleve analitike, përfshirë integrimin e teknikave të avancuara kompjuterike dhe të inteligjencës artificiale në analizën ekonomike.

Projektet kërkimore me fokus në politikën monetare u përqendruan në vlerësimin e efekteve asimetrike të kursit të këmbimit në inflacionin e shportës së konsumit dhe aftësinë e ndërmarrjeve të vogla e të mesme për të siguruar burime financimi, gjatë shtrëngimit të kushteve monetare. Është fakt i ditur se luhatjet e kursit të këmbimit kanë një ndikim të rëndësishëm në inflacionin total në ekonominë shqiptare. Megjithatë, studimi i efekteve asimetrike të kursit të këmbimit në drejtim të kahut të lëvizjes dhe për nivele të ndryshme të inflacionit, tregon se nënçmimi i kursit ndikon pozitivisht në rritjen e çmimeve, por efektet janë më të zbehta në rastin e mbiçmimit të monedhës. Rezultati kryesor evidenton në veçanti se nënçmimet kanë tendencë të kenë një efekt inflacionist më të theksuar në kuantilet më të larta të inflacionit.

Rëndësia e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme për ekonominë shqiptare ka nxitur studimin mbi vështirësitë që ato hasin për t'u financuar gjatë periudhave me kushte monetare të shtrënguara. Analiza tregon se rritja e normave të interesit në vitin 2022 nxiti përdorimin e financimeve alternative dhe të fondeve të brendshme, sidomos te firmat e vogla dhe relativisht të reja, të cilat kanë presione të vazhdueshme të nevojave për likuiditet.

Emigracioni dhe ndryshimet demografike ndikojnë zhvillimin ekonomik dhe prosperitetin e një shoqërie, duke ushtruar presione në tregun e punës e, për rrjedhojë, edhe në vendimmarrjen e politikës monetare. Shqipëria renditet ndërmjet vendeve ku afërsisht 40% e fuqisë punëtore ka emigruar jashtë vendit. Rezultatet e studimit tregojnë se dinamika afatshkurtër e tregut të punës dominohet nga goditjet e kërkesës, ndërsa oferta e punës përcakton trendet



afatgjata. Rritja e ofertës së punës nuk gjeneron presione inflacioniste në paga, por rritja e normës së pjesëmarrjes në forcën e punës shoqërohet me rritje të pagave dhe, për rrjedhojë, me presione inflacioniste.

Pasojat e dinamikave në tregun e punës për hapësirën e veprimit të politikës monetare u vlerësuan përmes një modeli makroekonomik. Rezultatet e marra sugjerojnë se dinamika demografike shpjegon rreth 20% të rënies së normës reale të interesit që nga viti 2001, duke konfirmuar se efektet e saj kanë prekur edhe hapësirën e veprimit të politikës monetare.

Koncepti i përballueshmërisë së blerjes së banesës është bërë gjithnjë e më i rëndësishëm në debatin publik dhe akademik gjatë viteve të fundit, si pasojë e rritjes së vazhdueshme të çmimeve të banesave. Për shkak të implikimeve të tregut të banesave për stabilitetin financiar, disa materiale studimore në BSH janë përqendruar në ndërtimin e një indeksi hedonik të çmimeve të banesave në Shqipëri, në matjen e përballueshmërisë së blerjes së banesave, dhe në analizimin e ecurisë makro-financiare të tregut të banesave në vend.

Ndërtimi i indeksit hedonik të çmimeve të banesave, i bazuar në listimet *online* që nga viti 2015, synon të ofrojë një matje më të saktë dhe të detajuar të zhvillimeve në tregun e pasurive të paluajtshme në rang kombëtar. Mbulimi i gjerë gjeografik mundëson analiza krahasuese ndërmjet kryeqytetit, zonave bregdetare dhe territoreve të tjera, duke evidentuar diferencat strukturore në dinamikën e çmimeve. Paralelisht, studimet mbi përballueshmërinë e strehimit vlerësojnë aftësinë e një familjeje tipike për të financuar blerjen e një banese me kredi hipotekare, duke marrë në konsideratë të ardhurat, kostot financiare dhe karakteristikat e pronës. Një analizë tjetër, me qasje makroekonomike, shqyrton devijimet e çmimeve nga ekuilibrat afatgjatë dhe ndikimin e tyre në rritjen ekonomike.

Gjetjet paraprake sugjerojnë prani të shmangieve nga nivelet e qëndrueshme afatgjata, me implikime të mundshme për stabilitetin financiar të familjeve, sektorin bankar dhe për rritjen ekonomike. Këto evidenca mbështesin qasjen parandaluese të BSH-së për menaxhimin e ekspozimit të bankave ndaj tregut të pasurive të paluajtshme.

Në kuadër të stabilitetit financiar dhe mbikëqyrjes bankare, studimet janë përqendruar në analizën e përcaktuesve të përfitueshmërisë së bankave tregtare dhe efikasitetit të përdorimit të burimeve të tyre. Vëmendja është fokusuar në ndikimin e treguesve makroekonomikë dhe të shëndetit bankar, duke përdorur metodologjinë MIDAS (të dhëna me frekuencë të përzierë) mbi një panel të dhënash për periudhën 2002–2024.

Gjetjet e studimit konfirmojnë analizën e BSH-së se aktiviteti ekonomik dhe raporti i mjaftueshmërisë së kapitalit kanë një ndikim pozitiv në normën e kthimit mbi aktivet e bankave, ndërsa kreditë me probleme e ndikojnë atë negativisht. Një tjetër gjetje e rëndësishme është se efektet e rrezikut të kredisë dhe të



normave të interesit zbehen gradualisht me kalimin e kohës, ndërsa ndikimi i kursit të këmbimit amplifikohet në kohë. Studimi kontribuon mbi literaturën ekzistuese, duke ilustruar mënyrën se si të dhënat me frekuenca të ndryshme kohore mund të integrohen në një kuadër konciz, duke shmangur problematikën e parametrizimit të tepërt.

Ndërkohë, studimi që shqyrton efikasitetin e përdorimit të burimeve në ofrimin e shërbimeve financiare identifikon ndryshime të rëndësishme në efikasitetin e kostos dhe fitimit midis institucioneve bankare, duke theksuar se mangësitë në faktorët menaxherialë, teknologjikë dhe ata strukturorë, dëmtojnë efikasitetin dhe fitimin e institucioneve bankare. Gjetjet ofrojnë informacion të vlefshëm për politikkbërësit dhe palët e interesuara të industrisë bankare për hartimin e strategjive që synojnë të rrisin konkurrueshmërinë, të forcojnë rezultatet dhe qëndrueshmërinë financiare, dhe të përmirësojnë shëndetin dhe stabilitetin e përgjithshëm të sektorit bankar shqiptar.

Vrojtimi i pasurisë së familjeve shqiptare ofron një pasqyrë të përditësuar dhe të detajuar mbi strukturën e aktiveve reale dhe financiare, si edhe nivelin e detyrimeve të tyre, duke përfshirë informacion mbi burimet e të ardhurave, sjelljen e konsumit dhe karakteristikat socio-demografike. Vrojtimi i parë, i realizuar në vitin 2018, evidentoi rolin e rëndësishëm të remitancave në mirëqenien ekonomike të familjeve, duke ulur probabilitetin e klasifikimit të tyre nën kufirin e varfërisë dhe duke forcuar qëndrueshmërinë e të ardhurave të saj. Gjatë vitit 2025 u ndërmor cikli i dytë i këtij vrojtimi, ndërsa përpunimi dhe analizimi i të dhënave të mbledhura planifikohet të realizohet gjatë vitit 2026.

Së fundi, evidentojmë studimet dhe analizat empirike mbi efektet e ndryshimeve klimatike dhe sfidat që ato paraqesin për stabilitetin makroekonomik e financiar. Raportet dhe materialet studimore janë përqendruar në vlerësimin e efekteve negative dhe politikave të tranzicionit (drejt një ekonomie të gjelbër) në ekonominë shqiptare, si dhe në rolin e institucioneve financiare në kontekstin e miradministrimit të rrezikut të ardhur nga ndryshimet e klimës. BSH-ja ka bashkëpunuar me institucione kombëtare e ndërkombëtare për pëmbushjen e detyrimeve që rrjedhin nga zbatimi i strategjisë së gjelbër. Përgatitja dhe publikimi i Progres-Raportit Vjetor të Monitorimit dhe Vlerësimit të Strategjisë së Gjelbër të BSH-së përshkruan arritjet dhe sfidat e autoritetit monetar për përballimin e rreziqeve financiare të ndërlidhura me klimën.


Në këtë vazhdë, analizat kanë vlerësuar ekspozimin e sektorit bankar shqiptar ndaj rreziqeve klimatike, duke përfshirë rreziqet fizike dhe ato të tranzicionit. Ato përpiqen të identifikojnë sektorët dhe aktivitetet ekonomike më të prekura nga ndryshimet klimatike, dhe janë një hap i rëndësishëm drejt përmirësimit të qëndrueshmërisë së sektorit financiar dhe përafrimit të tij me standardet ndërkombëtare të qëndrueshmërisë.

Këto dhe studime të tjera janë bërë objekt diskutimi në aktivitetet dhe konferencat e organizuara nga BSH-së apo institucione të tjera. Në këtë kuadër, Banka



organizoi "Takimin e 19-të Rajonal të Kërkimeve për Evropën Juglindore", në datat 6-7 nëntor 2025. Ky aktivitet kërkimor shkencor shërben si një forum diskutimi për punimet kërkimore mbi çështjet aktuale ekonomike dhe financiare, dhe përpiqet të nxisë shkëmbimin e pikëpamjeve midis kërkuesve të BSH-së, bankierëve qendrorë, komunitetit akademik e të tjerë, në rajon dhe më gjerë.

Në faqen zyrtare të BSH-së, nën kategorinë "Botime/Botime kërkimore" gjendet informacion më i detajuar mbi të gjitha punët kërkimore të institucionit. Punë të tjera kërkimore publikohen në formën e artikujve në Revistën Ekonomike të BSH-së, ndërkohë revista me frekuencë gjashtëmujore "Të rejat shkencore në Bankën e Shqipërisë" informon në lidhje me materialet studimore të sapo përfunduara apo ato në proces, materialet e prezantuara në aktivitetin "Seminaret e së Premtes" apo në aktivitete të tjera të organizuara nga Banka.



2.11. INTEGRIMI EVROPIAN DHE BASHKËPUNIMI NDËRKOMBËTAR


Banka e Shqipërisë jep kontributin e saj në përmbushjen e detyrimeve që rrjedhin nga hapja e procesit të negociatave për anëtarësim në BE, Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit, progres-raportet e Komisionit Evropian, Nënkomitetet e përbashkëta BE-Shqipëri, si dhe Plani Kombëtar për Integrimin Evropian. Ajo kryeson Grupet Ndërinstitucionale të Punës së Integritit Evropian për 2 kapituj të acquis dhe ka një kontribut të qenësishëm në 6 kapituj të tjerë.

Banka e Shqipërisë ka vijuar të mbështesë në mënyrë aktive procesin e integritit evropian, përmes angazhimit në grupet ndërinstitucionale dhe kontributit në hartimin e dokumenteve strategjike që synojnë përafrimin e legjislacionit dhe politikave me acquis të Bashkimit Evropian.

Gjatë vitit 2025, puna vazhdoi në drejtim të adresimit të piketave mbyllëse për çdo kapitull të paraqitura nga Komisioni Evropian (KE), në përputhje me objektivin e mbylljes së negociatave të anëtarësimit brenda vitit 2027. Rrjedhimisht, BSH-ja, si institucion lider për kapitullin 4 – Lëvizja e lirë e kapitalit dhe kapitullin 17 – Politikat Ekonomike dhe Monetare, ka qenë maksimalisht e angazhuar në përgatitjen e planeve të punës dhe ndjekjen e tyre. Ajo ka bashkëpunuar ngushtë me institucionet kontribuuese në këta kapituj, nëpërmjet mbledhjeve të grupeve ndërinstitucionale të punës dhe nëpërmjet bashkëpunimit me Zyrën e Kryenegociatorit. Gjithashtu, BSH-ja ka kontribuar në hartimin e planeve të punës për adresimin e piketave mbyllëse për kapitujt e tjerë si Kapitulli 9 – Shërbimet Financiare, Kapitulli 18 – Statistikat dhe Kapitulli 28 – Mbrojtja e Konsumatorit. Aktualisht, Banka po punon për përafrimin e plotë të legjislacionit të saj: Ligji për Bankën e Shqipërisë, Ligji për bankat në Republikën e Shqipërisë dhe Ligji për Shërbimet e Pagesave.

BSH-ja përfaqësohet rregullisht në takimin vjetor në nivel të lartë të Komitetit të Stabilizim-Asociimit, në takimet e dy Nënkomiteteve: 1) Tregu i brendshëm dhe Konkurrenca, dhe 2) Çështjet Ekonomike, Financiare dhe Statistikat, si dhe në Dialogun Ekonomik dhe Financiar midis BE-së dhe vendeve të Ballkanit Perëndimor dhe Turqisë. Në takimet e mësipërme është diskutuar, në nivel politik dhe teknik, mbi çështje si: zbatimi i politikës monetare, stabiliteti financiar, treguesit dhe zhvillimet e sektorit bankar etj.

Në nëntor 2025, Komisioni Evropian dorëzoi pranë autoriteteve shqiptare Raportin e Progresit 2025, i cili përshkruan progresin e bërë nga Shqipëria gjatë vitit. Në Kapitullin 4, Shqipëria vlerësohet ndërmjet një niveli “të moderuar dhe të mirë” përgatitjeje, duke nënvizuar anëtarësimin e Shqipërisë në SEPA. Edhe në Kapitullin 17, Shqipëria ndodhet midis një niveli “të moderuar dhe të mirë” përgatitjeje në fushën e politikës ekonomike dhe monetare, duke veçuar progresin e arritur në ruajtjen e stabilitetit të çmimeve nga BSH-ja.



BASHKËPUNIMI ME INSTITUCIONET E HUAJA

Banka e Shqipërisë ka bashkëpunuar ngushtë me institucionet e huaja, duke shkëmbyer analiza dhe opinione, në funksion të forcimit të bashkërendimit të politikave makroekonomike dhe ekspertizës profesionale.

MARRËDHËNIET ME FONDIN MONETAR NDËRKOMBËTAR

Republika e Shqipërisë iu bashkua FMN-së në tetor 1991. Ajo vazhdon të qëndrojë në kuotën e 139.3 milionë SDR (0.03% e totalit) dhe zotëron 2.858 vota ose 0.06% të shumës së përgjithshme të votave të të gjithë anëtarëve të FMN-së. Shqipëria ndodhet në të njëjtën konstituencë me Italinë, Greqinë, Portugalinë, Maltën dhe San Marinon. Shuma totale e akorduar dhe e lëvruar deri më 31 dhjetor 2025 është 204.92 milionë SDR³³.

Marrëdhëniet e Shqipërisë me FMN-në vijojnë të përqendrohen nën konsultimet e Artikullit IV. Në dhjetor 2025, Bordi Ekzekutiv i FMN-së përmbylli konsultimet për Artikullin IV me Shqipërinë, në përfundim të cilit publikoi vlerësimet mbi ecurinë e ekonomisë shqiptare dhe bëri rekomandimet përkatëse³⁴.

MARRËDHËNIET ME GRUPIN E BANKËS BOTËRORE

Grupi i BB-së ka filluar punën në Shqipëri në vitin 1991 dhe ka mbështetur një sërë projektesh, duke synuar zbutjen e varfërisë dhe sigurimin e mjeteve të qëndrueshme, për të nxitur zhvillimin afatgjatë të vendit. Shqipëria bën pjesë në konstituencën e përbërë nga Greqia, Italia, Portugalia, Malta dhe Timori Lindor.

Kuadri aktual i Partneritetit 2023–2027 përqendrohet në nxitjen e rritjes së qëndrueshme, të udhëhequr nga sektori privat.

BB-ja ka mbështetur BSH-në në fushën e pagesave, administrimit të rezervës valutore, mbikëqyrjes financiare, ndërhyrjes së jashtëzakonshme, statistikave, sigurisë kibernetike, edukimit dhe përfshirjes financiare etj.

BASHKËPUNIMI TEKNIK

Gjatë vitit 2025 ka vazhduar zbatimi i fazës së dytë të programit "Forcimi i kapaciteteve të bankave qendrore të vendeve candidate dhe kandidatëve të mundshëm për anëtarësim në BE nga Ballkani Perëndimor" të financuar nga BE-ja. Ky program synon forcimin e mëtejshëm të kapaciteteve të institucioneve përfituese, kryesisht përmes përmirësimit të mëtejshëm të instrumenteve të tyre analitike dhe politike, nëpërmjet përvetësimit të standardeve më të mira ndërkombëtare dhe evropiane në praktikat kombëtare. Programi mbështetet nga BE-ja, nëpërmjet Instrumentit të saj për Asistencën e Para-Anëtarësimit (IPA III).

³³ Informacion i përftuar nga faqja zyrtare e internetit e FMN-së për Shqipërinë <https://www.imf.org/en/countries/alb>

³⁴ <https://www.imf.org/-/media/files/publications/cr/2025/english/1albea2025003-source-pdf.pdf>



BSH-ja ka marrë pjesë në trajnimet dhe internship-e të organizuara nga Banka Qendrore Evropiane, si dhe ka përfituar nga ekspertiza në fushat e sistemit të pagesave, statistikave, mbikëqyrjes financiare, kontabilitetit, ndërhyrjes së jashtëzakonshme, mirëqeverisjes, stabilitetit financiar, menaxhimit të parasë, etj.

Aktivitete të tjera dhe pjesëmarrje në aktivitete ndërkombëtare, gjatë vitit 2025

- Në datën 27 mars 2025, Zëvendësgovernatorja e Parë, zj. Minxhozi, mori pjesë në konferencën “Gratë dhe aktivitetet financiare të paligjshme në Ballkanin Perëndimor: Zgjerimi i kufijve për njohuri dhe veprim”, organizuar nga Qendra AIRE për Ballkanin Perëndimor, me mbështetjen e Qeverisë së Mbretërisë së Bashkuar.
- Në datat 21-26 prill 2025, në Uashington, u zhvilluan Mbledhjet e Pranverës të FMN-së dhe të Grupit të BB-së, me pjesëmarrjen e ministrave të financave të vendeve anëtare, guvernatorëve të bankave qendrore, drejtuesve të lartë të institucioneve financiare ndërkombëtare, si dhe përfaqësuesve të botës akademike, biznesit dhe shoqërisë civile. Gjatë prezencës atje, Guvernatori Sejko zhvilloi disa takime të rëndësishme me personalitete të njohura të fushës financiare ndërkombëtare.
- Në datat 29-30 maj 2025, Guvernatori Sejko mori pjesë në konferencën e nivelit të lartë të organizuar nga Banka Kombëtare e Kroacisë dhe FMN-ja, me temë “Rritja dhe qëndrueshmëria në vendet e Evropës Qendrore, Lindore dhe Juglindore (EQIJJL), në një botë më të fragmentuar”, në Dubrovnik, Kroaci. Në këtë takim dyditor u zhvillua një tryezë e rumbullakët me Drejtoreshën e Përgjithshme të FMN-së, zj. Kristalina Georgieva, ku morën pjesë ministrat e financave dhe guvernatorët e bankave qendrore të vendeve të EQIJJL-së.
- Në datat 26-27 qershor 2025, Guvernatori Sejko mori pjesë në Mbledhjen e Konstituencës së FMN-së dhe të BB, zhvilluar në Varese, Itali. Takimi mblodhi së bashku guvernatorët dhe ministrat e financave të vendeve anëtare të kësaj konstituence, për të diskutuar mbi zhvillimet më të fundit të ekonomisë botërore dhe ekonomive përkatëse. Përfaqësues të lartë të FMN-së dhe BB-së prezantuan perspektivat e dy institucioneve për të garantuar stabilitet financiar dhe rritje ekonomike të qëndrueshme dhe afatgjatë.
- Në datat 29-30 shtator 2025, Zëvendësgovernatorja e Dytë, zj. Ahmetaj, ndoqi punimet e takimit vjetor të Forumit të Iniciativës së Vjenës, organizuar nga Komisioni Evropian, në Bruksel. Këtë vit, forumi u fokusua te projekti evropian “Unioni i Kursimeve dhe Investimeve” dhe rëndësia e tij për ekonominë e EQIJJL-së, duke trajtuar sfidat dhe përfitimet e mundshme për rajonin.



- Në datën 10 tetor 2025, Guvernatori Sejko mori pjesë në Konferencën Shkencore Ndërkombëtare, me temë “Ndryshimet demografike dhe dinamika e tregut të punës - sfidat e zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik në Shqipëri, Kosovë dhe rajon”, të organizuar nga Akademia e Shkencave të Shqipërisë dhe Akademia e Shkencave dhe e Arteve të Kosovës. Kjo konferencë pati në fokus një ndër sfidat më të mëdha të kohës sonë: ndërthurjen mes zhvillimeve demografike dhe strukturës së tregut të punës, në kontekstin e qëndrueshmërisë ekonomike.
- Në datat 16-18 tetor 2025, Guvernatori Sejko mori pjesë në Mbledhjet Vjetore të FMN-së dhe të Grupit të BB-së, të zhvilluara në Uashington DC, SHBA. Takimet e zhvilluara në këto mbledhje kishin në fokus zhvillimet më të fundit në ekonominë botërore.

MEMORANDUME BASHKËPUNIMI

Banka e Shqipërisë dhe Banka Evropiane e Investimeve (BEI) nënshkruan, në janar 2025, një marrëveshje historike bashkëpunimi për zhvillimin e financave të gjelbra dhe për mbështetjen e rritjes ekonomike të qëndrueshme në Shqipëri. Kjo marrëveshje, pjesë e Programit për Sistemet Financiare të Gjelbra të BEI-t, synon të forcojë qëndrueshmërinë e sistemit financiar shqiptar, duke integruar rreziqet klimatike në kuadrin rregullator dhe duke e përgatitur Shqipërinë për harmonizimin me standardet e BE-së.

Kjo iniciativë ofron një bazë solide për forcimin e kapaciteteve të sektorit financiar shqiptar, ndërsa krijon mundësi për investime që kontribuojnë në mbrojtjen e mjedisit dhe reduktimin e rreziqeve klimatike. Për më tepër, ajo pasqyron rëndësinë e bashkëpunimit ndërinstitucional për të harmonizuar praktikatat me standardet më të mira ndërkombëtare, duke i hapur rrugën Shqipërisë drejt një të ardhmeje më të qëndrueshme dhe më të sigurt.



2.12. TRANSPARENCA DHE KOMUNIKIMI ME PUBLIKUN

Komunikimi me publikun përbën një hallkë të rëndësishme në aktivitetin e Bankës së Shqipërisë, si në përbushjen e detyrimit për të ofruar transparencë maksimale të vendimmarrjes, ashtu dhe në funksion të rritjes së efektivitetit, nëpërmjet forcimit të besueshmërisë së saj. Në këtë kuadër, Banka e vlerëson komunikimin ndëreveprues me publikun si një çështje parësore dhe me rëndësi strategjike, për të transmetuar tek opinioni publik, sa më drejt dhe kuptueshëm, aktivitetet e saj.

NJË BANKË QENDRORE E HAPUR DHE TRANSPARENTE

Përtej detyrimeve ligjore, Banka e Shqipërisë i komunikon publikut një informacion të shumëllojshëm lidhur me rolin dhe veprimtarinë e saj, nga vendimmarrja e Këshillit Mbikëqyrës deri tek aktiviteti operacional i përditshëm. Ky komunikim transparent ndihmon në rritjen e efektivitetit të politikave të ndjekura nga Banka e Shqipërisë, duke bërë që publiku të kuptojë drejt vendimet e marra prej saj.

Në këtë kuadër, BSH-ja përdor një sërë kanalesh komunikimi, me qëllim shpjegimin sa më qartë të rolit, objektivit kryesor të saj – ruajtjes së stabilitetit të çmimeve – si dhe të mënyrës së përbushjes së tij. Komunikimi ynë synon të mbështesë politikat e Bankës në garantimin e stabilitetit monetar dhe financiar të vendit, zhvillimin e tregjeve financiare dhe instrumenteve të pagesave, përkrahjen e procesit të integritimit evropian, adresimin e sfidave afatgjata të zhvillimit të vendit dhe përmirësimin e strategjive, politikave dhe procedurave të brendshme.

Vendimmarrja e politikës monetare bazohet në një cikël periodik analizash, parashikimesh dhe vlerësimi të zhvillimeve ekonomike e financiare, të përcaktuar në një kalendar vjetor prej 8 mbledhjesh të Këshillit Mbikëqyrës. Pas çdo mbledhjeje, zhvillohet konferenca për shtyp e Guvernatorit, ku i shpjegohet publikut vendimi i marrë nga Këshilli Mbikëqyrës dhe analiza e përdorur në mbështetje të këtij vendimi. Në përgjigje të këtij cikli, gjatë vitit 2025, u organizuan konferencat përkatëse për shtyp, gjatë të cilave, krahas deklaratës së politikës monetare, Guvernatori i është përgjigjur edhe interesit të medias për çështje të tjera të lidhura me BSH-në. Konferencat për shtyp janë shoqëruar me publikimin e fjalimeve të Guvernatorit dhe të zbardhjes së pyetje-përgjigjeve përkatëse, në gjuhën shqipe dhe angleze.

Gjithashtu, gjatë vitit 2025, pas çdo mbledhjeje u vijua me publikimin e një përmbledhjeje të shkurtër me vendimet kryesore të marra nga Këshilli Mbikëqyrës i BSH-së. Të gjitha vendimet publike të Këshillit Mbikëqyrës, si dhe urdhrat ose aktet e administratorëve, të zbatueshme nga subjektet e licencuara nga BSH-ja, u botuan të plota në Buletinin Zyrtar, në 8 numrat e tij.

Komunikimi i BSH-së pasurohet me publikimin periodik të Raportit të Stabilitetit Financiar (gjashtëmujor) dhe Raportit Vjetor të Mbikëqyrjes Bankare. I pari



analizon zhvillimet kryesore të sistemit financiar, identifikon rreziqet sistemike dhe vlerëson masat e nevojshme për adresimin e tyre, ndërsa i dyti paraqet ecurinë e sistemit bankar, aktivitetin mbikëqyrës, ndryshimet rregullatore dhe statistikën mbi subjektet e licencuara.

Krahas raporteve periodike, komunikimi ynë plotësohet në mënyrë të vazhdueshme dhe në kohë reale me një sërë raportesh periodike, vrojtimesh, analizash, të dhënash, vlerësimesh e opinionesh të BSH-së, mbi gjendjen makroekonomike të vendit dhe rolin e Bankës në mbështetje të stabilitetit financiar të tij.

Komunikimi me publikun i përgjigjet interesit, nivelit akademik dhe formimit profesional të grupeve të shënjestuara nga BSH-ja, ndër të cilat vend të rëndësishëm zë media. Edhe gjatë vitit 2025, komunikimi me median ka vijuar, nëpërmjet konferencave për shtyp, fjalimeve, prezantimeve dhe kumtesave të mbajtura në aktivitete të organizuara nga BSH-ja apo institucione të tjera vendase dhe të huaja, intervistave të dedikuara apo pjesëmarrjes në emisione televizive, shprehjes së qëndrimeve për çështje specifike me interes për BSH-në apo aktiviteteve të tjera publike të Guvernatorit dhe përfaqësuesve të tjerë të saj. Në gjuhën e numrave, gjatë vitit janë hartuar 118 fjalime, njoftime e deklarata për shtyp, janë realizuar 88 intervista, qëndrime zyrtare e pjesëmarrje në emisione televizive, si dhe janë zhvilluar 7 prezantime "off the records" të raporteve të saj periodike. Këto prezantime synojnë orientimin e medias në leximin e drejtë të vendimmarrjes së BSH-së dhe vlerësohen si një mjet mjaft efikas komunikimi.

Në një botë ku informacioni qarkullon me shpejtësi dhe platformat digjitale po kthehen në burime kryesore të komunikimit, BSH-ja ka vazhduar të forcojë praninë e saj në mediat sociale, gjatë vitit 2025. E pranishme në LinkedIn, X, Facebook, YouTube, Flickr dhe së fundmi Instagram, Banka ka synuar transmetimin e informacionit në një kohë sa më të shpejtë, të plotë dhe të thjeshtuar, duke e bërë komunikimin më të hapur dhe të aksesueshëm për publikun. Ky përkushtim i BSH-së ndaj komunikimit digjital është një hap i rëndësishëm për të mbetur një institucion transparent dhe i aksesueshëm për të gjithë qytetarët.



HAPËSIRË INFORMUESE 7

AKTIVITETE BRENDA VENDIT, TË ORGANIZUARA GJATË VITIT 2025

Më 9 janar 2025, me nismën dhe nën drejtimin e Guvernatorit Sejko, BSH-ja organizoi një takim me drejtuesit e sistemit bankar, me qëllim diskutimin e objektivave prioritarë për vitin. Në fokus të diskutimeve ishte forcimi i mëtejshëm i qëndrueshmërisë së sektorit bankar dhe rritja e kontributit të tij në zhvillimin e ekonomisë vendase, përmes kreditimit të shëndetshëm. Gjithashtu, u trajtuan çështje që lidhen me nxitjen e inovacionit financiar, procesin e anëtarësimit në SEPA dhe zhvillimin e bankingut të hapur, si elemente kyçe të modernizimit të sistemit financiar.

Më 23 janar 2025, BSH-ja dhe Banka Evropiane e Investimeve nënshkruan në Tiranë një marrëveshje në kuadër të Programit për Sistemet Financiare të Gjelbra. Marrëveshja synon zhvillimin e financave të qëndrueshme në vend, përmes hartimit të një Taksonomie Kombëtare të Gjelbër për klasifikimin e aktiviteteve ekonomike të qëndrueshme, si dhe forcimin e kapaciteteve të sektorit financiar për menaxhimin e rreziqeve klimatike.

Më 25 janar 2025, BSH, në bashkëpunim me BB-në, organizoi workshop-in me temë "Aspektet teknike dhe ligjore të lidhjes me skemat SEPA". Aktiviteti u përqendrua në diskutimin e hapave konkretë që institucionet financiare duhet të ndërmarrin pas anëtarësimit të Shqipërisë në zonën SEPA, për të garantuar përfitime të drejtpërdrejta për qytetarët dhe bizneset.

Më 6 shkurt 2025, BSH-ja, nën kujdesin e Guvernatorit Sejko dhe me pjesëmarrjen e Kryeministrit Rama, Ministres së Bujqësisë Denaj dhe Ministrit të Financave Malaj, organizoi tryezën "Kreditimi i sektorit bujqësor", me qëllim bashkimin e drejtuesve të bankave dhe agrobizneseve për të gjetur rrugë e instrumente që përmirësojnë financimin e bujqësisë.

- Më 19 shkurt 2025, u zhvillua ceremonia e nënshkrimit të Marrëveshjes mes Akademisë së Shkencave dhe BSH-së për ekspozimin në Muzeun e Bankës të disa objekteve numizmatike dhe arkeologjike në administrim të Akademisë së Shkencave/Institutit të Arkeologjisë.
- Më 20 mars 2025, BSH-ja dhe Dhoma Amerikane e Tregtisë organizuan forumin e biznesit me temë "E ardhmja është tani: Si po riformëson inovacioni shërbimet financiare shqiptare në 2025". Në fjalën përshëndetëse, Guvernatori Sejko theksoi transformimin e shpejtë të tregut financiar vendas falë digjitalizimit.
- Më 28 maj 2025, në ambientet e BSH-së u prezantua Raporti i Tranzicionit 2024–2025 i BERZH-it. Në fjalën e tij, Guvernatori Sejko vuri në dukje rëndësinë e reformave strukturore përballë sfidave të reja ekonomike, përfshirë rënien demografike dhe ndryshimet në tregun e punës. Aktiviteti shërbeu si platformë për diskutimin e politikave që nxisin diversifikimin ekonomik dhe rritjen e qëndrueshme.
- Më 25-26 qershor 2025, BSH-ja mirëpriti për herë të parë takimin vjetor të Kolegjit të Mbikëqyrësve të organizuar nga BQE-ja, forum ku paraqiten vlerësimet e përbashkëta të rrezikut, i njohur si Procesi i Rishikimit dhe Vlerësimit të Mbikëqyrjes (SREP), për grupet bankare evropiane, dhe diskutohen sfidat e menaxhimit të riskut gjeopolitik për vitin 2025.
- Më 8 korrik 2025, BSH-ja, në bashkëpunim me Ministrinë e Financave, organizoi një tryezë diskutimi me drejtuesit e sistemit bankar në vend, me fokus rritjen e kreditimit të sektorit bujqësor. Në këtë kontekst, Guvernatori



evidentoi angazhimin e Bankës për të nxitur kreditimin e bujqësisë, përmes ofrimit të fondeve me kosto të ulët dhe kushte të qëndrueshme financimi, duke mbështetur investime që rrisin produktivitetin dhe kapacitetet e këtij sektori jetik.

- Më 22 shtator 2025, BSH-ja zhvilloi një takim diskutimi me Bordin Drejtues të Shoqatës Shqiptare të Bankave, nën drejtimin e Guvernatorit Sejko. Qëllimi i takimit ishte intensifikimi i dialogut dhe bashkëpunimit me sektorin bankar, me fokus zhvillimet në sistemet e pagesave, digjitalizimin, promovimin e pagesave elektronike, investimet në infrastrukturë moderne dhe mbikëqyrjen e sistemit bankar.
- Më 7 tetor 2025, nën kujdesin e Guvernatorit Sejko, u zhvillua ceremonia e lançimit të transaksionit të parë të Shqipërisë në sistemin SEPA. Ceremonia u hap me fjalët përshëndetëse të Guvernatorit dhe Ambasadorit të Delegacionit të BE-së në Shqipëri, Sh. T.Z. Silvio Gonzato. Guvernatori Sejko theksoi se ky zhvillim përfaqëson më shumë se një hap teknik: ai është një moment themelor në rrugën e Shqipërisë drejt integritimit në infrastrukturën financiare evropiane.
- Më 23 tetor 2025, BSH-ja, në bashkëpunim me Bankën Evropiane të Investimeve, organizuan workshop-in me temë "Taksonomia Kombëtare e Gjelbër", në kuadër të përpjekjeve për zhvillimin e financave të qëndrueshme dhe përafrimin e mëtejshëm me standardet e BE-së. Diskutimet u përqendruan në rolin e taksonomisë së gjelbër, si një instrument orientues për identifikimin dhe klasifikimin e aktiviteteve ekonomike të qëndrueshme, nga pikëpamja mjedisore dhe klimatike.
- Më 6-7 nëntor 2025, BSH-ja organizoi në Tiranë workshop-in e 19-të të Kërkimeve Ekonomike për Evropën Juglindore. Punimet u hapën nga Guvernatori Sejko, i cili theksoi rëndësinë e kërkimit shkencor në një moment simbolik për institucionin, në 100-vjetorin e krijimit të tij, si dhe nevojën për politika të bazuara në dije, transparencë dhe analiza të thelluara përballë pasigurive globale, tranzicionit të gjelbër e digjital dhe ndryshimeve strukturore.
- Komiteti Kombëtar i Sistemit të Pagesave zhvilloi mbledhjen e tij të njëmbëdhjetë në datën 16 dhjetor 2025, nën drejtimin e Kryetares së tij, zj. Luljeta Minxhozi, Zëvendësguvernatore e Parë e BSH-së. Aktiviteti theksoi rolin kritik që po merr ky komitet, për të garantuar që transformimet teknologjike të një ekonomie që po digjitalizohet me ritme të shpejta të ecin në të njëjtin hap me zhvillimet rregullatore.
- Më 23 dhjetor 2025, me rastin e mbylljes së vitit, Guvernatori Sejko zhvilloi një takim me publicistë, analistë të politikës dhe të ekonomisë, gazetarë të shtypit të shkruar e medias elektronike. Ky takim - tashmë një traditë e konsoliduar e dialogut institucional - shërbeu si një platformë reflektimi mbi zhvillimet kryesore ekonomike dhe financiare të vitit, si edhe mbi rolin e medias në informimin e publikut dhe forcimin e besimit në institucionet publike. Gjatë këtij aktiviteti, u ndanë dhe tre çmimet e konkursit të përvitshëm "Çmimi i Guvernatorit për diplomën më të mirë për vitin 2025".



NJË BANKË QENDRORE E PËRGJEGJSHME DHE LLOGARIDHËNËSE


Si një institucion i pavarur, Banka e Shqipërisë synon të informojë qytetarët dhe në veçanti Kuvendin e Shqipërisë, mbi gjithë veprimtarinë e saj.

Marrëdhëniet institucionale me Kuvendin e Shqipërisë zhvillohen në disa drejtime, ku vendin më të rëndësishëm e zënë seancat dëgjimore të Guvernatorit në Komisionin Parlamentar të Ekonomisë, Punësimit dhe Financave (KEPF) dhe seancat plenare të Kuvendit. Në muajin tetor, Guvernatori prezantoi Raportin Vjetor të BSH-së për vitin 2024 në KEPF dhe më pas në Kuvendin e Shqipërisë, duke iu përgjigjur, sipas rastit, edhe interesit të deputetëve për çështje të veçanta të lidhura me të. Si çdo vit, Banka e Shqipërisë ka prezantuar në muajin nëntor 2025, në një seancë dëgjimore të dedikuar të KEPF-it, edhe opinionin e BSH-së për pikat kryesore të projektbuxhetit të shtetit për vitin pasardhës.

Qytetarët mund të gjejnë informacion të plotë dhe të përditësuar mbi gjendjen ekonomiko-financiare dhe zhvillimet kryesore makroekonomike të vendit, si dhe rolin e kontributin e BSH-së në këtë drejtim, në faqen zyrtare të internetit: www.bankofalbania.org. Gjatë vitit 2025, BSH-ja vijoi me përditësimin e rregullt të faqes së internetit, e cila pati rreth 2,4 milionë vizitorë, të cilët shfletuan rreth 9,4 milionë faqe.

Faqja jonë pasurohet vazhdimisht me një gamë të gjerë statistikash për shumë sektorë të ekonomisë shqiptare, si: sektori bankar, sektori fiskal, sektori real dhe sektori i jashtëm; të cilat publikohen sipas një kalendari të përcaktuar që përditësohet çdo gjashtëmuor. Statistikat e BSH-së gjenden edhe në raportet mujore statistikore dhe në raportet tremujore të politikës monetare. Kjo faqe ofron edhe të gjitha botimet, të cilat përmbledhin informacion të përditësuar mbi ekonominë shqiptare dhe atë botërore; mbi zhvillimet në sistemin bankar dhe atë financiar; stabilitetin financiar e paranë; ndryshimet e pasurimet e legjislacionit bankar dhe të kuadrit të tij rregullator; si dhe mbi çështje të tjera, duke u konsoliduar kështu si burim informacionesh të sakta dhe të besueshme për publikun.

Botimet e realizuara gjatë vitit 2025 janë, si çdo vit, periodike dhe joperiodike, dhe numërojnë rreth 3,200 faqe analiza, statistika dhe studime në gjuhën shqipe dhe atë angleze. Seti i raporteve periodike edhe gjatë këtij viti ka ruajtur të njëjtën strukturë: Raporti Vjetor (vjetor), Raporti i Politikës Monetare (tremujor), Raporti i Stabilitetit Financiar (gjashtëmuor) dhe Raporti i Mbikëqyrjes (vjetor). Përveç raporteve periodike, kjo gamë pasurohet më tej me Buletinin Zyrtar (në varësi të mbledhjeve të Këshillit Mbikëqyrës), Revistën “Bankingu Qendror” (gjashtëmuore), Revistën Ekonomike (gjashtëmuore), Revistën “Të reja shkencore në Bankën e Shqipërisë” (gjashtëmuore), si dhe materialet e ndryshme studimore dhe edukative. Gjatë vitit 2025, BSH-ja ka vijuar politikën e shpërndarjes falas të botimeve të saj, duke pasur në konsideratë edhe përfaqsimin në fushën e përgjegjshmërisë sociale të reduktimit të botimeve në letër.



Në funksion të informimit të publikut, BSH-ja i përgjigjet edhe kërkesave të shumta për informacion të qytetarëve, në formë të shkruar ose në formë elektronike. Gjatë vitit 2025, i janë kthyer përgjigje 85 kërkesave zyrtare drejtuar koordinatorit për të drejtën e informimit, gjithashtu janë trajtuar rreth 3,700 korrespondenca të publikut me departamentet e BSH-së për marrje informacioni, ankimime dhe pyetje në lidhje me sistemin bankar, të mbërritura pranë Bankës përmes adresës elektronike zyrtar: public@bankofalbania.org.

100-VJETORI I BANKËS SË SHQIPËRISË

Një shekull në shërbim të stabilitetit monetar dhe zhvillimit të vendit

Viti 2025 shënoi kremtimin e 100-vjetorit të themelimit të Bankës së Shqipërisë, një jubile që kurorëzoi një shekull përkushtimi ndaj stabilitetit monetar, forcimit të sistemit financiar dhe mbështetjes së zhvillimit ekonomik të vendit. Ky përvjetor historik përfaqëson jo vetëm një arritje institucionale, por edhe një reflektim mbi rrugëtimin e Shtetit Shqiptar drejt konsolidimit të institucioneve moderne dhe të pavarura.

Përgjatë këtij viti, BSH-ja organizoi një kalendar të pasur aktivitetesh shkencore, akademike dhe komunikuese, të cilat ndërthurën dimensionin historik me vizionin për të ardhmen, duke riafirmuar misionin e saj në prag të shekullit të dytë të veprimtarisë.

Konferenca e 100-vjetorit

Aktiviteti qendror i jubileut, i zhvilluar më 11 nëntor 2025 në Tiranë, mbledhi drejtues të bankave qendrore, përfaqësues të institucioneve financiare ndërkombëtare, autoritete publike dhe personalitete të botës akademike. Për herë të parë, BSH-ja mirëpriti 10 guvernatorë bankash qendrore, duke e shndërruar konferencën në një forum të nivelit të lartë për reflektim mbi evolucionin e bankingut qendror dhe sfidat e ekonomisë moderne. Panelet tematike trajtuan çështje kyçe si politika monetare, stabiliteti financiar, inovacioni në sistemet e pagesave dhe transformimi digjital.

Me rastin e jubileut, Presidentja e BQE-së, Christine Lagarde, dhe Drejtoresha e Përgjithshme e FMN-së, Kristalina Georgieva, përcollën mesazhe vlerësimi për rrugëtimin institucional të BSH-së. Në këto mesazhe u theksua rëndësia e pavarësisë së bankës qendrore, roli i saj në ruajtjen e stabilitetit të çmimeve dhe kontributi në forcimin e besimit publik e të qëndrueshmërisë ekonomike.

Në këtë konferencë, Kryeministri i Republikës së Shqipërisë, z. Edi Rama, vlerësoi bankën qendrore si një nga institucionet më të konsoliduara të Shtetit Shqiptar. Ai nënvizoi rolin e saj në garantimin e stabilitetit financiar, në përmbushjen e standardeve evropiane dhe në mbështetjen e integritetit të vendit në familjen evropiane.



Simbole të jubileut


Në kuadër të përvjetorit njëshekullor, u krijua një logo e veçantë që simbolizon traditën, stabilitetin dhe përkushtimin e Bankës për një të ardhme më të ndritur për Shqipërinë. Gjithashtu, BSH-ja emtoi monedhën përkujtimore “100 vjet Banka e Shqipërisë, 1925–2025”, e cila simbolizon vazhdimësinë institucionale dhe trashëgiminë monetare të vendit. Gjatë punimeve të konferencës, u prezantua videoja “100 vjet Banka e Shqipërisë”, një përmbledhje vizuale e rrugëtimit historik të institucionit, nga themelimi dhe sfidat e tranzicionit, deri te roli i sotëm si bankë qendrore e pavarur dhe moderne.

Dimensionin akademik dhe publik i jubileut

Në kuadër të 100-vjetorit u zhvillua Konferenca V e Muzeut të Bankës së Shqipërisë, me temë “Bankat qendrore dhe historia ekonomike: Reflektime dhe perspektiva”, duke forcuar dimensionin shkencor të jubileut. Paralelisht, u prezantua një cikël prej 5 dokumentarësh historikë dhe seria e postimeve në rrjetet sociale “100 vjet – 100 rrëfime”, të cilët sollën në vëmendje momente kyçe nga historia e bankës qendrore, duke krijuar një urë komunikimi me publikun e gjerë dhe brezat e rinj.

Në kuadër të jubileut u transmetuan emisione speciale dhe intervista në media kombëtare, ku drejtues të Bankës, ekspertë, akademikë dhe historianë ndanë analiza dhe rrëfime mbi rolin e saj në zhvillimin ekonomik të vendit, gjatë një shekulli.

Kremtimi i 100-vjetorit të bankës qendrore përfaqëson një moment solemn reflektimi mbi të kaluarën dhe një riafirmim të angazhimit për të ardhmen, për një bankë qendrore të pavarur, transparente dhe të orientuar drejt standardeve më të mira bashkëkohore.



2.13. EDUKIMI FINANCIAR

Edukimi financiar i publikut është pjesë e rëndësishme e veprimtarisë së Bankës së Shqipërisë. Ai realizohet përmes aktiviteteve dhe programeve edukative, vizitave në Muze, ekspozitave, si dhe botimeve të veçanta. Aktiviteti i Bankës së Shqipërisë, në këtë drejtim, ka dy objektiva kryesorë: prezantimin e rolit dhe funksioneve të bankës qendrore tek publiku, dhe kultivimin e përforcimin e një kulture financiare në shoqërinë shqiptare.

Gjatë vitit 2025, aktivitetet e edukimit financiar u zhvilluan në një kontekst me simbolikë të veçantë, duke u fokusuar kryesisht në shënimin e 100-vjetorit të Bankës së Shqipërisë dhe përgatitjeve për 100-vjetorin e monedhës kombëtare shqiptare. Ky përvjetor i dyfishtë u shfrytëzua si një mundësi për të rritur ndërgjegjësimin e publikut mbi historinë monetare dhe financiare të vendit, si dhe mbi rolin e institucionit në zhvillimin ekonomik të Shqipërisë.

Në kuadër të aktiviteteve edukuese të vitit 2025, BSH-ja organizoi Javën Globale të Parasë, në datat 17-23 mars, nën sloganin "Ndiq me mençuri, begati në ardhmëri! – 100 vjet bankë qendrore në Shqipëri!". Aktivitetet e saj u konceptuan si një ndërthurje mes sloganit të OECD-së që e koordinon këtë aktivitet në mbarë botën, me simbolikën e 100-vjetorit të bankës qendrore. Përmes aktiviteteve informuese, vizitave edukuese, sesioneve ndërgjegjësuese dhe materialeve të posaçme, Java Globale e Parasë përfshiu në mënyrë të drejtpërdrejtë mbi 4,800 nxënës dhe studentë, nga më shumë se 160 shkolla të të gjitha niveleve, në të gjithë vendin.

Më 11-12 qershor 2025, Banka organizoi Konferencën V të Muzeut të saj, me temë "Bankat qendrore dhe historia ekonomike: Reflektime dhe perspektiva", e cila shërbeu si një platformë reflektimi dhe shkëmbimi këndvështrimesh për çështje të historisë monetare dhe bankare. Historianë, muzeologë, studiues dhe ekonomistë të ftuar në këtë konferencë prezantuan gjetjet e studimeve të tyre mbi mënyrën si evoluojnë institucionet monetare, si vendimmarrja monetare formëson rezultatet, dhe si fitohet e ruhet besueshmëria, jo vetëm duke studiuar të kaluarën, por edhe duke parashtruar pyetjet e duhura për të ardhmen.

Për kremtimin e përvjetorit njëshekullor të bankingut qendror shqiptar, gjatë këtij viti u emetua monedha përkujtimore pa kurs ligjor "100 vjet Banka e Shqipërisë", e cila simbolizon rëndësinë e institucionit dhe përkujton ngjarjet kryesore që kanë shënuar zhvillimin e tij ndër vite, në nderim të kujtesës institucionale dhe si frymëzim për të ardhmen.

Një tjetër aktivitet i rëndësishëm ishte çelja e ekspozitës historike "Paraja rrëfen: 100 vjet jetë dhe ngjarje – Banka e Shqipërisë (1925-2025)", më 20 janar 2026. Përmes dokumenteve, objekteve muzeale dhe materialeve arkivore, ekspozita ofron një pasqyrë të zhvillimeve ekonomike, monetare dhe institucionale, përgjatë një shekulli.



Nismat e ndërmarra në kuadër të zbatimit të Strategjisë së BSH-së për Edukimin dhe Përfshirjen Financiare dhe aktivitetet edukuese, gjatë vitit 2025, kontribuuan në forcimin e njohurive financiare dhe në ndërtimin e një kulture të qëndrueshme financiare, duke e lidhur edukimin në këtë fushë me trashëgiminë historike dhe identitetin monetar kombëtar, në funksion të rritjes së mirëqenies afatgjatë.


MUZEU I BANKËS SË SHQIPËRISË

Edhe gjatë vitit 2025, Muzeu i BSH-së vijoi misionin e tij të prezantimit të historisë së monedhës kombëtare dhe të bankës qendrore, si dhe të promovimit, në mënyrë aktive, të edukimit financiar të publikut.

Përgjatë vitit, Muzeu priti rreth 5,000 vizitorë, duke u konsoliduar gjithnjë e më shumë si një pikë referimi për edukimin financiar. Vizitat në Muze janë kthyer tashmë në pjesë përbërëse të kurrikulës mësimore dhe të orëve të lira për nxënësit e shkollave 9-vjeçare dhe të mesme, por dhe për studentët e universiteteve, duke ofruar një qasje praktike dhe interaktive ndaj njohurive financiare dhe historike.

Më 19 maj 2025, në kuadër të Ditës Ndërkombëtare të Muzeve, me temë "E ardhmja e muzeve në komunitete që ndryshojnë me shpejtësi", Muzeu i BSH-së u hap për publikun në orare të zgjatura dhe pa kufizim në numrin e vizitorëve. Kjo temë theksoi rolin e muzeve në ndërtimin e një shoqërie më të përfshirë, më të qëndrueshme dhe të aftë për t'iu përshtatur sfidave të kohës. Me këtë rast, u përgatitën ekspozita me dokumente historike, filma të animuar dhe punime artistike të realizuara nga nxënës dhe studentë. Në vijim të kësaj tematike, Muzeu prezantoi për audiencën sesionin "Muzetë dhe pjesëmarrja e komunitetit: nga tradita në teknologji".

Në funksion të zgjerimit të veprimtarisë edukative, në datat 19-21 qershor 2025, Muzeu i BSH-së, në bashkëpunim me Parkun Arkeologjik të Apolonisë dhe Qendrën Muzeore Durrës, organizoi një ekspozitë të përbashkët në Apoloni, me temë "Qendrat urbane të Apolonisë dhe Dyrrahut të rrëfyera nëpërmjet monedhave". Përmes një kolazhi të pasur fotografish dhe imazhesh, vizitorët u njohën me traditën e prerjes së monedhave nga Apolonia dhe Dyrrahu, nga shek. IV p.e.s. deri në shek. II e.s., si dhe me disa prej prerjeve monetare të periudhës mesjetare. Qëllimi i kësaj ekspozite ishte të sillte më pranë publikut aspektet më të spikatura të zhvillimeve tregtare dhe ekonomike të këtyre qendrave urbane me rëndësi të veçantë në Ilirinë antike, si dhe të evidentonte vazhdimësinë historike, përmes monedhave kombëtare që pasqyrojnë monumente dhe objekte me vlera historike e kulturore universale.



3. BURIMET NJERËZORE DHE KAPACITETET INFRASTRUKTURE

Banka e Shqipërisë synon të zhvillojë kapitalin e saj njerëzor, në përputhje me objektivat strategjike dhe politikat përkatëse, duke krijuar një mjedis pune të favorshëm dhe motivues. Kjo qasje jo vetëm që ndihmon në rritjen e profesionalizmit dhe kompetencave të punonjësve, por gjithashtu kontribuon në përmirësimin e vazhdueshëm të proceseve administrative të institucionit.

3.1. BURIME NJERËZORE

Në harmoni me objektivat strategjike afatmesëm të institucionit, menaxhimi i burimeve njerëzore ka synuar adoptimin e praktikave dhe modeleve më të avancuara në fushën e administrimit të kapitalit njerëzor.

Përparësi e veçantë i është kushtuar zhvillimit të vazhdueshëm profesional të stafit, konsolidimit të një mjedisi pune stimulues e me nivel të lartë përgjegjësie, si dhe modernizimit të kuadrit rregullator dhe strukturës organizative të Bankës. Ky objektivi është ndjekur përmes përvetësimit sistematik të praktikave më të mira të menaxhimit të burimeve njerëzore, të zbatuara gjerësisht në institucionet homologe të BE-së, duke integruar njëkohësisht edhe mësimet e nxjerra dhe përshtatjet e domosdoshme të diktuara nga sfidat e reja.

Menaxhimi efektiv i burimeve njerëzore kërkon një rishikim dhe përshtatje të vazhdueshme të kuadrit rregullativ të institucionit, me synim harmonizimin e tij me standardet ndërkombëtare më të mira, si dhe mundësimin e zhvillimit dhe avancimit profesional të punonjësve me përvojë të konsoliduar. Përmes politikave të orientuara drejt forcimit të kompetencave profesionale, Banka synon ruajtjen e stabilitetit dhe kohezionit të stafit, si dhe identifikimin e tërheqjen e talenteve të reja — sfida këto që mbeten ndër më thelbësoret për bankat qendrore në kontekstin aktual. Zbatimi i politikave gjithëpërfshirëse për rekrutimin, menaxhimin dhe avancimin në karrierë ka për qëllim ndërtimin dhe ruajtjen e një strukture organizative efikase, profesionale dhe dinamike, duke e pozicionuar këtë objektivi ndër prioritetet thelbësore të Bankës. Njëkohësisht, racionalizimi i strukturës organizative dhe konsolidimi i vazhdueshëm i performancës institucionale, në përputhje të plotë me objektivat strategjike dhe kuadrit rregullativ në fuqi, vijojnë të qëndrojnë në thelb të këtyre politikave.

Përfaqësimi gjinor i stafit, në nivel drejtues dhe profesional, paraqitet si në vijim. Raporti i femrave ndaj meshkujve në totalin e punonjësve është rreth 59% - 41%, ndërkohë që ky raport në nivel drejtues është 63% - 37%.

Një kujdes i veçantë i është kushtuar edhe kombinimit të stafit me përvojë me stafin e ri. Moshë mesatare e stafit është 46 vjeç, ndërkohë që rreth 88% e punonjësve në Bankë janë me arsim të lartë. Vlen të theksohet se rreth 58% e



tyre kanë përfunduar studime pasuniversitare në nivel Master/PhD, si dhe kanë përfituar certifikata profesionale të njohura nga institucione ndërkombëtare.

Një tjetër element i rëndësishëm i politikave të burimeve njerëzore është edhe ofrimi i trajnimeve cilësore për zbatimin e proceseve të reja të punës. Pjesëmarrja e stafit në këto trajnime, të organizuara nga banka të ndryshme qendrore, institucionet financiare ndërkombëtare apo të tjera, përveç rritjes së njohurive profesionale, shërbejnë edhe për shkëmbimin e përvojave profesionale dhe menaxheriale me përfaqësuesit e institucioneve të tjera financiare.

Shpërndarja e aktivitetit të trajnimeve është respektivisht: 45% e tyre janë kryer në banka qendrore evropiane, si Banka Anglisë, BQE-ja, Banka e Francës, Banka e Italisë, Banka e Gjermanisë etj.; 22% janë kryer pranë institucioneve financiare ndërkombëtare si FMN-ja dhe BB-ja; dhe 33% nga organizatorë të tjerë si *Center of Excellence in Finance*, *EUROSTAT*, *Joint Vienna Institute*, Komisioni Evropian etj.


Ndërkohë, shpërndarja e aktivitetit të trajnimeve sipas drejtimeve të veprimtarisë është si vijon: 9.9% në mbikëqyrjen bankare, 9.46% në bankingun qendror, 9.46% në statistika financiare, 9.01% në sistemet e pagesave, 9.01% në operacione monetare, 7.66% në stabilitet financiar, si dhe 7.30% në teknologjinë e informacionit. Pjesa tjetër e trajnimeve janë zhvilluar në fusha të tilla si: politika monetare, ndërhyrja e jashtëzakonshme, ekonometri dhe modelim, auditimi i brendshëm etj. Duhet theksuar se numri më i madh i trajnimeve profesionale është i fokusuar drejt ndërtimit të kapaciteteve institucionale të bankës qendrore, për përmbushjen e funksioneve të saj kryesore.

Edhe gjatë vitit 2025, disa aktivitete janë organizuar në kuadër të marrëveshjeve të bashkëpunimit të Bankës me institucione homologe si: *State Secretariat for Economic Affairs (SECO)*, Komisioni Evropian, BQE-ja, dhe Banka e Gjermanisë, *European Banking Authority (EBA)* etj. Me qëllim marrjen e informacionit të targetuar dhe specifik, nga këto marrëveshje janë realizuar 18 aktivitete të formave të ndryshme, ku kanë marrë pjesë rreth 35 punonjës.

3.2. PËRMIRËSIME NË INFRASTRUKTURË

Banka e Shqipërisë ka vazhduar modernizimin dhe forcimin e sistemeve dhe infrastrukturës së teknologjisë së informacionit, në funksion të rritjes së efikasitetit dhe sigurisë operacionale.

Në funksion të objektivave strategjikë të BSH-së, edhe gjatë vitit 2025, kanë vijuar përmirësimet në sistemet dhe infrastrukturën e teknologjisë së informacionit, me fokus të veçantë sigurinë kibernetike. Në këtë drejtim janë ndërmarrë një sërë masash në funksion të: (i) rritjes së qëndrueshmërisë kibernetike të infrastrukturës dhe sistemeve informatike, nëpërmjet përsosjes së mëtejshme të



bazës rregullative e procedurale, (ii) implementimit të teknologjive të reja, (iii) përditësimit të sistemeve të sigurisë dhe mbrojtjes, (iv) intensifikimit të proceseve të monitorimit dhe rritjes së efektivitetit të zbulimit, dhe (v) reagimit ndaj sulmeve kibernetike dhe përmirësimit të planeve të vijimësisë.

Një objektiv i rëndësishëm gjatë vitit ka qenë modernizimi i mëtejshëm i sistemeve të pagesave në aspektin infrastrukturor. Kjo qasje vjen si përgjigje ndaj zhvillimeve teknologjike, i paraprin integrimin evropian dhe zgjerimit të përdorimit të shërbimeve elektronike të pagesave në nivel kombëtar e rajonal. Në të njëjtën kohë, ajo i përgjigjet nevojës për të aplikuar rregulla të forta të sigurisë dhe masa mbrojtëse, me qëllim adresimin e të gjitha rreziqeve, duke zbatuar standardet dhe praktikatat më të mira ndërkombëtare, si dhe aktet ligjore e rregullatore të miratuara në nivel kombëtar për sigurinë kibernetike.

Banka ka bashkëpunuar në vijimësi me institucione përgjegjëse për sigurinë kibernetike në vend dhe me institucione të tjera, duke ndjekur me kujdes çdo ngjarje kibernetike në Republikën e Shqipërisë. Ajo ka intensifikuar në të njëjtën kohë bashkëpunimin me institucione të huaja dhe vendase, në kuadër të përmirësimit të sigurisë, si FMN-në, BB-në, Autoritetin Kombëtar për Sigurinë Kibernetike (AKSK), si dhe Shoqatën Shqiptare të Bankave.

Gjithashtu, një vëmendje e veçantë i është kushtuar intensifikimit të fushatave ndërgjegjësuese brenda dhe jashtë institucionit: për rritjen e nivelit të gatishmërisë dhe vigjilencës së çdo punonjësi në përdorimin e sistemeve e të shërbimeve elektronike, dhe për mënyrën e reagimit ndaj formave të ndryshme të kërcënimeve me të cilat mund të përballen, për të mos rënë pre e kërcënimeve kibernetike; si dhe duke integruar çështjet e sigurisë kibernetike në edukimin financiar, me qëllim rritjen e besimit të publikut në përdorimin e sigurt të mjeteve digjitale në veprimtaritë financiare.



4. AUDITIMI I BRENDSHËM

Funksioni i auditimit të brendshëm në Bankën e Shqipërisë siguron mbarëvajtjen e zbatimit të ligjeve dhe akteve nënligjore në veprimtarinë e Bankës. Ai u siguron administratorëve dhe Këshillit Mbikëqyrës, në mënyrë periodike dhe të pavarur, verifikimin dhe vlerësimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm, duke testuar efektshmërinë e kontroleve dhe procedurat e vendosura. Auditimi i brendshëm realizohet nga Departamenti i Kontrollit.

4.1. ZHVILLIME TË RËNDËSISHME NË AKTIVITETIN E AUDITIMIT TË BRENDSHËM

A. VËNIA NË ZBATIM E POLITIKËS SË AUDITIMIT TË BRENDSHËM

Procesi i shqyrtimit dhe miratimit të Planit vjetor të Auditimit të Brendshëm në BSH u realizua në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit. Plani vjetor për vitin 2025 u hartua nga Departamenti i Kontrollit dhe Inspektori i Përgjithshëm dhe u paraqit për shqyrtim nga Komiteti i Auditimit. Më tej, ky plan i dakordësuar nga Komiteti i Auditimit, u miratua nga Këshilli Mbikëqyrës, me vendimin nr.66, datë 18.12.2024.

B. PROGRAMI I VLERËSIMIT TË CILËSISË SË AUDITIMIT TË BRENDSHËM

Standardet Ndërkombëtare për Praktikën Profesionale të Auditimit të Brendshëm kërkojnë që një vlerësim i jashtëm i cilësisë (EQA) së aktivitetit të auditimit të brendshëm të kryhet të paktën një herë në pesë vjet, nga një vlerësues i kualifikuar, i pavarur, ose një ekip vlerësimi nga jashtë institucionit. Standardet gjithashtu kërkojnë kryerjen e një vetëvlerësimi periodik çdo dy vjet.

Vlerësimi i Jashtëm i Cilësisë, i kryer gjatë vitit 2025 nga Banka Qendrore e Turqisë, konfirmoi se Aktiviteti i Auditimit të Brendshëm të Bankës së Shqipërisë "Përgjithësisht Përputhet"³⁵ me Standardet Globale të Auditimit të Brendshëm – që përfaqëson opinionin më të lartë të mundshëm.


Njësia rezultoi plotësisht në përputhje me shumicën e parimeve dhe pjesërisht në përputhje me disa prej tyre, duke ruajtur nivelin e kapaciteteve "Integrated" (Niveli 3) dhe, duke shënuar përparime drejt nivelit të avancuar. Ky opinion tregon se standardet janë zbatuar në mënyrë efektive dhe se mungesat e evidentuara nuk përbëjnë mospërputhje materiale.

Si rezultat, Auditimi i Brendshëm mund të deklarojë se vepron në përputhje me Standardet Globale të Auditimit të Brendshëm. Ai vlerësohet se përmbush rolin e tij dhe shton vlerë për qeverisjen, menaxhimin e rrezikut dhe kontrollin e brendshëm.

³⁵ Manuali i Vlerësimit të Cilësisë i IIAs (rishikuar në vitin 2025) sugjeron një shkallë me katër vlerësime: "Përputhet Plotësisht", "Përgjithësisht Përputhet", "Pjesërisht Përputhet" dhe "Nuk Përputhet".



Grafik 45. Progresi në vlerësimin e EQA-s



Burimi: Banka e Shqipërisë.


Ekipi i pavarur i vlerësimit evidentoi katër fusha ku auditimi i brendshëm demonstroi praktika të suksesshme audituese, tre fusha ku ekzistojnë boshllëqe në përputhshmëri me standardet e reja dhe pesë mundësi për përmirësim të vazhdueshëm. Këto të fundit janë përmirësuar në krahasim me vitin 2020. Ndërkohë, standardet “Pjesërisht në Përputhje”, të identifikuar në vlerësimin e fundit të EQA-së, vijjnë kryesisht si rezultat i ndryshimeve në Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të Brendshëm, të cilat kanë hyrë për zbatim nga muaji janar 2025. Këto standarde të reja kërkojnë rishikimin e bazës rregullative të Departamentit të Kontrollit - përfshirë Politikën e Auditimit të Brendshëm dhe Manualin e Auditimit – për të reflektuar konceptet dhe kërkesat e përditësuara të kuadrit të ri.

4.2. TREGUES TË PËRGJITHSHËM MBI DEPARTAMENTIN E KONTROLLIT

Në përputhje me Ligjin “Për Bankën e Shqipërisë”, statutin e Bankës së Shqipërisë, politikën dhe rregulloren e Auditimit të Brendshëm, dhe rregulloren e Komitetit të Auditimit, struktura e Departamentit të Kontrollit paraqitet sipas organigramës së mëposhtme me qëllim sigurimin e ruajtjes së objektivitetit, pavarësisë, integritetit të informacionit, përdorimit eficient të burimeve dhe efektivitetit të sistemeve të kontrollit të brendshëm në Bankën e Shqipërisë.

A. STRUKTURA ORGANIZATIVE E DEPARTAMENTIT TË KONTROLLIT

Struktura organizative e drejtuar nga Inspektori i Përgjithshëm jepet në vijim:



B. RITJA PROFESIONALE E STAFIT DHE TRAJNIMI I VAZHDUESHËM


Në funksion të përmbushjes së objektivit strategjik për rritjen profesionale të audituesve të brendshëm, inspektorët e kontrollit janë përfshirë në programe trajnimi për auditimin e brendshëm dhe për menaxhimin e rrezikut të ofruara nga bankat qendrore. Ata gëzojnë tituj në certifikime profesionale si ACCA, CIA, CISA, si dhe kanë ndjekur orët minimale të detyrueshme për mirëmbajtjen e tyre.

4.3. ANGAZHIMET E KRYERA GJATË VITIT 2025 DHE PROBLEMATIKAT KRYESORE TË EVIDENTUARA

Angazhimet e auditimeve të kryera gjatë vitit 2025 janë fokusuar në dhënien e opinionit mbi mjaftueshmërinë e kontrolleve të brendshme të vendosura nga Drejtimi për funksionet/proceset e audituara, përfshirë dhe aplikacionet mbështetëse për kryerjen e aktiviteteve.

Gjatë vitit 2025 u adresuan gjithsej **32 rekomandime** të rezultuara nga **11 angazhime** auditimi për dhënie sigurie. Rekomandimet kanë adresuar kryesisht nevojën për përmirësimin e proceseve (47%); rishikimin e bazës rregullative (28%) dhe të tjera mbi zbatimin e bazës rregullative (25%).

Gjetjet dhe rekomandimet për secilin prej auditimeve të realizuara gjatë kësaj periudhe janë adresuar fillimisht pranë drejtuesve të njësisë për komente dhe, më pas, pranë Administratorëve të Bankës së Shqipërisë dhe Komitetit të Auditimit.



5. ADMINISTRIMI I RREZIKUT OPERACIONAL

Qëllimi kryesor i Administrimit të Rrezikut Operacional është të miradministrojë pasiguritë që shoqërojnë veprimtarinë e Bankës së Shqipërisë, të informojë në çdo kohë Administratorët, duke ndihmuar në procesin vendimmarrës mbi rreziqet e mundshme operationale që pengojnë arritjen e objektivave, apo që kanë ndikime negative financiare dhe/ose reputacionale.

Njësia e Administrimit të Rrezikut Operacional, si një nga linjat e dyta të kontrolleve në Bankën e Shqipërisë, ka vijuar aktivitetin në drejtim të forcimit dhe rritjes së rolit të saj. Për vitin 2025, është kryer procesi periodik i rivlerësimit të rreziqeve operationale dhe nuk janë evidentuar rreziqe të shtuara. Nga analiza vjetore e raportimeve të njësive të Bankës ka rezultuar që, kontrollet e brendshme të vendosura nga njësitet janë përgjithësisht efektive për minimizimin/shmangien e dëmeve/rreziqeve nga incidentet e ndodhura. Shqyrtimi i mundësisë së lindjes së rreziqeve të reja të lidhura me zhvillimet globale ka qenë fokus i vazhdueshëm i vlerësimeve dhe analizës së ekspozimit të Bankës ndaj rrezikut operational.

A. Vlerësimi i nivelit të administrimit të rrezikut operational nga ekspertët ndërkombëtarë

Metodologjia e përdorur nga IORWG

Rritja dhe forcimi i aktivitetit të Njesisë pasqyrohet në vlerësimin e fundit të kryer nga ekspertët ndërkombëtarë të organizatës IORWG (*International Organization Risk Working Group*)³⁶.

Për vitin 2025, Banka e Shqipërisë u vlerësua me rezultatin 85%, me një rritje prej 3% nga vlerësimi i fundit. Ky vlerësim përkon me kategorinë "I Menaxhuar", ku klasifikohen shumica e bankave qendrore. Ai është në linjë me vetëvlerësimet e fundit pozitive dhe është vetëm 1 pikë larg kategorisë "I Avancuar" që është edhe objektivi afatmesëm i Bankës së Shqipërisë.

AD-HOC	BAZIKE	I MENAXHUAR	I AVANCUAR	I MATURUAR
<61%	≥61%	≥69%	≥86%	≥94%

Vlerësimi bëhet periodikisht bazuar në matricën e vlerësimit të IORWG, duke u bazuar në 5 shtylla kryesore:

- nivelin e dizenjimit të proceseve dhe sistemeve të kontrollit që mbulojnë këto procese,
- mënyrën dhe strukturën e organizimit të funksionit të administrimit të rrezikut,

³⁶ Banka e Shqipërisë, si anëtare e organizatës IORWG, ka marrë pjesë në vlerësimin periodik të kryer nga kjo organizatë për 102 banka qendrore si dhe autoritete mbikëqyrëse dhe monetare (siç janë BIS, ECB, FMN).



- c) nivelin e raportimit të saktë dhe në kohë,
- d) rezultatet pas menaxhimit të rrezikut, dhe
- e) kulturën e rrezikut, e cila është një sfidë që kërkon ndërgjegjësim dhe trajnim të vazhdueshëm nga njësitë e Bankës.

Ky vlerësim i kryer nga IORWG u realizua për të gjithë bankat qendrore të anëtarësuar. Ai certifikon nivelin e maturitetit nga një organizatë e pavarur ndërkombëtare të Administrimit të Rrezikut Operacional, ndërgjegjësimit dhe edukimit të njerëzve; aspekte që kanë ndikuar dhe do të ndikojnë në mirëfunksionimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të funksioneve bazë dhe mbështetëse në kuadër të menaxhimit të rrezikut.

B. Menaxhimi i Vijueshmërisë së Veprimtarisë (BCM³⁷)

Funksioni i “Menaxhimit të Vijueshmërisë së Veprimtarisë” ka për qëllim përmirësimin e aftësisë reaguese të Bankës në rast ndërprerjeje operacionale të gjatë apo një Krize/Emergjence. Ai siguron vazhdimësinë e proceseve kritike, si dhe ndihmon kthimin në veprimtarinë normale të aktivitetit të Bankës, sa më shpejt të jetë e mundur. Këshilli Mbikëqyrës ka miratuar një kuadër të plotë në lidhje me Menaxhimin e Vijueshmërisë së Veprimtarisë.

Pjesë përbërëse e këtij kuadri rregullativ janë edhe planet individuale të vijueshmërisë për çdo departament, strategjitë që ndiqen, si dhe detyrat e përgjegjësitë për çdo pjesëmarrës. Për të siguruar efektivitetin e tyre, janë realizuar trajnime dhe testime periodike me stafin.

Krizat ekspozojnë pikat e forta dhe të dobëta të qeverisjes së çdo organizate, si dhe aftësinë dhe fleksibilitetin e tyre për të menaxhuar përgjatë krizës. Gjatë periudhave të fundit kemi qenë dëshmitarë të ballafaqimit dhe kalimit me sukses të disa krizave si fatkeqësitë natyrore, pandemia dhe sulmet kibernetike. Parandalimi i rrezikut, planifikimi i vazhdimësisë së veprimtarisë dhe përmirësimi në menaxhimin e incidenteve janë thelbësore për të siguruar qëndrueshmërinë e institucionit.

C. Funksioni i Sinjalizuesit në Bankën e Shqipërisë

Në ndihmë të procesit të Administrimit të Rrezikut Operacional ka ardhur edhe konsolidimi i funksionit të Sinjalizimit. Bazuar në ligjin nr.60/2016 “Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve”, kjo strukturë ka për qëllim:

- a) të parandalojë dhe të godasë korrupsionin në Bankën e Shqipërisë;
- b) të nxisë sinjalizimet mbi veprimet ose praktikatat e dyshuara të korrupsionit;
- c) të mbrojë individët që sinjalizojnë veprimet ose praktikatat e dyshuara të korrupsionit në vendin e tyre të punës.

³⁷ BCM - Business Continuity Management.



Banka ka funksionuar me bazën rregullative të plotë, me të gjithë udhëzuesit e mjetet e nevojshme për t'iu mundësuar punonjësve sinjalizimin e rasteve të dyshimta.

Për vitin 2025 nuk është raportuar asnjë rast apo veprim i dyshuar sinjalizimi.



6. STRATEGJIA AFATMESME E ZHVILLIMIT TË BANKËS SË SHQIPËRISË 2026 – 2028

Strategjia afatmesme e zhvillimit përcakton objektivat institucionalë të Bankës së Shqipërisë për periudhën 2026-2028 dhe shërben si udhëzues për përgatitjen e buxhetit orientues afatmesëm. Objektivat përfshijnë edhe rekomandimet e Rezolutës së Kuvendit për vlerësimin e veprimtarisë së Bankës së Shqipërisë.

Në përputhje me detyrat e përcaktuara në ligjin organik, prioritetet në veprimtarinë e Bankës së Shqipërisë janë:

- a) Rritja e efektivitetit të politikës monetare dhe e cilësisë së vendimmarrjes, përmes: (i) zgjerimit të instrumenteve të politikës monetare për adresimin e sfidave të reja; (ii) përditësimin të modeleve makroekonomike dhe zhvillimit të metodave moderne të kërkimit shkencor; (iii) rritjes së bashkëpunimit me autoritetet fiskale në hartimin e strategjive të zhvillimit ekonomik të vendit; (iv) përmbushjes së kërkesave për përafrimin e legjislacionit të Bashkimit Ekonomik dhe Monetar; dhe (v) përmirësimit të komunikimit me publikun për të rritur kuptueshmërinë dhe njohuritë mbi vendimmarrjen.
- b) Parandalimi i rreziqeve sistemike dhe rritja e rezistencës së sistemit financiar, duke u bazuar në: (i) pasurimin me instrumente makroprudenciale që parandalojnë rreziqet sistemike strukturore; (ii) përmirësimin e metodologjive të ushtrimit të provës së rezistencës; (iii) sigurimin e ekuivalencës dhe përshtatjen e mëtejshme të kuadrit ligjor dhe nënligjor për mbikëqyrjen me legjislacionin evropian; (iv) rritjen e pjesëmarrjes në kolegjet mbikëqyrëse të grupeve të rëndësishme bankare evropiane; (v) vlerësimin e rezistencës së subjekteve ndaj sulmeve kibernetike; (vi) forcimin e mbikëqyrjes në drejtim të rreziqeve që burojnë nga inovacioni financiar dhe teknologjia; dhe (vii) përditësimin e planeve të ndërhyrjes së jashtëzakonshme dhe metodologjinë për përcaktimin e kërkesës minimale, në cilësinë e Autoritetit të Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme.
- c) Nxitja e funksionimit normal të sistemit të pagesave përmes: (i) implementimit të një sistemi Instant Payments me Bankën e Italisë, dhe (ii) mbështetjen e ofruesve të shërbimeve financiare për të vijuar anëtarësimin në skemat e Tregut Unik të Pagesave në Euro.
- d) Ruajtja e besimit publik të kartëmonedha dhe monedha shqiptare, plotësimi i nevojave në rritje të ekonomisë për para të gatshme e të përshtatshme për qarkullim, dhe mbrojtja nga falsifikimi.
- e) Rritja e kapaciteteve investuese në përputhje me rritjen e nivelit të rezervave valutore dhe përfshirja e klasave të reja të instrumenteve



financiare për një portofol sa më të diversifikuar.


- f) Hartimi dhe shpërndarja e statistikave duke ndjekur praktikat më të mira të administrimit të të dhënave sipas standardeve evropiane.
- g) Rritja e pranisë së Bankës së Shqipërisë në mediat sociale me gjuhë të kuptueshme dhe organizimi i ekspozitave dhe aktiviteteve të ndryshme për zgjerimin e edukimit dhe kulturës financiare në vend.
- h) Harmonizimi i mëtejshëm me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar dhe përditësimi i kuadrit të përgjithshëm kontabël, përmirësimi i infrastrukturës së rrjetit dhe sigurisë në teknologjinë e informacionit, dhe forcimi i sistemit të kontrollit të brendshëm.
- i) Përmirësimi dhe modernizimi i kuadrit rregullativ për mbikëqyrjen e rezikut kibernetik dhe përshtatjen e tij me legjislacionin evropian.



SHTOJCA NR. 1 REZOLUTA E VEPRIMTARISË PËR VITIN 2024

Kuvendi i Shqipërisë i paraqet BSH rekomandimet si më poshtë:


Nr.	REKOMANDIMI	STATUSI I REALIZIMIT	SQARIME
1	Të pasurojë modelet makroekonomike, duke përfshirë adoptimin në vazhdimësi të metodave bashkëkohore të kërkimit shkencor, në mënyrë që të përmirësojë cilësinë, saktësinë dhe përshtatshmërinë e parashikimeve dhe vlerësimeve ekonomike dhe financiare, duke mbajtur gjithmonë në fokus orientimin e politikës monetare drejt garantimit të qëndrueshmërisë së çmimeve si një parakusht themelor për zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik të vendit.	Realizuar	<p>Banka e Shqipërisë ka ndërmarrë një sërë veprimesh për forcimin e kuadrit analitik dhe mbështetjen e vendimmarrjes së politikës monetare. Në këtë kuadër, është konsoliduar procesi i parashikimit makroekonomik përmes pasurimit të bazës së të dhënave, formulimit më rigoroz të supozimeve dhe përdorimit më të integruar të modeleve makroekonomike, duke mundësuar një vlerësim më të plotë të goditjeve dhe ndërtimin e skenarëve parashikues më koherentë.</p> <p>Paralelisht, janë pasuruar dhe publikuar matjet e inflacionit bazë, të cilat kanë kontribuar në një vlerësim më të saktë të presioneve inflacioniste me karakter të qëndrueshëm dhe kanë mbështetur hartimin e një politike monetare më efektive. Puna kërkimore është avancuar në fusha kyçe makroekonomike, përfshirë analizën e faktorëve që ndikojnë në ecurinë dhe efektet e kursit të këmbimit, zhvillimet në tregun e punës, formimin e pritjeve të konsumatorëve dhe tregues të tjerë kryesorë ekonomikë.</p> <p>Në të njëjtën kohë, Banka e Shqipërisë ka forcuar kapacitetet profesionale dhe teknologjike përmes trajnimit të vazhdueshëm të stafit dhe përmirësimit të infrastrukturës së sistemeve dhe programeve kompjuterike, duke rritur cilësinë dhe efikasitetin e analizës ekonomike.</p>
2	Të koordinojë politikën monetare me atë fiskale, në mënyrë që të sigurohet një qasje e harmonizuar dhe sinergjike që jo vetëm të mbështesë stabilitetin makroekonomik dhe kontrollin efektiv të inflacionit, por edhe të krijojë kushtet për një rritje ekonomike të qëndrueshme dhe përmirësim të mirëqenies së përgjithshme të qytetarëve.	Realizuar	<p>Banka e Shqipërisë ka vijuar angazhimin e saj për koordinimin institucional me Ministrinë e Financave, përmes shkëmbimit të rregullt të informacionit dhe analizave, me fokus vlerësimin e ndikimit të politikës fiskale mbi inflacionin, aktivitetin ekonomik dhe stabilitetin financiar.</p> <p>Në këtë kuadër, Banka e Shqipërisë ka përgatitur opinione mbi projektbuxhetin dhe ka realizuar analiza mbi qëndrueshmërinë e borxhit publik dhe identifikimin e vulnerabiliteteve fiskale. Ky bashkëpunim është reflektuar gjithashtu në procesin e parashikimit makroekonomik, përmes përfshirjes së parametrave buxhetorë në skenarët analitikë.</p> <p>Në tërësi, ky koordinim ka kontribuar në ndërtimin e një miks politikash të balancuara dhe koherente, në mbështetje të stabilitetit makroekonomik në afatin e mesëm.</p>



3	<p>Të adoptojë një qasje të matur dhe të kujdesshme ndaj ndërhyrjeve në tregun valutor, duke i kufizuar ato në raste të nevojshme dhe të justifikuar nga rrethanat e tregut, në mënyrë që të forcohet funksioni i kursit të këmbimit si një mekanizëm vetërregullues i ekonomisë, i cili ndihmon në zbutjen e goditjeve të jashtme, ruajtjen e konkurrueshmërisë dhe mbështetjen e një ekuilibri të qëndrueshëm makroekonomik.</p>	Realizuar	<p>Banka e Shqipërisë ndjek një regjim kursi këmbimi fleksibël, në të cilin kursi përcaktohet kryesisht nga forcat e tregut. Ky regjim mbështet transmetimin efektiv të politikës monetare dhe kontribuon në ruajtjen e stabilitetit makroekonomik, në përputhje me objektivin kryesor të Bankës së Shqipërisë.</p> <p>Gjatë viteve të fundit, kursi ka shfaqur një tendencë forcuese, e cila mbështetet kryesisht në faktorë fundamentalë, si: përmirësimi i bilancit të pagesave, flukset e larta valutore nga turizmi dhe investimet, si dhe rritja e besimit ndaj ekonomisë vendase.</p> <p>Forcimi i kursit të këmbimit ka ushtruar një efekt të dukshëm disinflacionist, duke kontribuar në uljen e inflacionit të importuar dhe në zbutjen e presioneve të jashtme mbi çmimet. Ndikimi mbi konkurrueshmërinë e ekonomisë vlerësohet i menaxhueshëm, në kushtet e rritjes së eksporteve të shërbimeve dhe përmirësimit të produktivitetit në disa sektorë kyç.</p> <p>Në këtë kontekst, ndërhyrjet e Bankës së Shqipërisë në tregun valutor janë realizuar në mënyrë selektive dhe të përkohshme, të justifikuar nga kushtet e tregut dhe të orientuara drejt zbutjes së luhatjeve afatshkurtra. Këto veprime kanë synuar ruajtjen e stabilitetit makrofinanciar dhe shmangien e shtrëngimit të panevojshëm të kushteve financiare, pa cenuar parimin e fleksibilitetit të kursit të këmbimit dhe pa krijuar pritje për mbështetjen e një niveli të caktuar të tij.</p>
4	<p>Të forcohet mbikëqyrja për sa i takon ekspozimit të sistemit bankar ndaj kredimarrësve të mëdhenj dhe të diversifikohet portofoli i kredive, me qëllim zbutjen e përqendrimit në sektor dhe në territor, duke rritur kapacitetin e bankave në mënyrë që sistemi bankar të ruajë kapitalizimin dhe qëndrueshmërinë edhe në raste të vështirësive të huamarrësve kryesorë, si dhe garantimin e zhvillimit të qëndrueshëm</p>	Realizuar	<p>Bankat mbikëqyren si në nivel individual, ashtu edhe në nivel sistemi, në kuadër të një qasjeje gjithëpërfshirëse të vlerësimit të rrezikut. Përqendrimi i portofolit përbën një tregues kyç në procesin e vlerësimit të rreziqeve, duke reflektuar peshën e ekspozimeve ndaj subjekteve të caktuara, si në raport me portofolin e kredive, ashtu edhe me bazën e kapitalit të bankës. Në këtë kuadër, bankat raportojnë në mënyrë periodike mbi elementet përkatëse të rrezikut. Rreziku i përqendrimit analizohet gjithashtu në kuadër të procesit të brendshëm të vlerësimit të mjaftueshmërisë së kapitalit. Në rastet kur konstatohet tejkalimi i limiteve të përcaktuara, bankave u kërkohet të ndërmarrin masa korigjuese, përfshirë rritjen e kapitalit, me qëllim mbulimin e përshtatshëm të këtij rreziku.</p> <p>Në tërësi, rreziku i përqendrimit mbetet një element thelbësor në ndërtimin e portofolave të bankave, pasi ai pasqyron strukturën e ekonomisë vendase, e cila karakterizohet nga një përqendrim relativisht i lartë i veprimtarisë ekonomike në një numër të kufizuar subjektësh.</p>




5	<p>Të intensifikojë monitorimin e kredive ndaj sektorit të ndërimit dhe projekteve të mbështetura me pasuri të paluajtshme, duke siguruar vlerësim më konservativ të kolateralit dhe aftësisë pagueuse, për të reduktuar rrezikun e përqendruar në këtë sektor dhe për të ruajtur stabilitetin e sistemit bankar.</p>	Realizuar	<p>Banka e Shqipërisë ka miratuar vendimin për vendosjen e kufijve të sipërm për treguesit raporti i kredisë ndaj vlerës (Loan-to-Value – LTV) dhe raporti i shërbimit të borxhit ndaj të ardhurave (Debt Service-to-Income – DSTI) për kreditë e destinuar për pasuri të paluajtshme rezidenciale.</p> <p>Këta kufij janë diferencuar sipas monedhës së kredisë (lek ose valutë), si dhe sipas qëllimit të përdorimit të pronës, përfshirë blerjen e banesës së parë për qëllime banimi ose blerjen e banesave të dyta e vijuese për qëllime investimi dhe dhënieje me qira.</p> <p>Masat e ndërmarra synojnë ruajtjen e cilësisë së ekspozimeve të sektorit bankar ndaj tregut të pasurive të paluajtshme rezidenciale dhe kufizimin e rreziqeve të përqendrimit. Bankat janë të detyruara të raportojnë me frekuencë tremujore mbi zbatimin e këtyre kufijve, ndërsa informacioni i mbledhur do të përpunohet dhe analizohet për të vlerësuar efektivitetin e masave dhe, nëse është e nevojshme, për t'i përshtatur ose pasuruar ato në të ardhmen.</p> <p>Procesi i vlerësimit të kreditimit ndaj sektorëve të ekonomisë dhe i vlerësimit të kolateraleve të kredive përbën një element të rëndësishëm të veprimtarisë mbikëqyrëse dhe është në fokus të inspektimeve në vend. Kufizimi i përqendrimit sektorial është një kriter thelbësor i administrimit të rrezikut, për të cilin kuadri rregullator kërkon që bankat të vendosin limite të brendshme të përshtatshme. Banka e Shqipërisë dhe bankat e nivelit të dytë kanë zhvilluar diskutime të vazhdueshme lidhur me praktikën e vlerësimit të kolateraleve. Ky proces realizohet nga palë të treta të licencuara nga autoritetet përkatëse, ndërkohë që janë konstatuar raste të vlerësimeve jo realiste ose të ekzagjeruara, të cilat paraqesin rrezik për mbulimin e mjaftueshëm të ekspozimeve kreditore. Adresimi i kësaj problematike kërkon angazhim dhe masa të koordinuara nga autoritetet përgjegjëse.</p>
6	<p>Të integrojë rreziqet klimatike dhe ato të tranzicionit në kuadrin mbikëqyrës përmes zhvillimit të një kornize gjithëpërfshirëse për identifikimin, matjen, menaxhimin dhe raportimin e ekspozimeve ndaj sektorëve të ndjeshëm, e cila duhet të parashikojë kërkesën që bankat e nivelit të dytë të dokumentojnë politikat përkatëse të menaxhimit të rreziqeve klimatike, të raportojnë rregullisht ekspozimet përkatëse dhe të kryejnë analiza e stres-teste mbi ndikimet e mundshme klimatike dhe të tranzicionit, si dhe të ofrojnë instrumente të domosdoshme për financimin e projekteve, që janë në përputhje me këtë agjendë të Shqipërisë në linjë me procesin e integritimit evropian.</p>	Realizuar	<p>Banka e Shqipërisë ka integruar gradualisht rreziqet klimatike dhe faktorët ESG në kuadrin mbikëqyrës, në përputhje me praktikën më të mira ndërkombëtare dhe me objektivat e integritimit evropian.</p> <p>Në një fazë të parë, është hartuar Strategjia 2023–2025, e cila synon ndërgjegjësimin e sektorit bankar dhe përcaktimin e pritshmërive mbikëqyrëse për administrimin e rreziqeve klimatike dhe ESG. Këto pritshmëri janë reflektuar në një udhëzues orientues, jo të detyrueshëm për zbatim, mbi bazën e të cilit bankat kanë raportuar vetëvlerësimet e tyre për nivelin aktual të përmbushjes dhe planet për adoptimin gradual të kërkesave përkatëse.</p> <p>Në një fazë të dytë, Banka e Shqipërisë po përgatit Strategjinë 2026–2028, e cila parashikon kalimin drejt zbatimit më të strukturuar të pritshmërive mbikëqyrëse përmes raportimeve të rregullta dhe inspektimeve në vend. Në këtë kuadër, bankat do të zhvillojnë metodologji të brendshme, kryesisht me natyrë cilësore, për vlerësimin e nivelit të integritimit të rreziqeve klimatike dhe ESG në proceset e administrimit të rrezikut. Kërkesat mbikëqyrëse do të përfshijnë përfshirjen e rrezikut klimatik në procesin e brendshëm të vlerësimit të mjaftueshmërisë së kapitalit, si dhe ndërtimin e formateve të standardizuara të raportimit, të cilat do të mundësojnë kryerjen e analizave si në nivel individual banke, ashtu edhe në nivel sistemi bankar.</p>



7	<p>Të përshpejtojë procesin e përafritimit të kuadrit rregullator dhe mbikëqyrës me standardet e Bashkimit Evropian dhe rekomandimet e Bazel III, në funksion të rritjes së qëndrueshmërisë së sistemit bankar dhe përgatitjes së vendit për integrimin në tregun e përbashkët evropian.</p>	Realizuar	<p>Në përputhje me legjislacionin e Bashkimit Evropian dhe në funksion të procesit të integritimit evropian, Banka e Shqipërisë po avancojnë një sërë nismash për përafritimin e kuadrit ligjor dhe nënligjor bankar. Në këtë kuadër, po punohet për hartimin e ligjit të ri organik të Bankës së Shqipërisë, hartimin e një ligji të ri për institucionet e kreditit, i cili përfaqëson kërkesat e Direktivës 2013/36/BE dhe ndryshimeve pasuese të saj (CRD IV/V/VI), si dhe dispozitatë përkatëse të Rregullores (BE) nr. 575/2013, si dhe për përditësimin e ligjit për rimëkëmbjen dhe ndërhyrjen e jashtëzakonshme në banka.</p> <p>Paralelisht, po rishikohet ligji “Për sigurimin e depozitave”, me synim forcimin e mëtejshëm të kuadrit të mbrojtjes së depozituesve dhe rritjen e qëndrueshmërisë së rrjetit të sigurisë financiare.</p> <p>Procesi i hartimit të ligjit të ri për institucionet e kreditit po realizohet me asistencën e Bankës Botërore. Pas miratimit të këtij ligji, Banka e Shqipërisë do të vijojë me hartimin dhe miratimin e kuadrit përkatës nënligjor, në përputhje me standardet evropiane.</p> <p>Në funksion të forcimit të qëndrueshmërisë operationale digjitale, Banka e Shqipërisë ka hartuar projektregulloren “Për qëndrueshmërinë operationale digjitale”, e cila përfaqëson kërkesat e rregullores DORA dhe akteve të saj plotësuese. Kjo rregullore synon krijimin e një kornize rregullative gjithëpërfshirëse, në përputhje me standardet më të fundit të Bashkimit Evropian, për administrimin e rrezikut të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit, rrezikut kibernetik dhe rreziqeve që lidhen me përdorimin e ofruesve të jashtëm të shërbimeve TIK. Aktualisht, projektregullorja ndodhet në proces konsultimi me subjektet përkatëse.</p> <p>Aktet ligjorë dhe nënligjorë të sipërpërmendur janë duke u përgatitur në përputhje me afatet e parashikuara në planin përkatës për përafritimin me legjislacionin e BE-së.</p> <p>Gjatë vitit 2025, Banka e Shqipërisë ka plotësuar dhe paraqitur pranë Autoritetit Bankar Evropian pyetësorët e vlerësimit të ekuivalencës për fazën 1 dhe fazën 2, të cilët vlerësojnë përputhshmërinë e kuadrit ligjor dhe nënligjor me atë të Bashkimit Evropian. Faza e parë e këtij procesi është përfunduar me sukses, ndërsa pritet vlerësimi përfundimtar i fazës së dytë.</p>
8	<p>Të forcojë mbikëqyrjen ndaj institucioneve financiare jobanka, për të synuar zbatimin e plotë të ndryshimeve rregullatore të miratuara gjatë vitit të kaluar, për të përmirësuar cilësinë e portofolit të kredive dhe mbrojtjen e kredimarrësve.</p>	Realizuar	<p>Banka e Shqipërisë monitoron në mënyrë të vazhdueshme cilësinë e portofolit të kredive të institucioneve financiare jobanka, përmes raporteve tremujore të detyrueshme. Në rastet kur evidentohen mangësi ose problematika, Banka e Shqipërisë angazhohet në komunikim të drejtëpërdrejtë me subjektet përkatëse, me qëllim adresimin e tyre në kohë.</p> <p>Në përputhje me planin vjetor të mbikëqyrjes, Banka e Shqipërisë kryen inspektime në vend në mënyrë periodike, duke siguruar mbulimin e një cikli pesëvjeçar të mbikëqyrjes për secilin prej subjekteve financiare jobanka të licencuara. Këto inspektime synojnë vlerësimin e përputhshmërisë rregullatore, administrimin e rrezikut dhe qëndrueshmërinë e veprimtarisë së tyre.</p> <p>Gjatë vitit 2025, Banka e Shqipërisë ka ndërmarrë masa mbikëqyrëse ndaj subjekteve që nuk kanë përbushur kërkesat rregullatore, përfshirë revokimin e dy licencave dhe pezullimin e aktivitetit të një subjekti financiar jobanka.</p> <p>Në funksion të mbrojtjes së kredimarrësve, Banka e Shqipërisë monitoron rregullisht normat e interesit të aplikuara nga subjektet jobanka, për të siguruar përputhshmërinë e tyre me kufijtë e lejuar nga kuadri rregullator. Gjithashtu, Banka e Shqipërisë administron dhe trajton ankesat e paraqitura nga publiku pranë Zyrës së Regjistrimit të Kredive dhe Zyrës së Transparencës, në përputhje me procedurat përkatëse.</p>



<p>9</p>	<p>Në bashkëpunim me autoritetet e tjera përgjegjëse, të harmonizojë dhe të përditësojë në vijimësi planet për reagimin ndaj sulmeve kibernetike në sektorin bankar dhe në sistemet e pagesave të operuara prej saj, si dhe të angazhohet në vazhdimësi për realizimin e testeve të sigurisë për çdo bankë sistemike.</p>	<p>Realizuar</p>	<p>Banka e Shqipërisë ka hartuar dokumentin "Udhërrëfyesi i Vetëvlerësimit të Rrezikut Kibernetik", në bashkëpunim me partnerë ndërkombëtarë, përfshirë Departamentin Amerikan të Thesarit, dhe në përputhje me standardin ISO/IEC 27002:2022. Ky dokument synon forcimin e kuadrit për identifikimin, vlerësimin dhe administrimin e rrezikut kibernetik në sektorin bankar.</p> <p>Pas plotësimit të udhërrëfyesit nga bankat, Banka e Shqipërisë ka kryer vlerësimin përkatës të rezultateve, të cilat shërbejnë për të matur nivelin e maturitetit të proceseve dhe kontroleve që lidhen me menaxhimin e rrezikut kibernetik, si dhe për të identifikuar fushat që kërkojnë përmirësim ose masa korigjuese.</p> <p>Në nivel kombëtar, Banka e Shqipërisë bashkëpunon ngushtësisht me aktorët kryesorë të sistemit financiar dhe institucional. Në këtë kuadër, bashkëpunimi me Shoqatën Shqiptare të Bankave synon bashkërendimin e veprimeve dhe përmirësimin e komunikimit teknik në rast të incidenteve ose sulmeve kibernetike, me qëllim sigurimin e një reagimi të shpejtë dhe kufizimin e përhapjes së rrezikut në të gjithë sistemin bankar. Paralelisht, bashkëpunimi me Agjencinë Kombëtare të Sigurisë Kibernetike mbështet zbatimin e masave ligjore dhe teknike për mbrojtjen e Infrastrukturave Kritike, përfshirë koordinimin e testeve të sigurisë për vlerësimin e qëndrueshmërisë së tyre. Banka e Shqipërisë ka ndërmarrë gjithashtu një sërë masash për forcimin e qëndrueshmërisë operationale, duke përfshirë përmirësimin e mëtejshëm të masave mbrojtëse, përsosjen e proceseve të monitorimit dhe administrimit të sistemeve dhe sigurisë kibernetike, si dhe përditësimin e Sistemit të Pagesave dhe të gjithë infrastrukturës mbështetëse, përmes aplikimit të teknologjive më të fundit dhe standardeve më të larta të sigurisë.</p> <p>Në aspektin e edukimit dhe ndërgjegjësimit, në përputhje me strategjinë afatmesme, Banka e Shqipërisë ka intensifikuar aktivitetet ndërgjegjësuere për publikun mbi përdorimin e sigurt të mjeteve digjitale në veprimtaritë financiare, përmes integritit të sigurisë kibernetike në programet e edukimit financiar. Njëkohësisht, janë intensifikuar aktivitetet trajnuese dhe ndërgjegjësuere për stafin, me synim rritjen e nivelit të ndërgjegjësimit mbi rreziqet kibernetike dhe përmirësimin e aftësive për reagim në situata kërcënimesh kibernetike.</p>
<p>10</p>	<p>Të shtojë mbikëqyrje të vazhdueshme mbi aktivitetin e zyrave të këmbimit valutor, specifikisht për plotësimin e kërkesave të reja rregullatore, me synim garantimin e integritetit dhe transparencës së sistemit financiar.</p>	<p>Realizuar</p>	<p>Gjatë vitit 2025, Banka e Shqipërisë ka intensifikuar mbikëqyrjen ndaj zyrave të këmbimit valutor, duke kryer kontrole të shtuara dhe duke vendosur masa dhe rekomandime në përputhje me kërkesat e kuadrit ligjor për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit. Këto veprime kanë synuar forcimin e përputhshmërisë rregullatore dhe garantimin e integritetit të aktivitetit të këmbimit valutor.</p> <p>Në vijim, gjatë vitit 2026, Banka e Shqipërisë parashikon vijimin e kontroleve mbikëqyrëse, me fokus verifikimin e zbatimit të plotë të kërkesave ligjore dhe rregullatore, përfshirë kontrollin e transaksioneve dhe dokumentacionit mbështetës, me qëllim ruajtjen e transparencës dhe integritetit të sistemit financiar.</p>



11	Në bashkëpunim me institucionet e tjera të fushës, të sigurojë zbatimin rigoroz të të gjithë kuadrit rregullativ raportues, parandalues dhe të vigjilencës në fushën e parandalimit të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit për të gjitha subjektet që mbikëqyr.	Realizuar	Banka e Shqipërisë bashkëpunon ngushtësisht me Autoritetin e Inteligjencës Financiare, në bazë të memorandumit të mirëkuptimit ndërmjet institucioneve. Në kuadër të këtij bashkëpunimi, kryhen inspektime të përbashkëta në vend në fushën e parandalimit të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit. Për të siguruar një qasje të koordinuar dhe efektive mbikëqyrëse, në fillim të çdo viti hartohet një plan vjetor i inspektimeve, i cili përcakton prioritetet, fushat e fokusit dhe kalendarin e veprimeve mbikëqyrëse.
12	Të vijojë përditësimin dhe përfshirjen e kuadrit ligjor dhe rregullativ në fushën e pagesave në përputhje me legjislacionin dhe treguesit orientues (benchmarks) të Bashkimit Evropian të përcaktuar në procesin e negociatave, si dhe me nevojat e tregut. Të vazhdojë procesin e integritimit në sistemin TIPS dhe të mbështesë nisma për rritjen e aksesit në pagesa në kohë reale për popullatën dhe bizneset përmes inovacionit teknologjik.	Realizuar	Në muajin shtator, Banka e Shqipërisë ka përfunduar përditësimin e sistemeve kombëtare të pagesave, duke adoptuar standardin ISO 20022 dhe standardet SEPA për pagesat me vlerë të vogël, shoqëruar me miratimin e kuadrit të ri rregullator për funksionimin e tyre. Paralelisht, Banka e Shqipërisë ka miratuar rregullimin e tavaneve për tarifatat e pagesave në lekë dhe në euro, me synim uljen e tyre në mënyrë të ndjeshme dhe përmirësimin e aksesit të përdoruesve në shërbimet e pagesave. Gjithashtu, është rishikuar rregullorja “Për përcaktimin e kërkesave për transfertat e kreditit dhe të debitimit direkt në euro”, me qëllim sigurimin e barazisë së trajtimit ndërmjet transfertave ndërkombëtare dhe atyre kombëtare në euro, si dhe reduktimin e kostove për përdoruesit e këtyre shërbimeve. Në vijim, Banka e Shqipërisë po punon për rishikimin e ligjit “Për shërbimet e pagesave”, me synim përafrimin e plotë me legjislacionin e Bashkimit Evropian, përfshirë Direktivën për Shërbimet e Pagesave (PSD2) dhe Direktivën për Parantë Elektronike (EMD2), si dhe krijimin e bazës ligjore për përafrimin e rregullore së Bashkimit Evropian “Për komisionet e shkëmbimit për transaksionet me karta”, pjesë përbërëse e benchmark-ëve të procesit të integritimit. Paralelisht, po vijon përafrimi i mëtejshëm i kërkesave të transparencës në përputhje me Rregulloren (BE) 2021/1230 “Për pagesat ndërkufitare në Bashkimin Evropian”. Gjithashtu, vijon puna për ndërtimin e sistemit TIPS Clone, projekt i cili po zhvillohet në ndërthurje me nismën “Cashless Albania” dhe pritet të përfundojë brenda vitit 2026, me synim rritjen e aksesit në pagesa në kohë reale për popullatën dhe bizneset.
13	Të rrisë bashkëpunimin me të gjithë aktorët dhe institucionet publike për ndërgjegjësimin mbi dëmet e dezinformimit financiar, si dhe të hartojë dhe zbatojë rregullore standarde për parandalimin dhe monitorimin e tij, me qëllim ruajtjen e stabilitetit financiar dhe forcimin e sigurisë kombëtare.	Realizuar	Banka e Shqipërisë ka nisur një fushatë të dedikuar ndërgjegjësimi mbi dezinformimin financiar, me synim rritjen e nivelit të edukimit financiar të publikut dhe forcimin e aftësisë së tij për të identifikuar informacionin e pasaktë ose keqinformues në fushën financiare. Fushata përfshin materiale shpjeguese mbi temat kryesore të bankingut qendror, të hartuara në një gjuhë të thjeshtë dhe të aksesueshme për publikun e gjerë; një seri informuese me titull “Trill apo fakt”, e fokusuar në sqarimin e miteve dhe keqinterpretimeve më të shpeshta financiare; si dhe hartimin dhe publikimin e një fjalori financiar, me qëllim rritjen e kuptueshmërisë së termave kryesorë ekonomikë dhe financiarë. Zbatimi i kësaj fushate ka filluar në muajin shkurt 2026 dhe parashikohet të vijojë përgjatë vitit 2026. Paralelisht, Banka e Shqipërisë po punon për rishikimin e rregulloreve për transparencën dhe konfidencialitetin, me synim forcimin e standardeve të transparencës dhe informimit publik, si dhe përmirësimin e mekanizmave për parandalimin dhe adresimin e dezinformimit financiar, në funksion të reduktimit të spekulimeve dhe ruajtjes së besimit në sistemin financiar.



SHTOJCA NR. 2

Informacion i detajuar mbi zbatimin e rregullave të përcaktuara në manualin e monitorimit vjetor dhe periodik (miratuar me vendimin nr. 134/2018 të kuvendit) për raportimin e institucioneve të pavarura kushtetuese, në përgjithësi dhe të bankës së Shqipërisë, në veçanti

PIKA 3. ÇËSHTJE QË DUHET TË PËRFSHIHEN NË PËRMBAJTJEN E RAPORTIT VJETOR TË INSTITUCIONIT NË MONITORIM	REFERENCA ME NR. FAQE NË RAPORTIN VJETOR 2025
a) Mesazhi i Titullarit të institucionit	Fq. 9
b) Referencat në ligjet mbi të cilat mbështetet veprimtaria e institucionit	Fq. 7
c) Niveli i respektimit/plotësimit të detyrimeve ndërkombëtare	<ul style="list-style-type: none"> - Integrimi evropian dhe bashkëpunimi ndërkombëtar, fq. 103 - Marrëdhëniet me FMN fq. 104 - Marrëdhëniet me BB, fq. 104 - Bashkëpunimi teknik, fq. 104 - Kuadri rregullativ dhe metodologjik, fq. 59 - Kontributi në procesin e integrimit evropian, fq. 62 - Rishikimi i kuadrit mbikëqyrës lidhur me digjitalizimin dhe sigurinë kibernetike, fq. 62 - Ndjekja e rekomandimeve të Moneyval-it, fq. 63 - Vlerësimi i ekuivalencës së kuadrit mbikëqyrës rregullativ, fq. 63 - Plotësimi i kuadrit rregullator dhe metodologjik për ndërhyrjen e jashtëzakonshme, fq. 73 - Hapësirë informuese 5, përditësimi i sistemeve kombëtare të pagesave, fq. 82 - Statistikat, fq. 95
ç) Rekomandimet e "Progresraportit të BE-së për Shqipërinë" dhe shkalla e përbushjes së tyre	Integrimi evropian dhe bashkëpunimi ndërkombëtar, fq. 103
d) Niveli i zbatimit të Rezolutës së Kuvendit për vlerësimin e veprimtarisë	Shtojca nr. 1.
dh) Ndryshimet në kuadrin rregullator gjatë vitit në raportim dhe efekti që kanë sjellë	<ul style="list-style-type: none"> - Zhvillimet kryesore të vitit 2025, paragrafët 6-8, fq. 11 - Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë, fq. 15 - Hapësirë informuese 3, programi i financimit për biznesin mikro, të vogël dhe të mesëm, fq. 48 - Vlerësimi i rreziqeve sistemike, fq. 58 - Kuadri rregullativ dhe metodologjik, fq. 59 - Kontributi në procesin e integrimit evropian, fq. 62 - Rishikimi i kuadrit mbikëqyrës lidhur me digjitalizimin dhe sigurinë kibernetike, fq. 62 - Financa e gjelbër, fq. 62 - Ndjekja e rekomandimeve të Moneyval-it, fq. 63 - Mbrojtja konsumatore, fq. 63 - Vlerësimi i ekuivalencës së kuadrit mbikëqyrës rregullativ, fq. 63 - Rishikimi i kuadrit rregullativ dhe metodologjik, fq. 66 - Planet e ndërhyrjes së jashtëzakonshme, fq. 70 - Kërkesa minimale për instrumente të kapitalit rregullator dhe detyrime të pranura (MREL), fq. 71 - Plotësimi i kuadrit rregullator dhe metodologjik për ndërhyrjen e jashtëzakonshme, fq. 73 - Hapësirë informuese 5, përditësimi i sistemeve kombëtare të pagesave, fq. 82 - Statistikat, fq. 95 - Përmirësime në infrastrukturë, fq. 117



<p>e) Vendimarrja gjatë vitit në raportim dhe problematikat që e kanë nxitur</p>	<ul style="list-style-type: none"> - Zhvillimet kryesore të vitit 2025, paragrafët 6-8, fq. 11 - Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë, fq. 15 - Hapësirë informuese 1, ecuria e kursit të këmbimit dhe reagimi i Bankës së Shqipërisë, fq. 24 - Hapësirë informuese 3, programi i financimit për biznesin mikro, të vogël dhe të mesëm, fq. 48 - Vlerësimi i rreziqeve sistemike dhe masat makroprudenciale, fq. 58 - Kuadri regullativ dhe metodologjik, fq. 59 - Kontributi në procesin e integritetit evropian, fq. 62 - Rishikimi i kuadrit mbikëqyrës lidhur me digjitalizimin dhe sigurinë kibernetike, fq. 62 - Financa e gjelbër, fq. 62 - Ndjekja e rekomandimeve të Moneyval-it, fq. 63 - Mbrojtja konsumatore, fq. 63 - Vlerësimi i ekuivalencës së kuadrit mbikëqyrës rregullativ, fq. 63 - Rishikimi i kuadrit rregullativ dhe metodologjik, fq. 66 - Planet e ndërhyrjes së jashtëzakonshme, fq. 70 - Kërkesa minimale për instrumente të kapitalit rregullator dhe detyrime të pranuar (MREL), fq. 71 - Plotësimi i kuadrit rregullator dhe metodologjik për ndërhyrjen e jashtëzakonshme, fq. 73 - Hapësirë informuese 5, përditësimi i sistemeve kombëtare të pagesave, fq. 82 - Roli reformator dhe katalizator, fq. 88 - Statistikat, fq. 95 - Përmirësime në infrastrukturë, fq. 117 - Zhvillime të rëndësishme në aktivitetin e auditimit të brendshëm, fq. 119
<p>ë) Të dhëna mbi inspektimet e kryera</p>	<p>Ekzaminimet në vend, fq. 64 Inspektimet në banka, fq. 70</p>
<p>f) Vetëvlerësimi për nivelin e zbatimit të detyrimeve ligjore</p>	<p>Veprimtaria e Bankës së Shqipërisë gjatë vitit 2025 është kryer në përputhje me ligjin organik dhe me ligjet e tjera mbi bazën e së cilave funksionon institucioni. Kjo konfirmohet dhe në raportet e Auditorëve të Brendshëm, Auditorit të Jashtëm dhe të Kontrollit të Lartë të Shtetit.</p>
<p>g) Statusi i zbatimit të rekomandimeve të Kontrollit të Lartë të Shtetit</p>	<p>Dokumenti i bashkëlidhur me titull Informim për Kuvendin e Shqipërisë mbi aktivitetin dhe rezultatet e Departamentit të Kontrollit për periudhën janar – dhjetor 2025, seksioni VI. Ndjekja e statusit të rekomandimeve të adresuara nga KLSH gjatë vitit 2025, fq. 18</p>
<p>gj) Rekomandime të lëshuara për institucione të tjera</p>	<ul style="list-style-type: none"> - Vlerësimi i rreziqeve sistemike, fq. 58 - Ekzaminimet në vend, fq. 64 - Inspektimet në banka, fq. 70
<p>h) Nevoja për ndryshime në kuadrin ligjor, apo nënligjor</p>	<ul style="list-style-type: none"> - Kuadri regullativ dhe metodologjik, fq. 59 - Kontributi në procesin e integritetit evropian, fq. 62 - Rishikimi i kuadrit mbikëqyrës lidhur me digjitalizimin dhe sigurinë kibernetike, fq. 62 - Ndjekja e rekomandimeve të Moneyval-it, fq. 63 - Vlerësimi i ekuivalencës së kuadrit mbikëqyrës rregullativ, fq. 63 - Plotësimi i kuadrit rregullator dhe metodologjik për ndërhyrjen e jashtëzakonshme, fq. 73 - Roli reformator dhe katalizator, fq. 88 - Statistikat, fq. 95 - Strategjia afatmesme e zhvillimit të BSH 2026-2028, fq. 125
<p>i) Organizimi i brendshëm të institucionit dhe struktura</p>	<p>Burimet njerëzore, fq. 116</p>
<p>j) Të dhëna mbi të ardhurat dhe shpenzimet</p>	<p>Këshilli Mbikëqyrës: - Buxheti, fq. 16 Pasqyrat Financiare për vitin 2025</p>



k) Listë e proceseve gjyqësore në vijim	Banka e Shqipërisë	Çështje administrative	Çështje civile
	Palë e paditur	21	13
	Palë paditëse	14	3
	Total	35	16

PIKA 4. RAPORTIMI I BANKËS SË SHQIPËRISË NË KUVEND	REFERENCA ME NR. FAQE NË RV 2025
a) Trajtimi i problemeve në masën e duhur në funksion të transparencës dhe duke referuar te shembuj nga autoritete mbikëqyrëse bankare të vendeve të Europës	Zbatuar.
b) Përcjellja e informacionit me gjuhë të qartë, duke synuar sqarimin e çdo problematike	Zbatuar.
a) Analizat e zhvillimeve ekonomike në vend	Politika Monetare, fq. 20: - Politika monetare gjatë vitit 2025, fq. 20 - Hapësirë informuese 1, ecuria e kursit të këmbimit dhe reagimi i Bankës së Shqipërisë, fq. 24 - Ecuria e aktivitetit ekonomik, fq. 28 - Hapësirë informuese 2, rivlerësimi i rritjes potenciale, fq. 33 - Tregu i punës, fq. 36
b) Analizat e zhvillimeve në çmimet e konsumit, inflacion dhe zhvillimet monetare	Politika Monetare, fq. 20: - Inflacioni dhe faktorët përcaktues të tij, fq. 37 - Bilanci i pagesave dhe pozicioni i jashtëm i ekonomisë, fq. 41 - Tregjet financiare dhe treguesit monetarë, fq. 43 - Hapësirë informuese 3, programi i financimit për biznesin mikro, të vogël dhe të mesëm, fq. 48 Operacionet monetare, fq. 53: - Operacionet në treg të hapur dhe administrimi i nevojave për likuiditet, fq. 53 - Lehtësitë e përhershme, fq. 54 - Rezerva e detyruar, fq. 54
c) Stabiliteti financiar	Stabiliteti financiar dhe politika makroprudenciale, fq. 56: - Zhvillimet kryesore në sistemin financiar dhe sektorin bankar, fq. 56 - Vlerësimi i rreziqeve sistematike dhe masat makroprudenciale, fq. 58 - Kuadri rregullativ dhe metodologjik, fq. 59
ç) mbikëqyrja bankare	Mbikëqyrja bankare, fq. 61: - Ecuria e sektorit bankar dhe prioritetet mbikëqyrëse, fq. 61 - Ekzaminimet në vend, fq. 64 - Rishikimi i kuadrit rregullativ dhe metodologjik, fq. 66 - Kuadri licencues dhe miratimet, fq. 67 Ndërhyrja e jashtëzakonshme, fq. 69: - Fuqizimi i aftësisë për ndërhyrje të jashtëzakonshme, fq. 70 - Kërkesa minimale për instrumente të kapitalit rregullator dhe detyrime të pranuar (MREL), fq. 71 - Hapësirë informuese 4, burimet e financimit të kërkesës MREL gjatë vitit 2025, fq. 72 - Plotësimi i kuadrit rregullator dhe metodologjik për ndërhyrjen e jashtëzakonshme, fq. 73 - Operacionalizimi i fondit të ndërhyrjes së jashtëzakonshme, fq. 74



<p>d) Aktiviteti i BSH</p>	<ul style="list-style-type: none"> - Emetimi i monedhës, fq. 75 - Sistemet e pagesave, fq. 78 - Hapësirë informuese 5, përditësimi i sistemeve kombëtare të pagesave, fq. 82 - Administrimi i rezervës valutore, fq. 90 - Hapësirë informuese 6, flukset që ndikuan rezervën valutore, gjatë vitit 2025, fq. 93 - Statistikat, fq. 95 - Puna kërkimore, fq. 99 - Integrimi evropian dhe bashkëpunimi ndërkombëtar, fq. 103 - Transparenca dhe komunikimi me publikun, fq. 107 - Hapësirë informuese 7, aktivitete brenda vendit, të organizuara gjatë vitit 2025, fq. 109 - 100-vjetori i Bankës së Shqipërisë, fq. 112 - Edukimi financiar, fq. 114 - Burimet Njerëzore dhe kapacitetet infrastrukturore, fq. 116 - Auditimi i brendshëm, fq. 119 - Administrimi i rrezikut operacional, fq. 122 - Strategjia afatmesme e zhvillimit të BSH 2026-2028, fq. 125 <p>Këshilli Mbikëqyrës: Buxheti, fq. 16</p> <p>Raportit Vjetor i bashkëngjiten Pasqyrat Financiare të audituara dhe certifikuara, për vitin 2025.</p> <p>Për investimet:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Hapësirë informuese 5, përditësimi i sistemeve kombëtare të pagesave, fq. 82 - Roli reformator dhe katalizator, fq. 88 - Zhvillime të tjera, në kuadër të funksionit të administrimit të rezervës valutore, fq. 93 - Modernizimi strukturor i infrastrukturës statistikore, fq. 96 - Përmirësime në infrastrukturë, fq. 117 - Strategjia afatmesme e zhvillimit të BSH, Fq. 125 <p>Auditimi i brendshëm, fq. 119:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Zhvillime të rëndësishme në aktivitetin e auditimit të brendshëm, fq. 119 - Tregues të përgjithshëm mbi Departamentin e Kontrollit, fq. 120 - Angazhimet e kryera gjatë viti 2024 dhe problematikat kryesore të evidentuara, fq. 121 - Administrimi i rrezikut operacional, fq. 122
----------------------------	--





